



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 972/3 Prot.

Tiranë, më 04.05.2026

VENDIM

Nr. 06, Datë 04.05.2026

PËR
MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË VITIT 2025
TË VEPRIMTARISË SË AGJENCISË KOMBËTARE TË KËRKIMIT SHKENCOR
DHE INOVACIONIT

Në zbatim të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 109/2024 "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", VKM nr. 464, datë 31.07.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 607, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), me kërkesë të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Bordi i Administrimit të AKKSHI në mbledhjen e datës 04.05.2026,

VENDOSI:





- Miratimin e Raportit vjetor të vitit 2025 të veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe inovacionit, AKKSHI (dokumentacioni bashkëlidhur këtij vendimi);
- Përcjelljen pranë Ministrisë së Arsimit të Raportit vjetor të vitit 2025 të veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe inovacionit, AKKSHI;
- Ngarkohet AKKSHI për zbatimin e këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Znj. Armela Baka, Kryetar 

Z. Erjon Uka, Anëtar; 

Znj. Mirela Cami, Anëtar; 

Znj. Juljana Margariti, Anëtar; 
Znj. Anisa Subashi, Anëtar; 
Z. Fatbardh Sallaku, Anëtar; 
Znj. Ines Muçostepa Anëtar; 

AKSI
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

**AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT
SHKENCOR DHE INOVACIONIT**

[Handwritten signatures]

PËRMBAJTJA

0.1 HYRJE	6
0.2 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E RAPORTIT PËR VITIN 2025	7
1. DREJTORIA E PROGRAMEVE KOMBËTARE	8
1.1 STRUKTURA, MISIONI, PROGRAMET, PROCESET E PUNËS	9
1.2 TË DHËNA STATISTIKORE	15
1.2.1 Financimi	15
1.2.2 Sipas fushave dhe programeve	16
1.2.3 Monitorimi	20
i. Identifikimi i fushave prioritare	21
ii. Shpërndarja e fondeve për programet e kërkimit	21
iii. Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore	21
iv. Financimi i projekteve të doktoraturës	21
1.2.4 Aktivitete të tjera të DPK	22
a. Administrimi i bazës së të dhënave kombëtare	22
b. Transparenca e projekteve të financuara	22
c. Mbështetje për politikëbërjen	22
d. Shpërndarja e fondeve sipas kriterëve të miratuara	22
e. Komunikimi dhe shpërndarja e informacionit	22
1.3 VEPRIMTARIA SIPAS SEKTORËVE	23
1.3.1 SEKTORI I PROGRAMEVE KOMBËTARE	23
i. Hartimi i Dokumentave të Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit	23
ii. Përgatitja e Formularit të Aplikimit	23
iii. Takime dhe konsultime	23
iv. Shqyrtimi formal i projekt-propozimeve	23
v. Përgatitja e bazës së të dhënave	24
vi. Organizimi i procesit të vlerësimit	24
vii. Përgatitja e Urdhrit për financim	24
viii. Përgatitja e kontratave të financimit	24
ix. Analiza e ecurisë së projekteve	24
1.3.2 SEKTORI I TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT	28
i. Projekt e Infrastrukturës së kërkimit shkencor	28
ii. Projekte të Teknologjisë dhe Inovacionit	32
iii. Programi i Mbështetjes së Studimeve të Doktoraturës	34
a. Bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë	36
b. Bashkëpunimi me institucionet publike	36
c. Bashkëpunimi me sektorin privat	37
d. Organizimi i takimeve me universitete	37
e. Raportim për zhvillimin e inovacionit	37
f. Organizimi i forumeve shkencore	37
g. Analiza e bashkëpunimit me biznesin	37
h. Mbështetje për kuadrin ligjor	37
i. Përgatitja e raportit vjetor	37
1.4 ANALIZA SWOT E DPK	38

3. DREJTORIA E PROGRAMEVE NDËRKOMBËTARE	39
2.1 VEPRIMTARIA KRYESORE E DREJTORISË SË PROGRAMEVE NDËRKOMBËTARE	40
2.1.1 Shpërndarja e informacionit dhe koordinimi i proceseve të aplikimit	42
2.1.2 Koordinimi i Rrjetit të Pikave Kombëtare të Kontaktit (NCP)	42
2.1.3 Komunikimi i vlerësimit të veprimtarisë kërkimore	42
2.1.4 Administrimi i fondeve të tjera të kërkimit shkencor dhe inovacionit	42
2.1.5 Paraqitja e raportit vjetor pranë Ministrisë së Arsimit	42
2.1.6 Bashkëpunimi ndërinstitucional për zbatimin e strategjisë kombëtare	43
2.1.7 Nxitja e bashkëpunimit me sektorin e biznesit	43
2.2 SEKTORI I MARRËDHËNIEVE DYPALËSHE	44
2.2.1. Sektori 1 – Bashkëpunimi Shkencor	44
i. Analiza e Programave Bilaterale	45
a. Bashkëpunimi Shqipëri - Kosovë (Thirrja 2024–2026)	48
b. Bashkëpunimi Shqipëri - Turqi (Thirrja 2026–2028)	49
c. Bashkëpunimi Shqipëri - Austri (Thirrja 2026–2028)	51
d. Bashkëpunimi Shqipëri - Itali	53
ii. Përfundim i përgjithshëm	54
a. Përgatitja e Udhëzimeve për Programet e Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik Dypalësh	54
b. Përgatitja e drafteve të Protokolleve të Bashkëpunimit	54
c. Përcaktimi i fushave parësore të bashkëpunimit	54
d. Përgatitja e Formularit të Aplikimit	54
e. Përgatitja e Thirrjeve për Aplikim	54
f. Organizimi i seminareve dhe trajnimeve	55
g. Ndërtimi i bazës së të dhënave	55
h. Përgatitja e skedave të vlerësimit	55
i. Shqyrtimi formal i projekt-propozimeve	55
j. Organizimi i misioneve të vlerësimit	55
k. Përgatitja e projekt-planit financiar	55
2.2.2. Sektori 1 – Menaxhimi i Projekteve	55
i. Përgatitja e kontratave dhe monitorimi	55
ii. Takime dhe konsultime	55
iii. Monitorimi i projekteve	55
iv. Shqyrtimi i raporteve vjetore dhe përfundimtare	56
2.3 SEKTORI I MARRËDHËNIEVE SHUMËPALËSHE	57
2.3.1. Sektori i Marrëdhënieve Multilaterale	57
i. PËRMBLEDHJE E PROJEKTEVE NDËRKOMBËTARE KU AKKSHI ËSHTË I PËRFSHIRË	58
a. Projekti "POLICY ANSWERS"	58
b. Projekti "NCP_WIDERA.NET"	58
c. Projekti "SEREN5"	59
d. Projekti "ERA TALENT"	59
e. Projekti 1FUTURE	60
f. Projekti Biodiversa+	60

ii. PROGRESI DHE POZICIONIMI STRATEGJIK I SHQIPËRISË NË "HORIZON EUROPE"	61
a. Shqipëria në Horizon Europe	62
b. Pozicionimi Strategjik dhe Transformimi i Kuadrit Ligjor (2023-2026)	68
c. Reforma Ligjore si Garanci për Standardet e Ekselencës	69
d. Dokumentet Strategjike: Vizioni "Shqipëria 2030"	69
e. Rezultatet e Reformave dhe Objektivat e Inovacionit	69
f. Krahasimi Horizon 2020 vs Horizon Europe	70
g. Performanca Teknike	74
h. Vizioni Strategjik: Drejt një Ekosistemi Kërkimor Digjital dhe Konkurrues	77
i. Angazhimi Politik dhe Objektivat Operacionalë 2026-2027	77
iii. RRJETI COST	79
iv. RRJETI EUREKA	86
v. PROGRAMI I SHKËMBIMIT TË STUDIMEVE UNIVERSITARE "CEEPUS IV"	90
vi. Angazhime të tjera stafit të DPN	94
2.3.2. SEKTORI 2 – PROGRAMET E BE	96
i. Përgatitja e raportit vjetor për ecurinë e projekteve ndërkombëtare	96
ii. Analiza e programeve të BE-së	96
iii. Informim për programin Horizon Europe	96
iv. Organizimi i workshop-eve për aplikime	96
v. Ndihmë për aplikantët në projekte	96
vi. Monitorimi i projekteve ndërkombëtare	96
vii. Koordinimi me rrjetet ndërkombëtare	97
viii. Raport mbi projektet e financuara	97
ix. Analiza e performancës së projekteve	97
2.3.3. SEKTORI 2 – ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE	97
i. Dhënie informacioni dhe këshillim	97
ii. Takime me organizata ndërkombëtare	97
iii. Përgatitja e projekteve të reja	97
iv. Analiza e bashkëpunimit ndërkombëtar	97
v. Raporti vjetor ndërkombëtar	97
vi. Sfidat Kryesore dhe Rekomandimet	97
vii. Kërkesa/Rekomandime për Kapacitetet Njerëzore	98

3. SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE	99
3.1. SEKTORI 1 – FINANCË	100
3.1.1. Organizimi dhe drejtimi i veprimtarisë së sektorit	101
3.1.2. Kontrolli dhe garantimi i shkresave financiare	101
3.1.3. Asistenca në llogaritjen e kostove	101
3.1.4. Menaxhimi i riskut financiar	101
3.1.5. Menaxhimi i detyrimeve dhe pagesave	101
3.1.6. Planifikimi buxhetor	101
3.1.7. Zbatimi i buxhetit	102
i. Buxheti për shpenzimet kapitale viti 2025	102
3.1.8. Menaxhimi i shpenzimeve të personelit	104
3.1.9. Alokimi dhe rishpërndarja e burimeve	104
3.1.10. Administrimi i pagave	104
3.1.11. Hartimi i bilancit financiar	104
3.1.12. Regjistrimi i të ardhurave dhe shpenzimeve	104
3.1.13. Dokumentimi dhe gjurma e auditimit	104
3.1.14. Rakordimi me Thesarin	104
3.1.15. Raportimi financiar	105
3.1.16. Koordinimi me Ministrinë e Arsimit	105
3.1.17. Menaxhimi i inventarit	105
3.1.18. Kontrolli i magazinës dhe vlerave materiale	105
3.2. SEKTORI 2 – PROKURIMI	105
3.2.1. Planifikimi i procedurave të prokurimit	106
3.2.2. Ndjekja e procedurave të prokurimit publik	106
3.2.3. Monitorimi i kontratave	106
3.2.4. Analiza e procedurave të prokurimit	106
3.2.5. Raporti vjetor i prokurimeve	106
3.3. SEKTORI 3 – BURIME NJERËZORE	107
3.3.1. Zbatimi i legjislacionit mbi deklarin e interesave private pasurore dhe konfliktit të interesave	108
i. Subjektet e deklaramit të interesave private pasurore gjatë vitit 2025	108
ii. Konflikti i interesave gjatë vitit 2025	109
3.3.2. Zbatimi i procedurave ligjore në menaxhimin e burimeve njerëzore	109
3.3.3. Sigurimi i burimeve njerëzore dhe zhvillimi i karrierës	109
3.3.4. Mbështetja e njërive organizative	109
3.3.5. Zbatimi i politikave jo-diskriminuese	110
3.3.6. Monitorimi i standardeve të integritetit dhe mbrojtjes së të dhënave	110
3.3.7. Kontributi në hartimin e strukturës dhe organikës	110
3.4. Sektor 4 – Administratë dhe Protokoll	111
3.4.1. Menaxhimi i korrespondencës, arkivit dhe protokollit	111
3.4.2. Programi i Transparencës	112
4. PLANI I VEPRIMIT - VITI 2026	114

0.1 HYRJE

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) është institucioni kryesor publik në Republikën e Shqipërisë që ka për mision zhvillimin, mbështetjen dhe promovimin e kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ajo funksionon në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke luajtur një rol kyç në hartimin dhe zbatimin e politikave për zhvillimin shkencor dhe inovativ të vendit.

AKKSHI kontribuon në forcimin e kapaciteteve kërkimore të institucioneve të arsimit të lartë dhe qendrave kërkimore, nëpërmjet financimit të projekteve, mbështetjes së programeve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe krijimit të urave të bashkëpunimit ndërmjet akademisë, biznesit dhe industrisë. Përmes programeve të saj, Agjencia synon rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor, nxitjen e inovacionit dhe përfshirjen aktive të Shqipërisë në hapësirën evropiane dhe globale të kërkimit.

Struktura organizative e AKKSHI përfshin drejtori dhe sektorë të specializuar, të cilët mbulojnë programet kombëtare, bashkëpunimin ndërkombëtar, menaxhimin financiar, si dhe funksione mbështetëse administrative. Në vitin 2025, Agjencia ka operuar me një strukturë prej 19 punonjësish të miratuar, duke vijuar përpjekjet për rritjen e eficiencës institucionale dhe përmirësimin e proceseve të brendshme.

Në përmbushje të mandatit të saj, AKKSHI menaxhon një gamë të gjerë programesh, duke përfshirë Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit, projektet e infrastrukturës së kërkimit shkencor, programet e teknologjisë dhe inovacionit, si dhe mbështetjen për studimet doktorale dhe përfshirjen e diasporës shkencore.

Gjithashtu, ajo luan një rol të rëndësishëm në koordinimin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në programe ndërkombëtare si Horizon Europe, COST, EUREKA dhe iniciativa të tjera shumëpalëshe.

0.2 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E RAPORTIT PËR VITIN 2025

Raporti vjetor për vitin 2025 paraqet në mënyrë të detajuar aktivitetin, arritjet dhe sfidat e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, duke reflektuar progresin e bërë në drejtim të zhvillimit të kërkimit shkencor dhe inovacionit në Shqipëri.

Gjatë vitit 2025, AKKSHI ka administruar një buxhet të konsiderueshëm të dedikuar për mbështetjen e kërkimit shkencor dhe inovacionit, duke siguruar përdorimin e fondeve në përputhje me parimet e transparencës, eficiencës dhe efektivitetit. Fondet janë alokuar kryesisht për financimin e projekteve kërkimore, programeve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe për mbështetjen e infrastrukturës kërkimore.

Në kuadër të programeve kombëtare, janë financuar një numër i konsiderueshëm projektesh në fusha prioritare si teknologjia e informacionit, shëndetësia, bujqësia, mjedisi dhe shkencat sociale. Proceset e aplikimit, vlerësimit dhe monitorimit janë zhvilluar në përputhje me standardet dhe procedurat e përcaktuara, duke garantuar cilësi dhe objektivitet në përzgjedhjen e projekteve.

Në nivel ndërkombëtar, AKKSHI ka forcuar bashkëpunimin me partnerë strategjikë dhe ka rritur pjesëmarrjen e Shqipërisë në programe evropiane dhe shumëpalëshe. Gjatë vitit 2025 është vërejtur një përmirësim i indikatorëve të pjesëmarrjes në programin Horizon Europe, përfshirë rritjen e numrit të projekteve të suksesshme, fondeve të përfituara dhe pjesëmarrjes së aktorëve shqiptarë në rrjetet kërkimore ndërkombëtare.

Gjithashtu, Agjencia ka vijuar mbështetjen e rrjeteve ndërkombëtare si COST dhe EUREKA, duke kontribuar në rritjen e bashkëpunimit ndërkufitar dhe transferimit

të njohurive. Programet për përfshirjen e diasporës akademike dhe bashkëpunimin akademi-biznes kanë qenë një tjetër fokus i rëndësishëm, duke synuar lidhjen e kërkimit me zhvillimin ekonomik dhe inovacionin praktik.

Në aspektin institucional, AKKSHI ka përmirësuar proceset e brendshme të menaxhimit, përfshirë administrimin financiar, burimet njerëzore dhe procedurat e prokurimit publik, duke garantuar respektimin e legjisllacionit në fuqi dhe standardeve të qeverisjes së mirë.

Megjithatë, gjatë vitit janë evidentuar edhe disa sfida, si mungesa e plotësisht të strukturës së stafit, vonesat në disa procese administrative dhe vështirësitë në realizimin e plotë të disa projekteve infrastrukturore. Pavarësisht këtyre, AKKSHI ka arritur të ruajë një performancë të qëndrueshme dhe të kontribuojë ndjeshëm në zhvillimin e ekosistemit kërkimor dhe inovativ në vend.

Në tërësi, viti 2025 shënon një periudhë konsolidimi dhe zhvillimi për AKKSHI-në, duke reflektuar një angazhim të vazhdueshëm për forcimin e rolit të saj si institucion kyç në mbështetje të kërkimit shkencor dhe inovacionit në Shqipëri.



RAPORT 2025

DREJTORIA E PROGRAMEVE KOMBËTARE

1.1 STRUKTURA, MISIONI, PROGRAMET, PROCESET E PUNËS

Misioni i Drejtorisë së Programeve Kombëtare (DPK) është nxitja e kërkimit shkencor dhe inovacionit nëpërmjet mbështetjes, monitorimit dhe vlerësimit të Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit (PPKZH), të Projekteve të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH), të Projekteve të Teknologjisë dhe Inovacionit (PTI) që vijnë si bashkëpunime të komunitetit të kërkuesve shkencorë nga institucionet e arsimit të lartë në partneritet me industrinë dhe biznesin, Programit të Mbështetjes së Studimeve të Doktoraturës, si dhe administrimi dhe përditësimi i bazës kombëtare të të dhënave për kërkimin shkencor dhe inovacionin.

Drejtoria e Programeve Kombëtare ka në strukturën e saj 2 (dy) sektorë, me staf 1+2 për secilin sektor. Gjatë vitit 2025, DPK ka funksionuar me strukturë të paplotësuar me staf, ndërkohë që ngarkesa e punës është shumëfishuar.

Drejtoria e Programeve Kombëtare (DPK)

- Sektori i Programeve Kombëtare
- Sektori i Teknologjisë dhe Inovacionit

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Programeve Kombëtare (DPK) ka ushtruar një rol qendror në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave dhe instrumenteve financiare në mbështetje të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit në Shqipëri. Veprimtaria e saj është zhvilluar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi dhe dokumentet strategjike kombëtare, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor dhe forcimin e lidhjes ndërmjet sistemit akademik dhe zhvillimit ekonomik të vendit.

Një nga funksionet kryesore të Drejtorisë gjatë këtij viti ka qenë identifikimi dhe përditësimi i fushave prioritare të kërkimit shkencor dhe inovacionit, në përputhje me nevojat zhvillimore të vendit dhe orientimet

strategjike të Ministrisë së Arsimit. Këto fusha kanë shërbyer si bazë për orientimin e financimeve dhe për përcaktimin e prioriteteve në thirrjet për aplikim, duke garantuar një fokus të qartë në sektorë me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.

Në zbatim të mandatit të saj, Drejtoria ka realizuar shpërndarjen e fondeve për programet e kërkimit shkencor mbi bazën e konkurrencës së hapur ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë dhe institucioneve kërkimore. Procesi i financimit është mbështetur në parimet e transparencës, meritokracisë dhe vlerësimit profesional, duke garantuar përzgjedhjen e projekteve me cilësinë dhe impaktin më të lartë. Në këtë kuadër, është siguruar një shpërndarje e balancuar e fondeve në fusha të ndryshme prioritare, duke nxitur diversifikimin dhe zhvillimin e kërkimit shkencor në vend.

Një tjetër komponent i rëndësishëm i veprimtarisë së Drejtorisë ka qenë mbështetja e formimit të kapaciteteve njerëzore përmes financimit të projekteve të studimeve të doktoraturës. Përzgjedhja e këtyre projekteve është realizuar nëpërmjet konkurrencës së lirë dhe mbi bazën e kritereve të përcaktuara, duke synuar zhvillimin e brezit të ri të kërkuesve shkencorë dhe rritjen e cilësisë së kërkimit akademik.

Në aspektin institucional, Drejtoria ka vijuar me administrimin dhe përditësimin e bazës kombëtare të të dhënave për kërkimin shkencor, duke siguruar mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e informacionit mbi projektet e financuara dhe aktivitetin kërkimor në vend. Kjo ka kontribuar në rritjen e transparencës, aksesit në informacion dhe mbështetjen e vendimmarrjes së bazuar në të dhëna.

Gjithashtu, DPK ka luajtur një rol të rëndësishëm në ofrimin e informacionit, rekomandimeve dhe sugjerimeve për Ministrinë e Arsimit dhe institucionet e tjera përgjegjëse, duke kontribuar në hartimin dhe përmirësimin e politikave sektoriale në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit. Në këtë kuadër, Drejtoria ka qenë e angazhuar në procese të rëndësishme ndërinstucionale, përfshirë hartimin e akteve nënligjore dhe raportimeve në kuadër të integritetit evropian.

Veprimtaria e Drejtorisë është karakterizuar gjithashtu nga një komunikim i vazhdueshëm dhe aktiv me institucionet e arsimit të lartë, kërkuesit dhe aktorët e tjerë të sistemit të inovacionit. Nëpërmjet organizimit të sesioneve informuese, konsultimeve dhe shpërndarjes së informacionit, është

synuar rritja e pjesëmarrjes dhe cilësisë së aplikimeve, si dhe përmirësimi i ndërveprimit institucional.

Në tërësi, gjatë vitit 2025, Drejtoria e Programeve Kombëtare ka kontribuar në mënyrë të qëndrueshme në zhvillimin e sistemit të kërkimit shkencor dhe inovacionit në Shqipëri, duke forcuar mekanizmat e financimit, përmirësuar proceset e menaxhimit dhe rritur ndikimin e programeve kombëtare në zhvillimin socio-ekonomik të vendit.

1. Proceset kryesore të punës të kryera gjatë vitit 2025 dhe realizimi i tyre, sipas përshkrimit funksional, kanë qenë si më poshtë:

Aktiviteti i DPK gjatë vitit 2025

Procesi Referenca ligjore	Aktivitetet e kontrollit	Realizimi
1 Vendimi i Bordit për hapjen e thirrjes VKM Nr.607, datë 31.08.2016 "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit". Vendim i BA të AKKSHI	Përgatitja e dokumentacionit për thirrjet e reja; Përgatitja e relacionit për BA për hapjen e thirrjeve	100%
2 Shpallja e thirrjes VKM Nr.607, datë 31.08.2016 "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit". Vendim i BA të AKKSHI Programi Buxhetor Afatmesëm 2024-2026	Publikimi i thirrjeve së bashku me dokumentacionin shoqëruar në Web dhe media sociale; Njoftimi i IAL -ve me email;	100%

	Procesi Referenca ligjore	Aktivitetet e kontrollit	Realizimi
3	Aplikimi nga IAL-të dhe institucionet kërkimore Ligji Nr. 80, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 4, pika 4. Vendim i BA të AKKSHI për hapjen e thirrjeve, Programi Buxhetor Afatmesem 2024-2026	Organizimi i sesioneve informuese për të 4 thirrjet	- 12 sesione informuese online; - 6 ditë të plota informative në IAL dhe institucione të tjera aplikuese, sipas kërkesës
4	Përgatitja e databazës me aplikimet VKM Nr.607, datë 31.08.2016 "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit"	Hedhja e të dhënave të detajuara të të gjitha aplikimeve në excel	168 aplikime PKKZH; 59 aplikime PIKSH; 17 aplikime PTI; 59 aplikime PD; Total: 303 aplikime
5	Shqyrtimi formal i aplikimeve Udhëzuesit e programeve dhe kriteret e thirrjeve	Kontrolli i përmbushjes së kriterëve të aplikimit	303 aplikime të shqyrtura
6	Vlerësimi përmbajtësor nga komisionet e ekspertëve sipas fushave VKM Nr.607, datë 31.08.2016; Udhëzuesit e programeve dhe kriteret e thirrjeve; Skdat e vlerësimit përgatitur nga DPK	Vlerësimi tematik: Bujqësi & Mjedis, Uji & Energji, Shkenca Sociale, Shëndetësi, STI, Bujqësi, Ushqim & Bioteknologji;	303 aplikime të shqyrtura
7	Krijimi i databazës së aplikimeve sipas renditjes bazuar në vlerësimet VKM Nr. 607, datë 31.08.2016; Udhëzuesit e programeve dhe kriteret e thirrjeve; Skdat e vlerësimit	Renditja sipas pikëve dhe përgatitja e listës përfundimtare	100%
8	Përgatitja e relacionit për vendimmarrje VKM Nr.607, datë 31.08.2016 "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit".	Hartimi i relacionit me listën përfundimtare për Bordin	100%
9	Shpallja e listës fituese Vendimi BA Nr. 5, datë 30.04.2025 për PKKZH; Vendim BA Nr. 3, datë 13.03.2025 për PIKSH; Vendim BA Nr. 6 datë 30.04.2025 për PTI; Vendim BA Nr. 12 datë 19.12.2025 për PD;	Publikimi në Web dhe njoftimi me email i fituesve	148 projekte të miratuara për financim; Vlera totale: ALL 615,193,392

	Procesi Referenca ligjore	Aktivitetet e kontrollit	Realizimi
10	Lidhja e kontratave me fituesit dhe alokimi i financimit Vendime BA për financim	Lidhja e kontratës dhe bashkëlidhur saj: buxheti dhe kalendari i aktiviteteve	148 kontrata financimi të lidhura
11	Monitorimi dhe raportimi periodik i ecurisë Udhëzuesit e programeve; Rregullore e brendshme AKKSHI, miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit të AKKSHI-së datë 31.11.2017, neni 28 pika 7 “Shqyrtimi i raporteve vjetore për ecurinë e projekteve në kuadër të Programeve Kombëtare të kërkim zhvillimit”	Shqyrtimi dhe verifikimi i raporteve periodike; Komunikim dhe ndërhyrje në rast problematikash; Rekomandime për plotësimi dhe saktësimi të dokumentacionit.	121 raporte përfundimtare të shqyrtura të PK; 7 PIKSH+PTI në proces plotësimi dhe saktësimi të dok; 24 PKKZH në proces plotësimi dhe saktësimi të dok.
12	Dërgimi i raportit final Udhëzuesit e programeve; Rregullore e brendshme AKKSHI, miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit të AKKSHI-së datë 31.11.2017, neni 28 pika 7 “Shqyrtimi i raporteve vjetore për ecurinë e projekteve në kuadër të Programeve Kombëtare të kërkim zhvillimit”	Shqyrtimi, verifikimi i raporteve finale dhe dokumentacionit shoqërues	- 24 raporte përfundimtare të shqyrtura PIKSH+PTI për vitet 2024 - 2025; - 97 raporte përfundimtare të shqyrtura PKKZH; - Total: 121 raporte përfundimtare
13	Mbyllja realizimit të projekteve Udhëzuesit e programeve; Rregullore e brendshme AKKSHI, miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit të AKKSHI-së datë 31.11.2017, neni 28 pika 7 “Shqyrtimi i raporteve vjetore për ecurinë e projekteve në kuadër të PKZH”	Miratimi i raporteve përfundimtare dhe njoftimi me shkresë zyrtare	17 raporte të miratuar për PIKSH+PTI; 73 raporte finale të miratuara PKKZH; Total: 90 raporte të miratuara
14	Grupe pune për draftimin e VKM në zbatim të ligjit të ri për shkencën Urdhër MAS Nr. 20, datë.16.02.2025	Pjesëmarrje në të gjitha takimet dhe kontribute konkrete	13 grupe pune, 13 draft VKM

	Procesi Referenca ligjore	Aktivitetet e kontrollit	Realizimi
15	<p>Raportimi i të dhënave për kërkimin shkencor dhe inovacionin në Western Balkans Competitiveness Outlook 2025 (OECD)</p> <p>Pika 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të VKM Nr. 621, datë 10.10.2024 "Për miratimin e dokumentit të politikës "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027", në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian "Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor</p>	Pjesëmarrje në të gjitha takimet dhe kontribute konkrete në grupin e punës	100%
16	<p>Plotësimi i pyetësorëve për OECD SME Policy Index 2026</p> <p>Pika 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të VKM Nr. 621, datë 10.10.2024 "Për miratimin e dokumentit të politikës "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027", në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian "Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor</p>	Pjesëmarrje në të gjitha takimet dhe kontribute konkrete në grupin e punës	Urdhër Nr. 178, datë 30.12.2025 Për miratimin e planit të veprimit për përmirësimin e renditjes së Shqipërisë në indeksin e oecd-së për politikën e NMV-ve
17	<p>Plani i veprimit me masa për të siguruar progres që Shqipëria të klasifikohet si një inovator mesatar në tabelën evropiane të rezultateve të inovacionit, me rezultat në përmirësimin e raportimit të shqipërisë për treguesit TEI.</p> <p>Urdhri i Kryeministrit Nr. 142, datë 29.8.2025 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e një plani veprimi me masa për të siguruar progres që Shqipëria të klasifikohet si një inovator mesatar në Tabelën Evropiane të Rezultateve të inovacionit, me rezultat në përmirësimin e raportimit të Shqipërisë për treguesit TEI, në kuadër të dokumentit të politikës "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027</p>	Pjesëmarrje në të gjitha takimet dhe kontribute konkrete në grupin e punës	Urdhër nr. 179, datë 30.12.2025, "Për miratimin e planit të veprimit me masa për të siguruar progres që shqipëria të klasifikohet si një inovator mesatar në tabelën evropiane të rezultateve të inovacionit, me rezultat në përmirësimin e raportimit të shqipërisë për treguesit TEI"

Procesi Referenca ligjore	Aktivitetet e kontrollit	Realizimi
<p>18 Në kuadër të GNPIE-ve Në zbatim të VKM nr.749/2018 janë ngritur gjithashtu dhe GNPIE-të përmes Urdhrit të Kryeministrit Nr. 94, date 20.05.2019. "Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstucionale të punës për integrimin Evropian"</p>	<p>Kontribute periodike në kuadër të: GNPIE Kapitulli 25 "Shkenca dhe Kërkimi Shkencor"; GNPIE Kapitulli 18 "Statistikat"; GNPIE Kapitulli 20: "Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale"</p>	<p>Raporte, raportime, plotësim dokumentesh</p>
<p>19 Të tjera VKM Nr.607, datë 31.08.2016 "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit"</p>	<p>Pjesëmarrje në aktivitete përfaqësuese; Përgatitje raportesh; Kontribut si NCP</p>	<p>100%</p>

1.2 TË DHËNA STATISTIKORE

1.2.1 Financimi

Në kuadër të thirrjeve të hapura për vitin 2025 nga AKKSHI, Institucionet e Arsimit të Lartë, si edhe institucionet publike dhe private që kanë kërkimin shkencor si objekt të veprimtarisë së tyre, kanë paraqitur 303 projekt-propozime.

Aplikimet sipas programeve:

- Projekt-Propozime të Teknologjisë dhe Inovacionit (PTI): 17 aplikime - këto projekte realizohen në bashkëpunim mes universiteteve, bizneseve, industrisë dhe institucioneve publike, duke synuar transferimin e njohurive shkencore drejt aplikimeve praktike dhe zhvillimin e inovacionit në sektorët ekonomikë dhe shoqërorë.
- Projekt-Propozime të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH): 59 aplikime - programi ka përqëllim ngritjen, modernizimin dhe zhvillimin e infrastrukturës kërkimore, duke siguruar mjetet dhe ambientet e nevojshme për realizimin e kërkimit shkencor në nivele të larta.
- Projekt-Propozime të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH): 168 aplikime - ky program mbështet iniciativa kërkimore që synojnë avancimin e njohurive shkencore dhe zhvillimin e teknologjive të reja, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve të kërkimit shkencor në vend.
- Programi i Mbështetjes së Studimeve të Doktoraturës (PD): 59 aplikime - programi synon të forcojë kapacitetet e kërkimit individual përmes mbështetjes së studiuësve të rinj dhe promovimit të shkencës së avancuar në nivel doktore.

Nga këto iniciativa, 148 projekte janë financuar për të katër programet. Vlera totale e financimit për këto projekte arrin në ALL 615,193,392.

Rezultatet e përgjithshme të aplikimeve dhe financimit të projekteve për vitin 2025

Aplikime **303**

Projekte të financuara **148**

Totali i financimit **ALL 615,193,392**


1.2.2 Sipas fushave dhe programeve

Në kuadër të financimit për vitin 2025 në Programin Kombëtar të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH), projektet e mbështetura janë shpërndarë sipas gjashtë (6) fushave prioritare të shpallura nga AKKSHI, duke reflektuar fokusin strategjik në zhvillimin e qëndrueshëm, avancimin teknologjik dhe forcimin e kërkimit shkencor në vend.

Në total janë financuar 73 projekte, me një vlerë totale prej 179,414,201 lekë, duke përfshirë 389 kërkues shkencorë të

angazhuar në këto iniciativa. Shpërndarja sipas fushave prioritare tregon se fusha "Shkencat Sociale dhe Albanologjike" zë peshën më të madhe të projekteve të financuara, duke dëshmuar rëndësinë e studimeve që lidhen me zhvillimin shoqëror, kulturor dhe identitetin kombëtar. Kjo pasohet nga fusha "Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit", duke reflektuar prioritetin e transformimit digjital dhe inovacionit teknologjik.

Financim për vitin 2025 për PKKZH sipas Fushave




Në kuadër të Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH) për vitin 2025, financimi është orientuar drejt forcimit të kapaciteteve kërkimore dhe modernizimit të laboratorëve, pajisjeve dhe platformave teknologjike në institucionet kërkimore dhe akademike.

Në total janë financuar 21 projekte infrastrukture, me një vlerë totale prej 392,980,150 lekë, duke përfaqësuar një investim të rëndësishëm në zhvillimin e bazës materiale dhe teknologjike të kërkimit shkencor në vend.

Shpërndarja sipas fushave prioritare tregon një fokus të veçantë në fushën "Sisteme dhe Teknologjitë e Informacionit", duke reflektuar nevojën për infrastruktura digjitale, laboratorë të avancuar dhe kapacitete përpunimi të të dhënave. Një nivel i lartë investimi është orientuar gjithashtu në fushën e "Biodiversitetit dhe Mjedisit" duke mbështetur ngritjen dhe modernizimin e infrastrukturës kërkimore për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e burimeve natyrore.

Financim për vitin 2025 për PIKSH sipas Fushave




Programi i Projekteve të Teknologjisë dhe Inovacionit (PTI) për vitin 2025 thekson rolin e bashkëpunimit ndërmjet universiteteve, institucioneve kërkimore dhe sektorit privat në zhvillimin e zgjidhjeve inovative me potencial aplikimi në treg.

Në total janë financuar 14 projekte, me një mbështetje totale prej 31,171,963 lekë nga AKKSHI, e cila është shoqëruar nga një bashkëfinancim i sektorit privat prej 16,278,480 lekë, duke dëshmuar angazhimin e sektorit privat në zhvillimin e inovacionit

dhe transferimin e njohurive shkencore drejt praktikës.

Fusha me përfaqësimin më të madh është "Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit", me 8 projekte, duke reflektuar kërkesën e lartë për zgjidhje digjitale, produkte teknologjike dhe shërbime inovative. Projektet e mbetura shpërndahen në mënyrë të balancuar në fusha të tjera prioritare, si shëndetësia, mjedisi, bujqësia dhe energjia, duke treguar një shtrirje ndërsektoriale të teknologjisë dhe inovacionit.



Financim për vitin 2025 për PTI sipas Fushave



Në vitin 2025 u hap për herë të parë thirrja për mbështetjen me fonde të projekteve të studimeve të doktoratës, në kuadër të Programit të Kërkimit Shkencor të administruar nga DPK. Thirrja kishte në fokus temat prioritare të zhvillimit socio-ekonomik të vendit, me theks në qasje ndërdisiplinare që përfshijnë teknologjitë e avancuara, bujqësinë dhe industrinë ushqimore, trashëgiminë kulturore digjitale, ndryshimet klimatike, energjinë, si dhe ndërthurjen e së drejtës me teknologjinë dhe mjedisin.

Në total janë financuar 40 projekte doktorature, me një vlerë prej 11,627,078 lekë, duke përfshirë 80 kërkues. Numri më i lartë i projekteve i përket fushës së "Shëndetësisë dhe Shkencave Mjekësore", e ndjekur nga "Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit".

Financim për vitin 2025 për PD sipas Fushave



1.2.3 Monitorimi


Procesi i monitorimit ka për qëllim kryesor të sigurojë zbatimin efektiv të projekteve të financuara nga AKKSHI dhe të vlerësojë ecurinë e tyre. Ai fokusohet në dy drejtime kryesore:

- Verifikimi i zbatimit të projektit sipas planit të miratuar për financim;
- Shqyrtimi i raporteve periodike dhe përfundimtare të dorëzuara nga drejtuesit e projekteve mbi ecurinë e aktiviteteve dhe realizimin e objektivave të planifikuara.

Është e rëndësishme të theksohet se AKKSHI nuk ka funksion auditimi financiar të fondeve të përfituara nga institucionet e arsimit të lartë, as të procedurave të prokurimit. Për këtë arsye, institucionet përfituese mbajnë përgjegjësi të plotë për ndjekjen e procesit të realizimit të projektit, për respektimin e kuadrit ligjor në fuqi dhe për raportimin në kohë dhe sipas kërkesave të AKKSHI.

Gjatë vitit 2025, DPK ka kryer monitorimin e projekteve të financuara në kuadër të programeve kombëtare sipas viteve të financimit.

Monitorimet sipas programeve të DPK në vite



Nga monitorimi i realizuar kanë rezultuar kryesisht problematikat si më poshtë:

- Raporte përfundimtare që nuk respektojnë formatet e AKKSHI (propozimi narrative, forma financiare, kalendari i aktiviteteve).

- Mungesë ose mosrealizim i produkteve shkencore të planifikuara dhe të miratuara për financim nga AKKSHI.

- Mungesë dokumentacioni në dërgimin e Raportit Përfundimtar.

i. Identifikimi i fushave prioritare

DPK ka kontribuar në identifikimin dhe përditësimin e fushave prioritare të kërkimit shkencor dhe inovacionit, në përputhje me strategjitë kombëtare dhe dokumentet politike sektoriale, të cilat për vitin 2025 janë fokusuar në:

- Shkencat Sociale dhe Albanologjike
- Teknologjitë e Informacionit
- Shëndetësia
- Bujqësia dhe Bioteknologjia
- Biodiversiteti dhe Mjedisit
- Uji dhe Energjia

Identifikimi i fushave prioritare është bërë që në vitin 2017.

ii. Shpërndarja e fondeve për programet e kërkimit

Fondet janë shpërndarë mbi bazën e konkurrencës së lirë ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë dhe institucioneve kërkimore, duke financuar 148 projekte në programet kombëtare me një vlerë totale prej rreth 615 milion lekë.

Gjatë vitit 2025:

- Janë financuar 148 projekte në total
- Vlera totale e financimit: 615,193,392 lekë

Përsëritet informacioni.

iii. Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore

DPK ka kontribuar në proceset e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore në kuadër të detyrimeve ligjore dhe proceseve të integritetit evropian:

- reformave të kërkimit shkencor
- integritetit evropian (Kapitulli 25)
- zhvillimit të indikatorëve të inovacionit

Nuk e bën DPK, ne raportojmë.

iv. Financimi i projekteve të doktoraturës

Në vitin 2025 janë financuar projekte doktrature në institucione të arsimit të lartë, duke mbështetur formimin e brezit të ri të kërkuesve shkencor:

- Janë financuar 40 projekte doktrature
- Në 7 universitete
- Me vlerë totale 11,627,078 lekë

Ky program ka ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin e kapaciteteve kërkimore të brezit të ri.

Duhet vendosur si program tek sektori STI

1.2.4 Aktivitete të tjera të DPK

a. Administrimi i bazës së të dhënave kombëtare

Është vijuar me administrimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave për kërkimin shkencor dhe inovacionin për vitin 2025.

DPK ka:

- ndërtuar dhe përditësuar databazën e projekteve
- administruar të dhënat për 303 aplikime
- siguruar transparencën e projekteve të financuara

b. Transparenca e projekteve të financuara

DPK ka siguruar publikimin dhe administrimin e të dhënave për projektet e financuara në kuadër të programeve kombëtare.

c. Mbështetje për politikëbërjen

Janë ofruar rekomandime dhe kontribute për Ministrinë e Arsimit dhe institucionet e tjera në lidhje me politikat e kërkimit dhe inovacionit.

d. Shpërndarja e fondeve sipas kritereve të miratuara

Financimi është realizuar në bazë të kritereve të miratuara nga Bordi i Administrimit, duke garantuar transparencë dhe meritokraci.

e. Komunikimi dhe shpërndarja e informacionit

Janë organizuar aktivitete informuese dhe komunikim i vazhdueshëm me institucionet përfituese dhe aktorët e sistemit kërkimor.

1.3 VEPRIMTARIA SIPAS SEKTORËVE

1.3.1 SEKTORI I PROGRAMEVE KOMBËTARE

Programi Kombëtar I Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH)

Gjatë vitit 2025, Sektori i Programeve Kombëtare ka zhvilluar një veprimtari të gjerë dhe të strukturuar, duke mbuluar të gjithë ciklin e menaxhimit të projekteve kërkimore, nga hartimi i dokumentacionit dhe organizimi i thirrjeve, deri tek monitorimi dhe raportimi i rezultateve. Aktiviteti i sektorit është zhvilluar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe me standardet e transparencës dhe meritokracisë.

Në përgjigje të Thirrjes për aplikim për projekte të kërkimit dhe zhvillimit, u paraqitën në AKKSHI 168 projekt-propozime në 6 fushat e kërkimit shkencor.

Bazuar në Vendimin Nr. 5, datë 30.04.2025, të Bordit të Administrimit të AKKSHI me lëndë "Për miratimin e financimit të projekteve të PKKZH për vitin 2025", u realizua financimi i 73 projekteve në 6 fushat prioritare të kërkimit dhe zhvillimit.

Vlera e miratuar për financimin e projekteve është 179,414,201 lekë.

Sektori i Programeve Kombëtare ka realizuar të gjitha fazat e ciklit të projekteve:

- Hartimin dhe përditësimin e dokumentacionit të programit;
- Organizimin e thirrjeve dhe sesioneve informuese (12 online dhe 6 fizike);
- Administrimin e 168 aplikimeve;
- Organizimin e procesit të vlerësimit të projekteve nga ekspertë e fushave përkatëse;
- Financimin e 73 projekteve PKKZH, në 6 fushat prioritare të kërkimit dhe zhvillimit;
- Përgatitjen e 73 kontratave të financimit.

i. Hartimi i Dokumentave të Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit

Gjatë vitit 2025, sektori ka hartuar dhe përditësuar dokumentacionin bazë të programeve kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit (PKKZH), duke reflektuar prioritetet strategjike të vendit dhe përvojën e akumuluar nga ciklet e mëparshme të financimit. Dokumentacioni ka përfshirë udhëzuesit e programeve, kriteret e aplikimit, metodologjitë e vlerësimit dhe procedurat administrative, duke synuar rritjen e cilësisë dhe qartësisë së procesit.

ii. Përgatitja e Formularit të Aplikimit

Është realizuar përgatitja dhe përmirësimi i formularëve të aplikimit për projektet PKKZH, duke siguruar një strukturë të standardizuar dhe të plotë për paraqitjen e projekt-propozimeve. Formularët kanë mundësuar një përshkrim të detajuar të objektivave, metodologjisë, planit financiar dhe rezultateve të pritshme të projekteve, duke lehtësuar procesin e vlerësimit.

iii. Takime dhe konsultime

Gjatë vitit janë zhvilluar:

- 12 sesione informuese online
- 6 aktivitete informuese në institucione të arsimit të lartë

Gjithashtu, janë realizuar konsultime të vazhdueshme me drejtuesit e projekteve dhe përfaqësuesit e institucioneve për përmirësimin e procesit të aplikimit dhe zbatimit të projekteve.

iv. Shqyrtimi formal i projekt-propozimeve

Gjatë vitit janë administruar dhe shqyrtuar 168 aplikime në kuadër të PKKZH. Shqyrtimi formal është kryer në përputhje me kriteret e përcaktuara, duke verifikuar përmbushjen e kërkesave administrative dhe dokumentacionin e dorëzuar nga aplikantët.

v. Përgatitja e bazës së të dhënave

Sektori ka ndërtuar dhe përditësuar bazën e të dhënave për të gjitha projekt-propozimet, duke përfshirë informacion të detajuar mbi aplikantët, fushat kërkimore, vlerësimet dhe statusin e projekteve. Kjo databazë ka shërbyer si një instrument i rëndësishëm për analizë, raportim dhe vendimmarrje.

vi. Organizimi i procesit të vlerësimit

Procesi i vlerësimit është organizuar në mënyrë të strukturuar dhe transparente, duke përfshirë ekspertë të fushave përkatëse. Vlerësimi është realizuar mbi baza tematike dhe sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzuesit e programeve, duke garantuar objektivitet dhe cilësi në përzgjedhjen e projekteve.

vii. Përgatitja e Urdhrit për financim

Në përfundim të procesit të vlerësimit, sektori ka përgatitur dokumentacionin për vendimmarrje dhe urdhrat përkatës për financimin e projekteve fituese. Në total janë financuar 73 projekte PKKZH, me një vlerë prej 179,414,201 lekë.

viii. Përgatitja e kontratave të financimit

Për të gjitha projektet fituese janë përgatitur dhe lidhur kontratat e financimit, të shoqëruara me:

- planin financiar
- kalendarin e aktiviteteve
- detyrimet kontraktuale të palëve

ix. Analiza e ecurisë së projekteve

Sektori ka kryer analiza të detajuara mbi ecurinë e projekteve të financuar, duke vlerësuar:

- përmbushjen e objektivave dhe rezultateve të pritshme
- përdorimin e fondeve sipas planit financiar
- përputhshmërinë me afatet e zbatimit


Nga kjo analizë është evidentuar se një pjesë e projekteve kanë pasur nevojë për plotësim dhe saktësim të dokumentacionit, ndërsa pjesa më e madhe ka ecur sipas planifikimit.

Tabelat më poshtë tregojnë statistika në mënyrë të përmbledhur për 73 projektet e financuara në kuadër të PKKZH 2025.

Nr. i projekteve të financuara, për institucionet publike, jo-publike dhe institucione të tjera sipas fushave të aplikimit

	Projekte	IAL Publike	IAL Jo-Publike	Institute QTTB	Akad. e Shkencave
Biodiversiteti dhe Mjedis	01	8	6	2	-
Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia	02	9	9	-	-
Sisteme dhe Teknologji Informacioni	03	17	13	3	1
Shëndetësia dhe Shkencat mjekësore	04	12	7	3	1
Shkencat Sociale dhe Albanologjike	05	23	18	4	-
Uji dhe Energjia	06	4	4	-	-
TOTALI	73	57	12	1	3


Raporti i projekteve të financuara sipas fushave




Raporti i projekteve të financuara sipas fushave



Vlera e financimit sipas fushave




Raporti i financimit institucione publike – jopublike, qendra, institute



Numri dhe vlera e projekteve të financuara sipas institucioneve

Institucioni	Projekte	Vlera e financuar
01 Universiteti i Tiranës	14	34,590,816
02 Universiteti Politeknik i Tiranës	12	31,007,999
03 Universiteti Bujqësor i Tiranës	8	21,269,268
04 Universiteti i Arteve	2	6,574,816
05 Universiteti i Sporteve	2	4,374,677
06 Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan	8	13,549,120
07 Universiteti " Fan S. Noli", Korçë	2	2,825,331
08 Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër	2	4,281,780
09 Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastër	1	1,436,980
10 Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	3	5,368,636
11 Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	3	6,698,429
12 Akademia e Shkencave	3	12,379,152
13 Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët	1	1,261,748
14 Universiteti Katolik "Zoja e Keshillit te Mire"	2	5,985,005
15 Universiteti Polis	1	3,583,353
16 Universiteti "New York Tirana"	2	3,827,102
17 Universiteti European i Tiranës	2	4,880,500
18 Universiteti Barleti	2	6,544,861
19 Universiteti Mesdhetar	1	2,422,908
20 Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjise"	1	3,397,960
21 Western Balkans University	1	3,153,760
TOTALI	73	179,414,201

. Raporti i drejtuesve të projekteve femra-meshkuj



Raporti i drejtuesve të projekteve femra-meshkuj sipas fushave

Biodiversiteti dhe Mjedis	01	75%	6	2	25%
Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia	02	44%	4	5	55%
Sisteme dhe Teknologji Informacioni	03	82%	14	3	18%
Shëndetësia dhe Shkencat mjekësore	04	58%	7	5	42%
Shkencat Sociale dhe Albanologjike	05	65%	15	8	35%
Uji dhe Energjia	06	75%	3	1	25%
TOTALI			49 Femra	24 Meshkuj	

1.3.2 SEKTORI I TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

Gjatë vitit 2025, Sektori i Teknologjisë dhe Inovacionit ka ushtruar një rol të rëndësishëm në nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet kërkimit shkencor dhe zhvillimit ekonomik, duke promovuar transferimin e njohurive dhe teknologjive nga institucionet akademike drejt industrisë dhe sektorit privat. Aktiviteti i sektorit është fokusuar në administrimin e projekteve të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH) dhe Projekteve të Teknologjisë dhe Inovacionit (PTI), të cilat zhvillohen si bashkëpunime të komunitetit të kërkuesve shkencorë nga institucionet e arsimit të lartë në partneritet me industrinë dhe biznesin, si dhe në administrimin e Programit të Mbështetjes së Studimeve të Doktoraturës. Gjithashtu, sektori merret me regjistrimin e gradave shkencore dhe titujve akademikë.

i. Projekt e Infrastrukturës së kërkimit shkencor

Në kuadër të thirrjes për aplikim për projekte të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor për vitin 2026, në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit u paraqitën 59 projekt-propozime, nga të cilat 43 në Tiranë dhe 16 në rrethe, nga 11 IAL publike.

AKKSHI, bazuar në vendimin Nr. 3, datë 13.03.2025 të Bordit të Administrimit, "Për miratimin e financimit të projekteve fituese të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor, për vitin 2025 dhe 2026", ka miratuar financimin për 21 projekte të shpallura fituese, për 10 Universitete Publike të vendit me një total prej 392,980,150 lekë.

Tabelat më poshtë tregojnë statistika në mënyrë të përmbledhur për 59 projekt-propozimet e paraqitura në kuadër të thirrjes PIKSH 2025.

Nr. i aplikimeve sipas IAL-ve

Universiteti	Nr. i projekteve aplikuese
01 Universiteti Politeknik i Tiranës	12
02 Universiteti i Tiranës	12
03 Universiteti Mjekësisë Tiranë	7
04 Universiteti Bujqësor i Tiranës	4
05 Universiteti i Arteve	6
06 Universiteti i Sporteve të Tiranës	1
07 Akademia e Sigurisë	1
08 Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër	6
09 Universiteti "Ismael Qemali," Vlorë	7
10 Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"	2
11 Universiteti "Fan S. Noli", Korçë	1
TOTALI	59 Projekte

Nr. i aplikimeve sipas fushave prioritare




Në vitin 2025 AKKSHI ka miratuar financimin për 21 projekte të shpallura fituese, me një fond total prej 392,980,150 lekë, ndërsa në vitin 2024 janë financuar 22 projekte në kuadër të programit PIKSH, me një vlerë prej 299,474,016 lekë.

Megjithëse numri i projekteve të financuara në vitin 2025 ka qenë pak më i ulët (-1 projekt), fondi total i akorduar ka shënuar rritje të konsiderueshme. Kjo tregon një rritje të mbështetjes financiare mesatare për projekt.

Më poshtë një krahasim grafik i financimit për vitet 2024 dhe 2025 të programit PIKSH.

Financimi i PIKSH ne vtet 2024 dhe 2025




Tabelat më poshtë tregojnë statistika në mënyrë të përmblodhur për 21 projektet e financuara në kuadër të PIKSH 2025.

Numri dhe vlera e projekteve të financuara sipas universiteteve

Universiteti	Projekte	Financimi i projekteve sipas IAL
01 Universiteti i Tiranës	4	50,098,288
02 Universiteti Bujqësor i Tiranës	3	75,343,702
03 Universiteti Politeknik, Tiranë	5	117,385,003
04 Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	1	50,820,285
05 Universiteti i Sporteve i Tiranës	1	22,622,123
06 Universiteti i Arteve	2	17,113,400
07 Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"	1	18,900,000
08 Universiteti "Fan S. Noli", Korçë	1	2,860,700
09 Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër	2	27,316,649
10 Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	1	10,520,000
TOTALI	21	392,980,150


Raporti i drejtuesve të projekteve femra-meshkuj



Vlera e financimit sipas fushave



Raporti i financimit sipas fushave



Në vitin 2025 nga 21 projekte të financuara 9 prej tyre nuk arritën të realizojnë procedurat për ngritjen e laboratorëve brenda vitit të financimit.

Problematikat kryesore të raportuara si arsye për mosrealizimin ishin:

- dështimi i procedurave të prokurimit për shkak të mosparaqitjes së operatorëve ekonomikë,
- pasaktësitë në parashikimin e fondit nga grupet e punës së projekt-propozimeve,
- fondet e pamjaftueshme si pasojë e ndryshimeve të çmimeve në treg.

ii. Projekte të Teknologjisë dhe Inovacionit

Në kuadër të thirrjes së shpallur për aplikim për Projekte të Teknologjisë dhe Inovacionit për Vitin 2025, projekte që vijnë si bashkëpunim i Universiteteve me Biznesin/ Industrinë, janë paraqitur në AKKSHI 17 projekt-propozime.


AKKSHI, bazuar në Vendimin Nr. 6 datë 30.04.2025, të Bordit të Administrimit, ka financuar 14 projekte fituese të Teknologjisë dhe Inovacionit, me vlerë totale financimi ALL 31,171,963 , shpërndarë në 3 Universitete Publike dhe në 4 Universitete Private të vendit në 6 fusha prioritare të kërkimit shkencor për vitin 2025.

Tabelat më poshtë tregojnë statistika në mënyrë të përmbledhur për 14 projektet e financuara në kuadër të PTI 2025.


Numri dhe vlera e projekteve të financuara sipas universiteteve

Universiteti	Projekte PTI	Financimi i projekteve sipas IAL
01 Universiteti i Tiranës	3	9,259,300
02 Universiteti Politeknik i Tiranës	1	1,460,554
03 Universiteti i Sporteve të Tiranës	1	2,177,756
04 Kolegji Universitar i Biznesit	1	2,019,971
05 Tirana Busines University	3	4,753,260
06 Universiteti Barleti	4	7,843,522
07 Universiteti Metropolitan Tirana	1	3,657,600
TOTALI	14	31,171,963

Raporti i pjesëmarrjes së institucioneve publike – jopublike




Raporti i drejtuesve të projekteve femra-meshkuj



Vlera e financimit sipas fushave

Fusha	Projekte	Vlera e financimit (në lekë)
Biodiversiteti dhe Mjedisi	01	1,931,160
Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia	02	3,109,660
Sisteme dhe Teknologji Informacioni	03	17,439,883
Shëndetësia dhe Shkencat mjekësore	04	3,867,706
Shkencat Sociale dhe Albanologjike	05	3,363,000
Uji dhe Energjia	06	1,460,554
TOTALI	14	31,171,963

Raporti i financimit sipas fushave



Projektet fituese të financuara në vitin 2025, vijojnë të kryejnë aktivitetet për realizimin e tyre.

iii. Programi i Mbështetjes së Studimeve të Doktoraturës

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), për herë të parë në Korrik të vitit 2025 ka shpallur thirrjen për mbështetjen e studimeve të doktoratës.

Programi i Mbështetjes së Studimeve të Doktoratës, i financuar nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) për vitin 2025, ka për qëllim të nxisë kërkimin

shkencor cilësor dhe inovativ në kuadër të studimeve të doktoratës në Shqipëri në gjashtë fushat prioritare të kërkimit shkencor.

Në kuadër të programit të financimit për

mbështetjen e studimeve të doktoratës (kohorta I-rë 2025), thirrjes për aplikim të shpallur nga AKKSHI, i'u përgjigjën 59 aplikime, nga të cilat 57 në IAL publike dhe 2 aplikime në IAL jo-publike.

Me qëllim informimin për thirrjen, shpjegimin e bazës ligjore, kritereve të aplikimit dhe udhëzuesin, për mënyrën e aplikimit, për programin e mbështetjes së studimeve të Doktoratës 2025, DPK organizoi ditë informative me përfaqësues të IAL-ve, staf akademik dhe pjesëmarrës të interesuar.

AKKSHI, bazuar në Vendimin Nr. 12 datë 19.12.2025, të Bordit të Administrimit, ka financuar 40 projekteve fituese të programit të mbështetjes së doktoraturave për vitin 2025, me vlerë totale financimi ALL 11,627,078, në shtatë universitete.

Tabelat më poshtë tregojnë statistika në mënyrë të përmblodhur për 40 projektet e financuara në kuadër të PIKSH 2025.


Numri dhe vlerat e financimit të projekteve të doktoraturës sipas IAL

IAL	Projekte aplikuese	Financimi (në lekë)
01 Universiteti Politeknik i Tiranës	5	1,716,000
02 Universiteti i Tiranës	11	3,019,900
03 Universiteti Mjekësisë Tiranë	16	4,922,848
04 Universiteti Bujqësor i Tiranës	3	742,600
05 Universiteti i Arteve	1	338,000
06 Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	3	673,000
07 Universiteti POLIS	1	214,730
TOTALI	40	11,627,078


Vlera e financimit sipas fushave

	Projekte aplikuese	Vlera e financimit (në lekë)
Biodiversiteti dhe Mjedisi 01	4	1,931,160
Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia 02	2	3,109,660
Sisteme dhe Teknologji Informacioni 03	7	17,439,883
Shëndetësia dhe Shkencat mjekësore 04	21	3,867,706
Shkencat Sociale dhe Albanologjike 05	6	3,363,000
TOTALI	40	11,627,078

Raporti i financimit sipas fushave



Raporti i drejtuesve të projekteve femra-meshkuj



a. Bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë

Sektori ka bashkëpunuar ngushtë me institucionet e arsimit të lartë publike dhe jopublike, duke:

- mbështetur pjesëmarrjen e tyre në projekte inovative
- promovuar lidhjen ndërmjet kërkimit dhe aplikimit praktik

- përfshirë universitete në projektet PTI dhe PIKSH

b. Bashkëpunimi me institucionet publike

Është realizuar bashkëpunim me agjenci dhe institucione publike në linjë, në kuadër të:

- politikave për inovacionin
- zhvillimit të infrastrukturës kërkimore
- koordinimit ndërinstytucional

c. Bashkëpunimi me sektorin privat

Një fokus i veçantë i sektorit ka qenë bashkëpunimi me biznesin dhe industrinë, duke:

- nxitur partneritete ndërmjet universiteteve dhe sektorit privat
- mbështetur projekte me potencial komercial

d. Organizimi i takimeve me universitete

Janë zhvilluar takime dhe aktivitete informuese me universitete dhe institucione kërkimore, me qëllim:

- rritjen e ndërgjegjësimit për programet e inovacionit
- përmirësimin e cilësisë së aplikimeve
- forcimin e bashkëpunimit institucional

e. Raportim për zhvillimin e inovacionit

Sektori ka kontribuar në analizën dhe raportimin e zhvillimit të inovacionit në vend, duke përfshirë indikatorë mbi:

- pjesëmarrjen në projekte
- shpërndarjen e financimit

f. Organizimi i forumeve shkencore

Janë mbështetur dhe organizuar aktivitete dhe forume shkencore që promovojnë inovacionin dhe bashkëpunimin ndër-institucional.

g. Analiza e bashkëpunimit me biznesin

Është analizuar niveli i bashkëpunimit akademi-biznes, duke evidentuar:

- rritjen e projekteve të përbashkëta
- nevojën për më shumë ndërveprim
- potencialin për zhvillim të mëtejshëm

h. Mbështetje për kuadrin ligjor

Sektori ka ofruar mbështetje teknike për:

- përmirësimin e legjislacionit në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit
- harmonizimin me standardet europiane
- zhvillimin e politikave sektoriale

i. Përgatitja e raportit vjetor

Në përfundim të vitit, sektori ka kontribuar në përgatitjen e raportit vjetor, duke reflektuar:

- aktivitetet e realizuara
- rezultatet e arritura
- sfidat dhe rekomandimet për vitet në vijim

Përfundim për Sektorin

Gjatë vitit 2025, Sektori i Inovacionit dhe Transferimit të Teknologjisë ka kontribuar në mënyrë të rëndësishme në zhvillimin e ekosistemit të inovacionit në Shqipëri, duke:

- rritur financimin dhe numrin e projekteve inovative
- forcuar bashkëpunimin akademi-biznes
- përmirësuar mekanizmat e transferimit të teknologjisë

Pavarësisht sfidave të hasura, sektori ka arritur të konsolidojë rolin e tij në mbështetjen e inovacionit dhe në lidhjen e kërkimit shkencor me zhvillimin ekonomik të vendit.

1.4 ANALIZA SWOT E DPK

Pikat e forta	<ul style="list-style-type: none">• Rritja me 2.5 here e buxhetit te financimit për PKKZH• ALL 527,573,747 (EUR 5,460,019) vlere totale e financuar nga AKKSHI ne 4 vite• 278 projekteve te financuara• Shkalle suksesi 53% (Projekte te financuara/Projekte te aplikuar)• 1441 kerkues shhkencore qe kane perfituar financim (nga rreth 2500 qe kane aplikuar)• 337 produkte shkencore te financuara• 1175 kerkues shkencore qe kane botuar ne databaza te indeksuara• 149 artikuj shkencore te financuar, nga te cilet 79 (24%) jane ne databaza te indeksuara• 125 pjesemarrje ne konferenca nderkombetare me Proceeding & Abstract Book• Shperndarje e nr te projekteve te financuara ne institucione publike e jopublike, IAL dhe te tjera (35 projekte IAL jopublike, 21 ASH, etj)• Shperndarje e buxhetit te financimit ne institucione publike e jopublike, IAL dhe te tjera (75,235,204 ALL ne IAL jopublike, 40,408,510 ALL per ASH, etj).
Pikat e dobëta	<ul style="list-style-type: none">• Perthithje jo e plote e fondit te financimit nga projektet aplikuese• Realizim jo i plote i fondit te financuar, rreth 70 %• Planifikim jo i mirë i projektit• Buxhet dhe kosto të fryra / të pamjaftueshme, të pambështetura në një analizë dhe studim paraprak• Numër i madh aktiviteteve përkundrejt kohës dhe mundësive të realizimit• Mungesë lidhjeje dhe koherence midis kalendarit të aktiviteteve dhe buxhetit përkatës për secilin prej tyre• Planifikim botimi i artikujve shkencorë duke mos patur parasysh kohën reale që merr i gjithë procesi• Menaxhim jo i mirë i projektit në fazën e realizimit; Pengesa dhe vonesa ne permbyllje te projekteve• Struktura te kerkimit shkencor/projekteve ne IAL qe nuk funksionojne sic duhet per te orientuar dhe monitoruar projektet e financuara nga AKKSHI dhe per te perballuar fluksin ne rritje• Numer i ulet/i munguar kerkimesh te aplikuar
Mundësitë	<ul style="list-style-type: none">• Rritja e cilesise se projektpropozimeve qe vijne ne AKKSHI; Konceptimi dhe hartimi i projekteve nderdisiplinore; Orientimi nga kerkimi i aplikuar, patenta, inovacioni; Projekte me baze te gjere bashkepunimi• Trajnimi i kerkuesve per shkrim dhe menaxhim projektsh• Trajnimi i strukturave administrative dhe financiare te IAL per realizimin e plote dhe ne kohe te projekteve te financura nga AKKSHI• Funksionim, bashkepunim dhe bashkerendim me i mire i strukturave te kerkimit shkencor ne IAL
Rreziqet	<ul style="list-style-type: none">• Kerkues te patrajnuar per shkrim-menaxhim projektsh kombetare• Struktura shkencore dhe administrartive ne IAL te papergatitura per te perballuar fluksin ne rritje te projekteve qe financohen nga AKKSHI• Mungese bashkepunimi midis kerkuesve per te sjelle propozime nderdisiplinore apo nderinstitucionale

DREJTORIA E PROGRAMEVE NDËRKOMBËTARE

2.1 VEPRIMTARIA KRYESORE E DREJTORISË SË PROGRAMEVE NDËRKOMBËTARE

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Programeve Ndërkombëtare (DPN) ka luajtur një rol strategjik dhe parësor në forcimin e pozicionit të Shqipërisë brenda Hapësirës Evropiane të Kërkimit (ERA) dhe në rrjetet globale të inovacionit. Misioni i kësaj Drejtorie është të promovojë, monitorojë, koordinojë dhe të ofrojë mbështetje të specializuar teknike për bashkëpunimin shkencor dypalësh (bilateral) dhe shumëpalësh (multilateral) me vende partnere, Bashkimin Evropian, si dhe organizata dhe agjenci të huaja.

Veprimtaria e DPN-së gjatë vitit raportues është fokusuar në rritjen e përthithjes së fondeve të huaja dhe zhvillimin e partneriteteve që nxisin shkëmbimin e përvojave, mobilitetin akademik dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore. Përmes një angazhimi të vazhdueshëm në informimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit akademik, Drejtoria ka shërbyer si një katalizator për rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor në vend, duke lehtësuar integrimin e institucioneve shqiptare në rrjetet globale të dijes.

Objektivat Strategjikë dhe Shtyllat e Veprimitarisë

Veprimtaria e Drejtorisë për vitin 2025 është orientuar drejt ndërkombëtarizimit të kërkimit shkencor shqiptar përmes këtyre shtyllave kryesore:

- **Koordinimi i Programeve të Bashkimit Evropian:** Promovimi dhe mbështetja e pjesëmarrjes në programe madhore si Horizon Europe, COST, EUREKA dhe CEEPUS.
- **Asistencë Teknike e Specializuar:** Ofrimi i këshillimit të dedikuar mbi strukturën e aplikimit, identifikimin e partnerëve ndërkombëtarë dhe aspektet financiare për të rritur cilësinë e projekt-propozimeve.

- **Koordinimi i Rrjetit të Pikave Kombëtare të Kontaktit (NCP):** Sigurimi i funksionimit efektiv të rrjetit NCP si mekanizëm kyç për informimin dhe mbështetjen e aplikantëve shqiptarë përmes takimeve periodike dhe shkëmbimit të praktikave më të mira.
- **Monitorimi dhe Analiza e Performancës:** Mbledhja dhe analiza e të dhënave mbi numrin e aplikimeve, projektet e fituara dhe fondet e përfituara për të identifikuar fushat me performancë të lartë dhe sfidat institucionale.
- **Sinergjia Akademi-Biznes:** Nxitja e transferimit të njohurive dhe teknologjisë përmes përfshirjes së sektorit privat në programet ndërkombëtare kërkimore dhe zhvillimit të projekteve të përbashkëta.

Funksionet Operacionale dhe Bashkëpunimi Ndërinstitucional

Drejtorja ka realizuar funksione thelbësore administrative që garantojnë mbarëvajtjen e proceseve kërkimore në nivel kombëtar:

- **Shpërndarja e Informacionit:** Sigurimi i një komunikimi të vazhdueshëm dhe të strukturuar me institucionet e arsimit të lartë dhe qendrat kërkimore mbi mundësitë e financimit.
- **Vlerësimi i Veprimitarisë Kërkimore:** Komunikimi i rezultateve të vlerësimit të institucioneve të arsimit të lartë drejt AKFAL-it, duke shërbyer si bazë për vendimmarrje në shpërndarjen e fondeve dhe përmirësimin e performancës institucionale.
- **Administrimi i Fondeve:** Menaxhim i fondeve të kërkimit përmes thirrjeve për aplikim, vlerësimit të projekt-propozimeve dhe financimit mbi bazën e konkurrencës së hapur.
- **Harmonizimi i Politikave Kombëtare:** Bashkëpunim i ngushtë me ministritë

dhe institucionet publike për zbatimin e strategjisë kombëtare dhe harmonizimin e veprimeve me prioritetet evropiane.

- Raportimi dhe Transparenca: Përgatitja e raportit vjetor, i miratuar nga Bordi i Administrimit, i cili dokumenton aktivitetet, treguesit e performancës dhe rekomandimet strategjike për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.


Struktura Organizative dhe Zhvillimi i Kapaciteteve

Për përmbushjen e këtyre objektivave kompleksë, Drejtoria operon përmes dy sektorëve specialistikë:

1. Sektori i Marrëdhënieve Bilaterale (Dypalëshe): Fokusuar në ndërtimin e kuadrit rregullator dhe operacional të programeve dypalëshe me vende partnere.
2. Sektori i Marrëdhënieve Multilaterale (Shumëpalëshe): Fokusuar në programet e Bashkimit Evropian dhe koordinimin e projekteve ku AKKSHI është përfitues.

Aktualisht, Drejtoria ka një strukturë stafi të përbërë nga 1 drejtor, 2 shefa sektori dhe 2 specialistë për secilin sektor (stafi 1+2 për secilin sektor).

Struktura Organizative



2.1.1 Shpërndarja e informacionit dhe koordinimi i proceseve të aplikimit

Drejtorja ka luajtur një rol kyç në shpërndarjen e informacionit mbi mundësitë e financimit në kuadër të programeve ndërkombëtare, duke siguruar një komunikim të vazhdueshëm dhe të strukturuar me institucionet e arsimit të lartë, qendrat dhe institutet kërkimore në vend. Në këtë kuadër janë realizuar aktivitete informuese, sesione trajnimi dhe shpërndarje e materialeve udhëzuese për programet si Horizon Europe, COST dhe iniciativa të tjera ndërkombëtare.

Njëkohësisht, Drejtorja ka koordinuar proceset e aplikimit, duke ofruar asistencë teknike për aplikantët në përgatitjen e projekt-propozimeve, identifikimin e partnerëve ndërkombëtarë dhe përmbushjen e kërkesave procedurale. Ky proces ka ndikuar në rritjen e cilësisë së aplikimeve dhe në përmirësimin e shkallës së suksesit të institucioneve shqiptare.

2.1.2 Koordinimi i Rrjetit të Pikave Kombëtare të Kontaktit (NCP)

Një komponent i rëndësishëm i veprimtarisë së Drejtorisë ka qenë koordinimi i Rrjetit të Pikave Kombëtare të Kontaktit (NCP) për Programin e BE-së për Kërkimin dhe Inovacionin. Drejtorja ka siguruar funksionimin efektiv të këtij rrjeti përmes:

- koordinimit të aktiviteteve të pikave të kontaktit
- shkëmbimit të informacionit dhe praktikave më të mira
- organizimit të trajnimeve dhe takimeve periodike

Rrjeti NCP ka shërbyer si një mekanizëm kyç për informimin dhe mbështetjen e aplikantëve shqiptarë në programet evropiane.

2.1.3 Komunikimi i vlerësimit të veprimtarisë kërkimore

Drejtorja ka kontribuar në komunikimin e

rezultateve të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe në renditjen e njësive bazë dhe kryesore të institucioneve të arsimit të lartë. Ky informacion i është përcjellë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL), duke shërbyer si bazë për vendimmarrje në shpërndarjen e fondeve dhe përmirësimin e performancës institucionale.

Ky proces ka ndihmuar në rritjen e transparencës dhe në promovimin e konkurrencës ndërmjet institucioneve akademike.

2.1.4 Administrimi i fondeve të tjera të kërkimit shkencor dhe inovacionit

Drejtorja ka administruar fonde të ndryshme në kuadër të programeve ndërkombëtare dhe mekanizmave të tjerë të financimit, duke përfshirë projekte të financuara përmes bashkëpunimeve shumëpalëshe dhe iniciativave të përbashkëta.

Procesi i administrimit është bazuar në:

- shpalljen e thirrjeve për aplikim
- vlerësimin e projekt-propozimeve
- përzgjedhjen dhe financimin e projekteve

Këto fonde janë shpërndarë mbi bazën e konkurrencës së hapur, duke përfshirë subjekte publike dhe jopublike që kanë në fokus kërkimin shkencor dhe inovacionin.

2.1.5 Paraqitja e raportit vjetor pranë Ministrisë së Arsimit

Në përmbushje të detyrimeve institucionale, Drejtorja ka përgatitur raportin vjetor të veprimtarisë së saj, i cili është miratuar paraprakisht nga Bordi i Administrimit dhe më pas i është paraqitur Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Raporti ka përfshirë:

- analizën e aktiviteteve të realizuara

- rezultatet e arritura në programet ndërkombëtare
- treguesit e pjesëmarrjes dhe performancës
- sfidat dhe rekomandimet për përmirësim

2.1.6 Bashkëpunimi ndërinstitucional për zbatimin e strategjisë kombëtare

Drejtoria ka bashkëpunuar ngushtë me ministritë dhe institucionet e tjera publike për zbatimin e strategjisë kombëtare në fushën e shkencës dhe inovacionit. Ky bashkëpunim ka përfshirë:

- koordinimin e politikave sektoriale
- harmonizimin e veprimeve me prioritetet kombëtare dhe europiane
- pjesëmarrjen në grupe pune dhe iniciativa ndërinstitucionale

Ky proces ka kontribuar në rritjen e koherencës së politikave dhe në përmirësimin e koordinimit ndërmjet aktorëve të sistemit.

2.1.7 Nxitja e bashkëpunimit me sektorin e biznesit

Drejtoria ka promovuar dhe mbështetur bashkëpunimin ndërmjet institucioneve kërkimore dhe sektorit privat, duke synuar:

- rritjen e transferimit të njohurive dhe teknologjisë
- zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore
- përfshirjen e biznesit në programet ndërkombëtare

Janë mbështetur iniciativa që lidhin kërkimin shkencor me nevojat e tregut, duke kontribuar në rritjen e ndikimit ekonomik të inovacionit dhe në zhvillimin e një ekosistemi më të integruar kërkim–industri.

2.2 SEKTORI I MARRËDHËNIEVE DYPALËSHE

2.2.1. Sektori 1 – Bashkëpunimi Shkencor

Bashkëpunimi Shkencor

Gjatë vitit 2025, Sektori i Programeve Dypalëshe e thelloi rolin e tij për ndërkombëtarizimin e kërkimit shqiptar. Duke e konsideruar bashkëpunimin shkencor dhe teknologjik me partnerët strategjikë — Kosova, Austria, Italia, Turqia — si një imperativ strategjik, veprimtaria u fokusua në krijimin e një arkitekture rregullatore të sofistikuar. Kjo arkitekturë garanton ekselencën, objektivitetin dhe transparencën e proceseve konkurruese (aplikim, vlerësim, menaxhim), duke e pozicionuar Shqipërinë në trajektoren e integritetit të plotë në Hapësinë Evropiane të Kërkimit (ERA).

Konsolidimi Rregullator dhe Përmirësimi i Standardeve Institucionale

Sektori finalizoi një rishikim të thelluar të gjithë paketës së dokumentacionit, duke forcuar standardet institucionale dhe procedural. Ky konsolidim përfshiu:

- Hartimin dhe dakordësimin e Udhëzuesve të Përbashkët (Call Guidelines) dhe Protokolleve të reja me palët homologe, duke përcaktuar qartë fushat prioritare sipas Strategjisë së Specializimit Inteligjent (S3) (Teknologjitë e Informacionit, Shëndetësia, Bujqësia dhe Mjedisi).
- Përmirësimin e setit të plotë të formularëve të thirrjeve bilaterale: Formulari i Projekt-Propozimit (shqip/anglisht), Udhëzuesi i Përgjithshëm, Plani i Financimit, Dokumenti i Shpenzimeve, Kalendari i Aktiviteteve, Raporti Vjetor dhe Deklarata e Angazhimit.
- Riparjen e Skedës së Vlerësimit për Ekspertët e Jashtëm, e cila u dërgua për shqyrtim dhe miratim në Bordin e Administrimit të AKKSHI, për të siguruar

kritere të qarta, transparente dhe të bazuar në ekselencë.

- Standardizimin e Dokumentacionit të Kontratës dhe Monitorimit, duke garantuar menaxhim efikas financiar dhe përmbushje të detyrimeve kontraktuale.

Zgjerimi i Portofolit Dypalësh dhe Statusi i Thirrjeve

Gjatë periudhës raportuese, Sektori menaxhoi zbatimin aktiv të **16 projekteve** nga Thirrja Shqipëri-Kosovë (2023) dhe shënoi një zgjerim domethënës të portofolit, duke përfshirë:

- **Thirrja Shqipëri-Austri (2026-2028):** U hap pas miratimit të Udhëzuesit të Përbashkët. Ajo qëndroi e hapur deri më 21 Nëntor 2025, duke rezultuar në paraqitjen e **14 projekt-propozimeve**.
- **Thirrja Shqipëri-Turqi (2026-2028):** U shpall në Dhjetor 2025 dhe qëndroi e hapur deri më 17 Mars 2026. Kjo rezultoi në paraqitjen e **40 projekt-propozimeve**.
- **Thirrja Shqipëri-Itali (2026-2028):** Hapja e thirrjes së re bilaterale është planifikuar gjatë vitit 2026, në dakordësim me palën homologe.

Menaxhimi Operacional dhe Monitorimi i Projekteve

Sektori garantoi menaxhimin operacional efikas të projekteve në zbatim. Kjo përfshiu përgatitjen e kontratave dhe një monitorim proaktiv të vazhdueshëm, si dhe shqyrtimin e raporteve përfundimtare. Përmes takimeve dhe konsultimeve të rregullta me drejtuesit e projekteve, u siguroi rritja e eficiencës dhe përmbushje të plotë e detyrimeve kontraktuale nga palët përfituese.

i. Analiza e Programave Bilaterale

Analiza strategjike e performancës së Shqipërisë në bashkëpunimet kërkimore me partnerët strategjikë – Kosovën, Turqinë, Austrinë dhe Italinë – dëshmon një ecuri pozitive. Me një volum prej **mbi 80 aplikimesh/projektsh të angazhuara** në total, thirrjet bilaterale konfirmojnë një interes të lartë nga Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) dhe komuniteti kërkimor kombëtar.

Ky angazhim masiv, i drejtuar kryesisht nga **profesorë dhe studiues me gradë shkencore** (që përbëjnë mbi 85% të drejtuesve të projekteve), konfirmon nivelin e lartë të kapitalit njerëzor dhe pjekurinë e kërkuesve tanë për të udhëhequr iniciativa komplekse. Përtej Tiranës, aktiviteti kërkimor ka një shtrirje të rëndësishme gjeografike, duke përfshirë **6 qytete kryesore** (Durrësi, Shkodra, Elbasani, Vlora, Korça, Gjirokastra), gjë që ndihmon në diversifikimin dhe fuqizimin e kapaciteteve rajonale kërkimore.

Në aspektin tematik, interesimi është përqendruar në mënyrë strategjike në fushat kyçe të Strategjisë së Specializimit Inteligjent (S3). Fushat si **Agrikultura, Ushqimi dhe Bioteknologjia, Biodiversiteti dhe Mjedisi, si dhe Shkenca Sociale dhe Albanologjike** janë dominuese, duke siguruar që investimet bilaterale të jenë të shënjestruara drejt prioriteteve kombëtare.

Qëllimi parësor i këtyre programeve dypalëshe, të konceptuara si **“seed funding” (financim fillestar)**, është ndërtimi i urave të bashkëpunimit ndër-institucional që shërbejnë si faza përgatitore (pre-seeding). Këto projekte mobilizojnë partneritetet mes IAL-ve shqiptare dhe atyre të huaja, duke u ofruar kërkuesve eksperiencën e nevojshme për të formuar konsorciume të suksesshme dhe për të përfituar më pas nga fondet me impakt më të madh të Bashkimit Evropian, si **Horizon Europe**, programet e asistencës si **IPA** dhe programet e rrjetëzimit si **COST** dhe **CEEPUS**. Kështu, veprimtaria bilaterale shërben si një levë kyçe për integrimin e plotë të Shqipërisë në Hapësinë Evropiane të Kërkimit (ERA).


Përmbledhje e Veprimtarisë Bilaterale të Sektorit



Përmbledhje Totale e Projekteve/Aplikimeve sipas Fushave Prioritare

	Kosovë (Financuar)	Turqi (Aplikuar)	Austri (Aplikuar)	Itali (Financuar)	TOTAL
Biodiversiteti dhe Mjedisi	5	7	2	4	18
Agrikulturë, Ushqim dhe Bioteknologji	3	10	4	2	19
Teknologji Informacioni & Sisteme Digjitale	0	7	1	0	8
Shëndetësi dhe Shkenca Mjekësore	3	6	1	2	12
Shkencat Sociale dhe Albanologjike	4	7	1	2	14
Uji dhe Energjia	1	2	4	0	7
Fusha ndërdisiplinore (ICT & Shëndetësi)	0	1	1	0	2
TOTALI	16	40	14	10	80


Përmbledhje Totale e Projekteve/Aplikimeve sipas Fushave Prioritare



Performanca Institucionale (IAL) në 4 Thirrjet Bilaterale

	Kosovë (Fitues)	Turqi (Aplikuar)	Austri (Aplikuar)	Itali (Fitues)	TOTAL
Universitetet dhe institucionet në Tiranë	13	35	12	9	69
Universiteti 'Aleksandër Moisiu' Durrës	1	2	1	0	4
Universiteti i Shkodrës	0	2	0	0	2
Universiteti i Elbasanit	0	1	1	0	2
Universiteti 'Fan S. Noli' Korçë	1	0	0	1	2
Universiteti 'Eqrem Çabej' Gjirokastrë	1	0	0	0	1
Universiteti i Vlorës	0	0	0	0	0
TOTALI	16	40	14	10	80

Performanca Institucionale (IAL) në 4 Thirrjet Bilaterale



a. Bashkëpunimi Shqipëri - Kosovë (Thirrja 2024–2026)

Thirrja bilaterale për bashkëpunim shkencor ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për periudhën 2024–2026 përfaqëson një instrument strategjik në zbatim të marrëveshjes dypalëshe ndërqeveritare ndërmjet MAS dhe MASHTI. Ky program synon jo vetëm forcimin e bashkëpunimit kërkimor, por edhe ndërtimin e partneriteteve afatmesme ndërinstucionale që lehtësojnë integrimin progresiv të komunitetit shkencor mbarëshqiptar në standardet e Hapësirës Evropiane të Kërkimit (ERA). Përmes kësaj nisme, Shqipëria dhe Kosova po koordinojnë politikat e tyre kërkimore për të adresuar sfida të përbashkëta rajonale dhe globale.

Në kuadër të këtij cikli, janë përzgjedhur projekte kërkimore dy-vjeçare të bazuara në konkurrencën e hapur dhe ekselencën akademike. Këto projekte synojnë të prodhojnë ndikim praktik në shoqëri dhe ekonomi, duke shërbyer si “seed funding” për të krijuar bërthama kërkimore që mund të aplikojnë më pas me sukses në programe më të mëdha si Horizon Europe apo COST.

a.1. Fushat prioritare të financimit

Përzgjedhja e projekteve është orientuar drejt pesë fushave strategjike, të cilat përputhen me prioritetet kombëtare të kërkimit dhe Strategjinë e Specializimit Inteligjent (S3). Kjo shpërndarje siguron që investimet kërkimore të kenë vlerë të lartë të shtuar në sektorët ku vendet tona zotërojnë avantazhe konkurruese:

Fushat prioritare të financimit

Fusha prioritare	Projekte
Biodiversiteti dhe Mjedisi 01	5
Agrikulturë, Ushqim & Bioteknologji 02	3
Shëndetësia dhe Shkencat mjekësore 03	3
Shkencat Sociale dhe Albanologjike 04	4
Uji dhe Energjia 05	1
TOTALI	16 Projekte

a.2. Financimi dhe ndikimi buxhetor strategjik


- Çdo projekt mbështetet me një **buxhet maksimal deri në 20,000 Euro në total**, i ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet palëve.
- Kontributi i **AKKSHI për palën shqiptare arrin deri në 10,000 Euro ekuivalent në lekë për projekt**.
- Për vitin 2024, për pjesën shqiptare të financimit është miratuar një fond prej **mbi 10.6 milionë lekësh**, në përputhje me numrin e projekteve të financuara.
- Financimi mbulon shpenzime për veprimtari kërkimore, mobilitet, materiale dhe aktivitete shkencore të përbashkëta.

a.3. Kapitali njerëzor dhe përfituesit

Fuqizimi i kapitalit njerëzor është shtylla kryesore e kësaj thirrjeje. Duke angazhuar grupe pune me mesatarisht 3–5 anëtarë, programi shërben si një platformë për mobilitetin akademik dhe transferimin e njohurive.

- Numri i përfituesve të drejtpërdrejtë (kërkues të angazhuar) varion nga **48 deri në 80 persona** nga të dyja vendet.
- Përfshirja e një game të gjerë profilesh akademike garanton transferim njohurish dhe ndërtim kapacitetesh kërkimore.

Shpërndarja sipas gradave shkencore (drejtues projektsh)



Shtrirja Gjeografike e Aplikantëve

Universiteti / Institucioni	Qyteti	Aplikime
Universitetet dhe institucionet në Tiranë (agregim)	Tiranë	13
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	Durrës	1
Universiteti "Eqrem Çabej"	Gjirokastrë	1
Universiteti "Fan S. Noli"	Korçë	1
TOTALI		16

b. Bashkëpunimi Shqipëri - Turqi (Thirrja 2026–2028)

Thirrja bilaterale për bashkëpunim shkencor dhe teknologjik ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë (2026–2028) është zhvilluar në zbatim të marrëveshjes ndërqeveritare për kërkimin dhe inovacionin, në bashkëpunim me agjencinë homologe turke **TÜBİTAK**. Kjo thirrje përfaqëson një instrument strategjik për forcimin e Programeve dypalëshe në fushën e kërkimit, duke synuar ndërtimin e partneriteteve të qëndrueshme ndër-institucionale dhe rritjen e kapaciteteve kërkimore të institucioneve shqiptare.

Thirrja Shqipëri–Turqi është konceptuar si financim "seed" për projekte kërkimore të përbashkëta, duke pasur objektiva të ngjashme me programet e tjera evropiane, si krijimi i bazës për konsorciume më të gjera dhe aplikime të ardhshme në programe shumëpalëshe evropiane.

b.1. Aplikimet dhe Volumi i Projekt-Propozimeve

Në kuadër të kësaj thirrjeje janë paraqitur gjithsej 41 projekt-propozime të përbashkëta, me kohëzgjatje 24 muaj. Ky volum aplikimesh dhe projektsh e pozicionon thirrjen Shqipëri–Turqi si një nga bashkëpunimet bilaterale më aktive në portofolin e AKKSHI.

b.2. Shpërndarja sipas fushave prioritare

Projektet e financuara janë shpërndarë në përputhje me fushat prioritare të përcaktuara në udhëzuesin e thirrjes dhe në linjë me prioritetet e Strategjisë Kombëtare të Shkencës, Kërkimit dhe Inovacionit 2023–2030.

Kjo shpërndarje dëshmon fokus të veçantë në sektorë me ndikim të drejtpërdrejtë zhvillimor, si bujqësia dhe bioekonomia, mjedisi dhe biodiversiteti, si dhe teknologjitë digjitale dhe shëndetësia.

Fushat prioritare të financimit

Fusha prioritare	Projekte
Biodiversiteti dhe Mjedisi 01	6
Agrikulturë, Ushqim & Bioteknologji 02	10
Teknologji Informacioni & Sisteme Digjitale 03	7
Shëndetësia dhe Shkencat mjekësore 04	6
Shkencat Sociale dhe Albanologjike 05	7
Uji dhe Energjia 06	2
TOTALI	40 Projekte

b.3. Kapitali njerëzor dhe profili akademik

Analiza e kapitalit njerëzor tregon se thirrja Shqipëri–Turqi ka aktivizuar kryesisht burime akademike me përvojë të lartë kërkimore.

Dominimi i profesorëve dhe studiuesve me gradë PhD reflekton një orientim të qartë drejt projekteve me nivel të avancuar kërkimor.

Përfshirja sipas gradave shkencore

Titulli akademik	Numri i përfshirjeve
Profesor	63
Profesor i Asociuar	14
Doktor (PhD)	63
Master (MSc)	10

Shtirja Gjeografike e Aplikantëve

Universiteti / Institucioni	Qyteti	Aplikime
Universitetet dhe institucionet në Tiranë (agregim)	Tiranë	34
Universiteti i Shkodrës	Shkodër	2
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	Durrës	2
Universiteti i Elbasanit	Elbasan	1
Universiteti i Vlorës	Vlorë	1
TOTALI		40

c. Bashkëpunimi Shqipëri - Austri (Thirrja 2026–2028)

Thirrja bilaterale Shqipëri–Austri për projekt-propozime të përbashkëta (2026–2028) zhvillohet në kuadër të Marrëveshjes dypalëshe për Bashkëpunimin Shkencor dhe Teknologjik.

Qëllimi i kësaj thirrjeje është nxitja e bashkëpunimit dypalësh nëpërmjet mobilitetit të kërkuesve shkencorë dhe shkëmbimit të njohurive ndërmjet grupeve kërkimore të dy vendeve, duke kontribuar në ndërkombëtarizimin e kërkimit shqiptar dhe ndërtimin e partneriteteve të qëndrueshme institucionale.

Në këtë kuadër, mbështetja financiare realizohet mbi parimin e bashkëfinancimit të ndarë, duke u përdorur ekskluzivisht për **mobilitetin e kërkuesve shkencorë**.

- Kohëzgjatja e projektit: 2 (dy) vite.
- Shuma maksimale e financimit: deri në 4,000 EUR në vit, ose deri në 8,000 EUR gjithsej për projekt.

c.1. Volumi i Projekt-Propozimeve dhe Shpërndarja Sektoriale

Në kuadër të thirrjes bilaterale Shqipëri–Austri 2026–2028 janë paraqitur **14 projekt-propozime**.

Vërehet një orientim i qartë drejt sektorëve me ndikim të drejtpërdrejtë zhvillimor, si Agrikultura, Ushqimi dhe Bioteknologjia, së bashku me Ujin dhe Energjinë.

Shpërndarja e projekt-propozimeve sipas fushave prioritare

Fusha prioritare	Projekte
Biodiversiteti dhe Mjedisi 01	2
Agrikulturë, Ushqim dhe Bioteknologji 02	4
Teknologji Informacioni & Sisteme Digjitale 03	1
Shëndetësi dhe Shkenca Mjekësore 04	1
Shkencat Sociale dhe Albanologjike 05	1
Uji dhe Energjia 06	4
Fusha ndërdisiplinore (ICT & Shëndetësi) 07	1
TOTALI	14 Projekte

c.2. Kapitali njerëzor dhe profili akademik i drejtuesve të projekteve

Projekt-propozimet janë drejtuar nga kërkues shkencorë me profil akademik të konsoliduar.

Shpërndarja sipas gradave shkencore (drejtues projektesh)

Titulli akademik i drejtuesve (shqiptarë)	Numri
Profesor	5
Profesor i Asociuar	3
Doktor (PhD)	6
TOTALI	14

Shtrirja Gjeografike e Aplikantëve

Universiteti / Institucioni	Qyteti	Aplikime
Universitetet dhe institucionet në Tiranë (agregim)	Tiranë	12
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	Durrës	1
Universiteti i Elbasanit	Elbasan	1
TOTALI		14

d. Bashkëpunimi Shqipëri - Itali

Thirrja bilaterale për bashkëpunim shkencor dhe teknologjik ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë zbatohet në kuadër të marrëveshjes dypalëshe për kërkimin shkencor. Qëllimi është forcimi i kapaciteteve kërkimore, rritja e ndërkombëtarizimit të kërkimit shqiptar dhe krijimi i partneriteteve institucionale të qëndrueshme.

Financimi i projekteve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor, ku pala shqiptare mbulon financimin e pjesës shqiptare, ndërsa pala italiane mbulon pjesën respektive të institucioneve partnere.

d.1. Aplikimet, shpërndarja sektoriale dhe leximi analitik

Në kuadër të marrëveshjes dypalëshe Shqipëri-Itali janë financuar në total **10 projekte kërkimore të përbashkëta**.

Vërehet një përqendrim i projekteve në fusha me ndikim të drejtpërdrejtë mjedisor dhe zhvillimor, me Biodiversitetin dhe Mjedisin si fushën me numrin më të lartë të projekteve.

Shpërndarja e projekteve sipas fushave prioritare

Fusha prioritare	Projekte
Biodiversiteti dhe Mjedisi 01	4
Agrikulturë, Ushqim dhe Bioteknologji 02	2
Shëndetësia 03	2
Shkenca Sociale dhe Albanologjike 04	2
TOTALI	10 Projekte

d.2. Përmbledhje financiare dhe institucionale

Analiza tregon një strukturë të unifikuar të buxhetit, me shumicën e projekteve që kërkojnë rreth 540,950 lekë.

Institucionet përfituese kryesore përfshijnë:

- Universiteti i Tiranës
- Universiteti Bujqësor i Tiranës
- Universiteti Politeknik i Tiranës
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë
- Universiteti "Fan S. Noli" Korçë
- Akademia IVODENT
- Universiteti i Mjekësisë Tiranë

Shpërndarja Institucionale dhe Territoriale

Institucionet përfituese (Orientuese)	Qyteti	Aplikime
UT; UBT; UPT; ASSh; IVODENT; UMT	Tiranë	9
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	Korçë	1
TOTALI		10

ii. Përfundim i përgjithshëm

Strukturimi i të dhënave sipas secilës thirrje tregon qartë se Tirana përbën boshtin kryesor institucional dhe territorial të aplikimeve kërkimore. Njëkohësisht, përfshirja e universiteteve rajonale në Durrës, Shkodër, Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë ofron bazë faktike për politika të synuara drejt forcimit dhe diversifikimit territorial të kapaciteteve kërkimore në Shqipëri.

a. Përgatitja e Udhëzimeve për Programet e Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik Dypalësh

Sektori ka hartuar dhe përditësuar udhëzimet për programet e bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik dypalësh, duke përcaktuar në mënyrë të qartë:

- kriteret e aplikimit dhe përzgjedhjes
- procedurat administrative dhe teknike
- detyrimet e palëve përfituese

Këto udhëzime kanë synuar harmonizimin e proceseve me praktikat ndërkombëtare dhe rritjen e transparencës në menaxhimin e programeve.

b. Përgatitja e drafteve të Protokolleve të Bashkëpunimit

Në kuadër të forcimit të marrëdhënieve ndërkombëtare, sektori ka kontribuar në hartimin e drafteve të protokolleve të bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik me vendet partnere. Këto dokumente kanë

shërbyer si bazë për zhvillimin e programeve të përbashkëta dhe për përcaktimin e prioriteteve të bashkëpunimit.

c. Përcaktimi i fushave parësore të bashkëpunimit

Bazuar në prioritetet kombëtare dhe interesat e përbashkëta me vendet partnere, sektori ka përcaktuar fushat kryesore të bashkëpunimit, duke përfshirë:

- teknologjitë e informacionit
- shëndetësinë
- bujqësinë dhe mjedisin
- energjinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm

Kjo ka mundësuar orientimin e projekteve drejt fushave me ndikim të lartë zhvillimor.

d. Përgatitja e Formularit të Aplikimit

Sektori ka hartuar formularët standardë të aplikimit për projektet dypalëshe, duke siguruar një strukturë të plotë për paraqitjen e:

- objektivave të projektit
- partneriteteve ndërkombëtare
- planit të punës dhe buxhetit

Këto formularë kanë ndihmuar në standardizimin e aplikimeve dhe në lehtësimin e procesit të vlerësimit.

e. Përgatitja e Thirrjeve për Aplikim

Janë përgatitur dhe publikuar thirrjet për aplikim në kuadër të programeve të bashkëpunimit dypalësh, duke siguruar:

- transparencë në shpallje
- akses të barabartë për të gjithë aplikantët
- informim të gjerë të komunitetit kërkimor

f. Organizimi i seminareve dhe trajnimeve

Spektori ka organizuar seminare dhe sesione trajnimi për kërkuesit, me fokus:

- interpretimin e udhëzimeve
- plotësimin korrekt të formularëve të aplikimit
- rritjen e cilësisë së projekt-propozimeve

Këto aktivitete kanë kontribuar në rritjen e kapaciteteve të aplikantëve dhe në përmirësimin e pjesëmarrjes në programet dypalëshe.

g. Ndërtimi i bazës së të dhënave

Është ndërtuar dhe përditësuar baza e të dhënave për të gjitha projekt-propozimet e paraqitura në kuadër të programeve dypalëshe, duke përfshirë:

- të dhëna mbi aplikantët dhe partnerët
- fushat kërkimore
- statusin e aplikimeve

Kjo databazë ka shërbyer si një mjet i rëndësishëm për analizë dhe raportim.

h. Përgatitja e skedave të vlerësimit

Spektori ka hartuar skeda të standardizuara të vlerësimit për projektet dypalëshe, duke përcaktuar kritere të qarta për:

- cilësinë shkencore
- relevancën dhe ndikimin
- kapacitetet e partnerëve

i. Shqyrtimi formal i projekt-propozimeve

Të gjitha projekt-propozimet e paraqitura janë shqyrtuar në aspektin formal, duke verifikuar përbushjen e kriterëve administrative dhe dokumentacionit të kërkuar, si hap i parë për kalimin në fazën e vlerësimit shkencor.

j. Organizimi i misionëve të vlerësimit

Spektori ka organizuar procesin e vlerësimit të projekteve në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, duke përfshirë:

- koordinimin e misionëve të përbashkëta të vlerësimit
- përfshirjen e ekspertëve ndërkombëtarë
- harmonizimin e rezultateve të vlerësimit

Ky proces ka garantuar objektivitet dhe standarde të larta në përzgjedhjen e projekteve.

k. Përgatitja e projekt-planit financiar

Është përgatitur projekt-plani financiar për projektet e përzgjedhura, duke përcaktuar:

- alokimin e fondeve sipas aktiviteteve
- strukturën e shpenzimeve
- kalendarin financiar të projekteve

2.2.2. Spektori 1 – Menaxhimi i Projekteve

i. Përgatitja e kontratave dhe monitorimi

Spektori ka përgatitur kontratat e financimit për projektet dypalëshe dhe ka ndjekur zbatimin e tyre në përputhje me detyrimet kontraktuale, duke garantuar përdorimin korrekt të fondeve dhe realizimin e aktiviteteve të planifikuara.

ii. Takime dhe konsultime

Janë zhvilluar takime dhe konsultime të vazhdueshme me drejtuesit e projekteve dhe institucionet përfituese, me qëllim:

- zgjidhjen e problematikave gjatë zbatimit
- përmirësimin e koordinimit ndërinstitutional
- rritjen e eficiencës së projekteve

iii. Monitorimi i projekteve

Spektori ka realizuar monitorimin e vazhdueshëm të projekteve dypalëshe, duke ndjekur:

- progresin e aktiviteteve

- përmbushjen e objektivave
- respektimin e afateve dhe buxhetit

iv. Shqyrtimi i raporteve vjetore dhe përfundimtare

Janë shqyrtuar raportet vjetore dhe përfundimtare të projekteve, duke vlerësuar:

- rezultatet e arritura
- ndikimin e bashkëpunimit ndërkombëtar
- nivelin e realizimit të objektivave

Ky proces ka shërbyer për përmirësimin e programeve dhe për forcimin e mekanizmave të monitorimit.

Përfundim për Sektorin 1 – Marrëdhëniet Dypalëshe

Përfundim dhe Vizioni Strategjik

Angazhimi i Sektorit të Programeve Dypalëshe gjatë vitit 2025 shënoi një hap transformues, duke tejkaluar menaxhimin operacional. Ky kontribut u përqendrua në tri akse strategjike:

- **Konsolidimi Institucional:** U forcua kuadri rregullator dhe u standardizuan proceset konkurruese (aplikim, vlerësim, monitorim), duke rritur ekselencën dhe transparencën.
- **Integrimi Kërkimor:** U nxit bashkëpunimi ndërkombëtar, duke e pozicionuar kërkimin shqiptar në trajektoren e integritit të plotë në Hapësirën Evropiane të Kërkimit (ERA).
- **Rritja e Kapitalit Njerëzor:** U rrit cilësia e projekteve të përbashkëta dhe u fuqizuan kërkuesit shqiptarë për të udhëhequr iniciativa komplekse ndërkombëtare.

Në tërësi, sektori ka vepruar si një levë kyçe për ndërkombëtarizimin e kërkimit kombëtar dhe për integrimin e tij efektiv në rrjetet globale të dijes.

Vizioni i Zgjerimit Global (2026 e në vazhdim)

Përveç konsolidimit të partneriteteve ekzistuese, Drejtoria po intensifikon punën për një zgjerim strategjik të fushës së bashkëpunimit bilateral me vende që janë epiqendra të inovacionit botëror. Synimi primar mbetet formalizimi i marrëdhënieve kërkimore me fuqitë globale si Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Sh.B.A.), Japonia, Korea e Jugut, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar. Ky vizion zgjerimi dy-palësh synon:

- **Thithjen e Teknologjisë së Lartë:** Integrimin e kërkuesve shqiptarë në projektet më të avancuara të teknologjisë së lartë në nivel botëror.
- **Angazhimin e Diasporës:** Krijimin e mundësive të strukturuar për diasporën shkencore, duke kthyer trurin e saj në një burim katalitik për zhvillimin e brendshëm të kërkimit.
- **Rritjen e Konkurrencës:** Vendosijen e standardeve të reja të ekselencës përmes transferimit të praktikave më të mira nga liderët botërorë të kërkimit shkencor.

2.3 SEKTORI I MARRËDHËNIEVE SHUMËPALËSHE

2.3.1. Sektori i Marrëdhënieve Multilaterale

Sektori i Marrëdhënieve Multilaterale gjatë vitit 2025 ka kryer aktivitetet e mëposhtme:

Projektet ndërkombëtare shumëpalëshe (Horizon Europe, Erasmus, UNICEF, IPA)

Në vitin 2025, Sektori i Marrëdhënieve Multilaterale vazhdoi të ndjekë projektet ndërkombëtare (Horizon Europe, Erasmus, UNICEF dhe IPA) ku AKKSHI është përfitues. Disa të dhëna statistikore mbi ecurinë e këtyre projekteve jepen në vazhdim. Deri në fund të 2025, AKKSHI ka patur 8 projekte ndërkombëtare shumëpalëshe në proces.

Programet e Bashkimit Evropian dhe Organizatat Ndërkombëtare

Gjatë vitit 2025, Sektori i Marrëdhënieve Shumëpalëshe ka zhvilluar një aktivitet intensiv në drejtim të promovimit, koordinimit dhe mbështetjes së pjesëmarrjes së institucioneve shqiptare në programet e Bashkimit Evropian dhe në iniciativat e organizatave ndërkombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit. Veprimtaria e sektorit është fokusuar në rritjen e ndërkombëtarizimit të kërkimit shkencor, përmirësimin e performancës së aplikimeve dhe forcimin e bashkëpunimit shumëpalësh.

Projektet ndërkombëtare ku AKKSHI është përfitues

Titulli i projektit	Institucionet zbatuese	Koordinatori i projektit
1 R&I POLICY making, implementation AND Support in the WEsteRn BalkanS (POLICY ANSWERS)	AKKSHI	Zentrum fur soziale innovation GMBH (ZSI)
2 Transnational network of national contact points (NCPS) for widening participation and strengthening the european research area (NCP_WIDERA.NET)	AKKSHI	NARODOWE CENTRUM BADAN I ROZWOJU (NCBR)
3 SEcurity REsearch NCPs network 5 (SEREN5)	AKKSHI	Agenzia per la promozione della ricerca Europea (APRE)
4 ERA TALENT Platform for career development of researchers in Europe (ERA TALENT)	AKKSHI	Agenzia per la promozione della ricerca Europea (APRE)
5 jOiNEd For sUsTainability - bUiLding climate REsiliEnt communities in WB and EU (1FUTURE)	AKKSHI	UNIVERSITETI I TIRANES
6 University to society collaborations for inclusive digital transformation in the Western Balkans (U2SID)	AKKSHI	UNIVERSETI SHKODRES LUIGJ GURAKUQI
7 ADRION-BlueAir	AKKSHI	Area Science Park
8 UNICEF	AKKSHI	UNICEF

i. PËRMBLEDHJE E PROJEKTEVE NËRËKOMBËTARE KU AKKSHI ËSHTË I PËRFSHIRË

a. Projekti me titull: “R&I POLICY making, implementation ANd Support in the WEsteRn BalkanS”, ose siç njihet nga akronimi i tij “POLICY ANSWERS”, numër projekti: 101058873 (perfundon ne prill 2026)

Fusha: Shkenca sociale

Qëllimi: POLICY ANSWERS mbështet dialogun e politikave duke përfshirë takime zyrtare, monitorim dhe caktim axhende, ngritje kapacitësh dhe implementimin e Axhendës së Ballkanit Perëndimor të Bashkimit Evropian, si dhe bashkërendimin e prioritetëve tematike. Projekti po ashtu implementon veprimtari pilote dhe përmirëson një platformë informuese të bazuar në platformën wbc-rti.info.

Objektivat: Bashkimi i grupeve të interesit në takime të mirëpërcaktuara (platformë drejtuese), duke mundësuar vazhdimësinë dhe mbështetjen organizative dhe hapësirën për koordinim me masa ndjekëse të përshtatshme.

Rezultatet e pritshme:

- Identifikimi dhe hartëzimi i institucioneve, programeve, nismave, nevojave konkrete dhe prioritetëve kryesore në Ballkanin Perëndimor (BP).
- Organizimi i aktiviteteve të dialogut politik dhe krijimi i hapësirës për shkëmbim mbi implementimin e politikave.
- Hartimi i rekomandimeve konkrete për politikëbërësit e rajonit në fushat e kërkimit dhe inovacionit, arsimit, kulturës, rinisë dhe sportit.
- Koordinimi i veprimeve pilot dhe të ngritjes së kapaciteteve (p.sh. skema e

mobilitetit të kërkuesve) në BP që ndikon drejtpërdrejt universitetet, industrinë dhe shoqërinë civile.

- Implementimi dhe ndjekja e kanaleve informuese të përditësuar rregullisht si dhe mjeteve në lidhje me kërkimin, inovacionin, arsimin, kulturën, rininë dhe sportin në BP.

b. Projekti me titull: “TRANSNATIONAL NETWORK OF NATIONAL CONTACT POINTS (NCPS) FOR WIDENING PARTICIPATION AND STRENGTHENING THE EUROPEAN RESEARCH AREA”, akronimi: “NCP_WIDERA.NET”, numër projekti: 101055286 (vazhdon deri ne mars 2027)

Fusha: Shkenca sociale

Qëllimi: NCP_WIDERA.NET ka si qëllim mbështetjen e kapaciteteve dhe efektshmërisë së Pikave Kombëtare të Kontaktit (PKK/NCP) të WIDERA-s duke i dhënë vëmendje kryesore subjekteve me përvojë më të pakët në vende anëtare me performancë të ulët dhe vende të asociuara për të mbushur hendeqet e njohurive në rritjen e aksesit në mundësi financimi nën Programin Kuadër Horizont Evropa.

Objektivat: Identifikimi dhe ndarja e praktikave të mira brenda komunitetit të PKK-ve dhe rritjen e standardeve të shërbimit që PKK-të i japin aplikuesve.

Rezultatet e pritshme:

- Implementimi i suksesshëm i elementëve të “Advancing Europe Package (AEP)” drejt shërbimeve të parakontrollit të propozimeve dhe krijimit të lidhjeve.
- Ofrimi i parakontrollit profesional nga PKK-të e vendeve të zgjerimit për aplikuesit.
- Rritja e rritjes së aplikuesve të

vendeve të zgjerimit në komunitetet e Shtyllës II.

- Organizimi i suksesshëm i aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve të PKK-ve të WIDERA-s duke përfshirë të porsaardhurit.
- Shënjestrim i suksesshëm i klientëve nga vendet e zgjerimit me anë të publikimeve dhe aktiviteteve, kryesisht mbi sinergjitë.
- Shënjestrimi i suksesshëm i klientëve të ERA-s nëpërmjet aktiviteteve dhe publikimeve.
- Hartimi i një axhende bashkëpunimi me partnerët, në veçanti rrjetet e PKK-ve të Shtyllës II
- Komunikimi dhe shpërndarja e gjerë e rezultateve të projektit.

c. Projekti me titull: “SEcurity REsearch NCPs network 5”, akronimi: “SEREN5”, numër projekti: 101073472 [perfunduar ne Dhjetor 2025, ndiqet nga SEREN6 ku jemi partnere]

Fusha: Ndërdisciplinore (Shkenca sociale, Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit, Siguria)

Qëllimi: SEREN5 ka si qëllim kryesor të përmirësojë dhe profesionalizojë aftësitë e Pikave Kombëtare të Kontaktit të Cluster 3 (CL3) në mbarë Evropën, duke thjeshtuar aksesin e aplikuesve në thirrjet e Horizont Evropa (HE) dhe rritjen e cilësisë mesatare të propozimeve të dorëzuara.

Objektivat: Rritja e njohurive të PKK-ve të CL3 për të mbështetur përdoruesit e shërbimeve të tyre, si aplikues në HE, kërkues dhe institucione që veprojnë në fushën e kërkimit dhe inovacionit të CL3.

Rezultatet e pritshme:

- Organizimi i takimeve të rrjetit për CL3

- Rritja e kapaciteteve të PKK-ve nëpërmjet trajnimeve, webinar-eve, forumeve, guidave dhe grupeve mentoruese
- Angazhimi i grupeve të interesit – kryesisht nga vendet e zgjerimit-nëpërmjet trajnimeve, aktiviteteve ndërlidhëse dhe ditëve informuese
- Organizimi i aktiviteteve (trajnimeve) ndërdisiplinore me rrjete të tjerë, si EEN.
- Shpërndarja, shfrytëzimi dhe komunikimi i vazhdueshëm i rezultateve të projektit me anë të mjeteve të ndryshme

d. Projekti me titull: “ERA TALENT Platform for career development of researchers in Europe”, akronimi “ERA TALENT”, numër projekti: 101103476 [perfundon ne 2026, ndiqet nga projekti ERA Talents]

Fusha: Shkenca sociale

Qëllimi: ERA TALENT ka si qëllim të mbështesë implementimin e komunikimit të Zonës Evropiane të Kërkimit (ERA) dhe të zhvillojë më tej shërbimet e dhëna për rrjetin ekzistues EURAXESS.

Objektivat: Mbeshtetja e zhvillimit të karrierës së kërkuesve në Evropë, duke zgjeruar drejtimitet e karrierave të tyre në akademi, industri dhe biznes.

Rezultatet e pritshme:

- Krijimi i pesë platformave tematike që do të veprojnë si shërbime me një ndalesë.
- Formimi i gjashtë Komunitetesh Praktike (Community of Practices).
- Dhënia e shërbimeve të specializuara për menaxhimin e talentit në përmirësimin e marrjes në punë dhe mobilitetit të kërkuesve.
- Krijimi i një kulture më të konsoliduar sipërmarrjeje që hap rrugë të reja karriere për kërkuesit në biznes dhe industri.

e. Projekti me titull: “joiNEd For sUsTainability - bUilding climate REsiliEnt communities in WB and EU”, akronimi: 1FUTURE, numer projekti: 101082815 (perfunduar ne mars 2026)

Fusha: Ndërdisciplinore (Biodiversiteti dhe mjedisi, Shkenca sociale)

Qëllimi: Krijimi i një qasjeje holistike drejt veprimeve klimatike të qëndrueshme.

Objektivat: Objektivi i projektit është në një linjë me « Marrëveshjen e Gjelbër » të BE-së si një projekt që mbështet veprime brenda sistemeve të arsimit të lartë për krijimin e komuniteteve që i rezistojnë ndryshimeve klimatike.

Rezultatet e pritshme:

- Vendosja e qendrave të njohurisë për qëndrueshmëri klimatike brenda çdo IAL-je në vendet e Ballkanit Perëndimor (BP).
- Harmonizimi i kulturës klimatike dhe të qëndrueshmërisë brenda IAL-ve të vendeve të BP.
- Rritja e ndërgjegjësimit të stafit dhe komunitetit studentor për nevojat për aksion klimatik brenda IAL-ve.
- Përmirësimi e sinergjive ndërmjet universiteteve, biznesit dhe qeverisë për implementimin e nismave të përbashkëta për klimën dhe qëndrueshmërinë.
- Forcimi i rrjetëzimit dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve të stafit dhe studentëve në IAL-të e BE-së dhe BP-së për veprimet mbi klimën dhe qëndrueshmërinë.

f. Projekti me titull: “The European Biodiversity Partnership” Akronimi: Biodiversa+

Qëllimi: Biodiversa+ është Partneriteti Evropian për Biodiversitetin që mbështet kërkimin shkencor mbi biodiversitetin me ndikim në politika dhe shoqëri.

ii. PROGRESI DHE POZICIONIMI STRATEGJIK I SHQIPËRISË NË “HORIZON EUROPE”

Ky dokument është hartuar me synimin për t'i ofruar Ministrit një informacion lidhur me progresin dhe pozicionimi strategjik të Shqipërisë në “HORIZON EUROPE” dhe e prezanton vendin si një partnere të maturuar që ka kaluar nga pjesëmarrja pasive në rolin e koordinatores së projekteve ndërkombëtare, duke vënë në pah rezultatin prej 7.69 milion € financim neto.

Hyrje

Bashkimi European ka financuar dy programe madhore për kërkim dhe inovacion: Horizon 2020 (2014–2020) dhe Horizon Europe (2021–2027). Shqipëria, si vend i asociuar, ka marrë pjesë në të dyja programet duke siguruar fonde, rritje të pjesëmarrjes dhe përfshirje të ekspertëve shqiptarë në vlerësim projekteve.

Horizon Europe është programi kryesor i Bashkimit European për kërkimin dhe inovacionin për periudhën 2021–2027, i cili mbështet zhvillimin e projekteve shkencore, teknologjike dhe bashkëpunimin ndërkombëtar mes universiteteve, instituteve kërkimore dhe sektorit privat. Shqipëria është e asociuar në këtë program, duke vijuar angazhimin e saj në programet kuadër të BE-së dhe duke përfutur akses të plotë në të gjitha thirrjet dhe instrumentet e tij, në kushte të barabarta me vendet anëtare. Ky status përbën një mundësi të rëndësishme për forcimin e kapaciteteve kërkimore dhe për integrimin në Hapësirën Europiane të Kërkimit (ERA).

Marëveshja për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Horizon Europa 2021-2027 është ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me ligjin Nr. 47/2022, “Për ratifikimin e Marrëveshja Ndërkombetare ndërmjet Këshillit të

Ministratve të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian, Horizont Evropa-Programi kuadër për kërkimin dhe inovacionin”.

Megjithatë marëveshja është nënshkruar në maj 2022, efektet e saj kanë filluar në janar 2021, me fillimin e ciklit 7 vjeçar të Programit Kuadër “Horizon Europe” 2021-2027.

Shqipëria paraqitet në takimin e Komitetit të Përbashkët (JCM) në Bruksel si një partnere e maturuar dhe kontribuese aktive në programin “Horizon Europe”. Ky pozicionim është rrjedhojë e një transformimi të thellë ligjor dhe strukturor që ka mundësuar integrimin e kërkimit shkencor shqiptar në standardet e Bashkimit Evropian, duke shënuar kalimin e suksesshëm nga një pjesëmarrje pasive drejt rolit të koordinatores strategjike të projekteve me impakt evropian. Ky progres dëshmohet nga përfitimi i **7.69 milion €** financim neto dhe arritja e statusit të Koordinatorit në konsorciume ndërkombëtare, siç është projekti RE-ENGAGE, ku institucionet tona udhëheqin partnerë nga vendet anëtare të BE-së.

Vizioni ynë për periudhën 2026-2027 synon konsolidimin e kësaj “autostrade ligjore” përmes modernizimit të infrastrukturës digjitale, duke siguruar aksesin në rrjetet GEANT dhe fuqinë llogaritëse HPC. Ky hap teknologjik, i shoqëruar me objektivin për të rritur pjesëmarrjen e sektorit privat në 25%, synon ta shndërrojë dijen shkencore në një motor real të zhvillimit ekonomik. Me një kapital njerëzor ekselent, ku spikat përfaqësimi prej 80% i grave kërkuese, Shqipëria rikonfirmon vullnetin e saj politik për të qenë një nyje strategjike e inovacionit dhe një partnere e besueshme në Hapësirën Evropiane të Kërkimit (ERA).

a. Shqipëria në Horizon Europe

Shqipëria është një vend plotësisht i asociuar në programin kryesor të kërkimit dhe inovacionit të BE-së, Horizon Europe. Ky status i jep Shqipërisë një pozicion të privilegjuar ekuivalent me shtetet anëtare të BE-së për sa i përket pjesëmarrjes.

Sfondi i politikave

Shqipëria merr pjesë në programet e BE-së për Kërkim dhe Inovacion që nga viti 2008. Aktivitetet vjetore të Shqipërisë në Programet Kornizë Evropiane për Kërkim dhe Inovacion kanë qenë në rritje që nga viti 2014. Marrëveshja e Asociimit me Shqipërinë, e cila siguron pjesëmarrjen e saj në Programin Kornizë Horizont Evropë, hyri në fuqi më 30 maj 2022. Marrëveshja zbatohet me efekt prapaveprues nga 1 janari 2021.

Në kuadër të Horizont Evropës, Shqipëria është veçanërisht aktive në pjesën e programit të Zgjerimit, në grupin 6 (Ushqimi, Bioekonomia, Burimet Natyrore, Bujqësia dhe Mjedisit), grupin 2 (Kultura, kreativiteti dhe shoqëria gjithëpërfshirëse) dhe grupin 1 (Shëndeti). Shqipëria është e angazhuar në mënyrë aktive në krijimin e një sistemi qeverisjeje të Kërkim dhe Inovacionit për ta sjellë atë në përputhje me prioritetet e ERA-s. Pjesëmarrja e rritur ndjeshëm në veprimet COST mbështet krijimin e rrjeteve shkencore. Strategjia e Specializimit të Mençur u miratua në fund të vitit 2024 dhe do të forcojë më tej ekosistemin kombëtar të kërkimit dhe inovacionit të Shqipërisë.


Asociimi i Shqipërisë me Horizont Evropë përfundon shoqërimin e ekonomive të Ballkanit Perëndimor në program. Është gjithashtu një nga rezultatet kryesore të Axhendës së Ballkanit Perëndimor për Kërkimin, Inovacionin, Arsimin, Kulturën,

Rininë dhe Sportet. Ai nënvizon rëndësinë që do të luajë bashkëpunimi në fushën e kërkimit dhe inovacionit në të ardhmen dhe fuqinë transformuese të politikave të Kërkimit dhe Inovacionit në përshpejtimin e ndjekjes së tranzicionit të gjelbër dhe atij dixhital.

Mundësi financimi



Horizon Europe është programi kryesor i financimit të BE-së për kërkimin dhe inovacionin me një buxhet prej 95.5 miliardë eurosh në dispozicion gjatë 7 viteve (2021 deri në 2027).

Të dhënat kryesore:







Pjesëmarrja:



Participations by region (NUTS 2)




Top organisations



Top Collaborations

Collaboration links in the projects where Albania is involved



R&D landscape:



b. Pozicionimi Strategjik dhe Transformimi i Kuadrit Ligjor (2023-2026)

Marëveshja monitorohet në vazhdimsi gjatë gjithë periudhës 7 vjecare, mbi baza partneriteti duke përfshirë Komisionin Evropian dhe Shqipërinë.

Për të ushtruar këtë funksion, "Marrëveshja Ndërkombetare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian, Horizont Evropa-Programi kuader për kërkimin dhe inovacionin" në nenin 8 të saj parashikon ngritjen e një "Komiteti i përbashkët BE-Shqipëri për kërkim dhe inovacion" i cili ka detyrat si me poshtë:

a) vlerësimin dhe rishikimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, në veçanti:

- i. pjesëmarrjen dhe performancën e personave juridikë të Shqipërisë në Programin Horizont Evropa,
- ii. nivelin e hapjes (reciproke) ndaj personave juridikë të vendosur në secilën Palë për të marrë pjesë në programe dhe projekte të Palës tjetër;
- iii. zbatimin e mekanizmit të kontributit financiar dhe mekanizmit automatik të korrigjimit në përputhje me nenet 3 dhe 4;
- iv. shkëmbimin e informacionit dhe shqyrtimin e pyetjeve të mundshme mbi përdorimin e rezultateve, përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale;

b) diskutimin me kërkesë të secilës Palë të kufizimeve të aplikuara ose të planifikuara nga Palët për qasjen në programet e tyre kërkimore dhe inovative, përfshirë në veçanti për veprimet që lidhen me asetet, interesat, autonominë ose sigurinë e tyre strategjike;

c) shqyrtimin e mënyrës së përmirësimit dhe zhvillimit të bashkëpunimit;

d) diskutimin e përbashkët rreth orientimeve dhe përparësive të politikave të ardhshme lidhur me kërkimin dhe inovacionin dhe planifikimin e kërkimit me interes të përbashkët;

e) shkëmbimin e informacionit, ndër të tjera, mbi legjislacionin e ri, vendimet ose programet kombëtare të kërkimit dhe inovacionit që janë të rëndësishme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Në këtë kuadër, takimi i përbashkët EU-Albania Horizon Europe Joint Research and Innovation Committee është kthyer tashmë në një praktikë të përvitshme, duke u zhvilluar një herë në vit dhe në mënyrë të alternuar midis Shqipërisë dhe Brukselit. Ky takim shërben si një hapësirë dialogu mes përfaqësuesve të Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, ku diskutohet progresi i arritur dhe identifikohen mënyrat për të përmirësuar më tej performancën e vendit, jo vetëm në Horizon Europe, por në përgjithësi në sistemin e kërkimit dhe inovacionit, në përputhje me prioritetet e ERA.

Përgjatë tre viteve të fundit, Shqipëria ka ndërmarrë një reformë rrënjësore të ekosistemit të kërkimit dhe inovacionit, me synimin e qartë për t'u rreshtuar krahas vendeve me performancën më të lartë në "Horizon Europe". Ky proces transformimi nuk është kufizuar vetëm në ndryshime administrative, por ka synuar krijimin e një baze institucionale solide që garanton konkurrueshmërinë e kërkuesve tanë në nivel evropian. Konsolidimi i këtij kuadri ligjor shërben si premisë kryesore për rritjen e qëndrueshme të financimeve dhe forcimin e lidhësive shkencor të Shqipërisë në rajon

c. Reforma Ligjore si Garanci për Standardet e Ekselencës

Statusi i asociimit të Shqipërisë në Horizon Europe mbështetet mbi një bazë ligjore të modernizuar, e cila shërben si garanci për partnerët tanë ndërkombëtarë:

- **Ligji i Ri për Kërkimin Shkencor:** Ky ligj ka krijuar struktura të reja drejtuese dhe një bazë institucionale më të qëndrueshme, duke siguruar që kërkimi shkencor të shërbejë si motor i vërtetë zhvillimi ekonomik dhe shoqëror.
- **Ligji për Arsimin e Lartë:** Ky kuadër integron kërkimin shkencor si shtyllë obligative për universitetet, duke nxitur ndërkombëtarizimin dhe pjesëmarrjen aktive të akademisë në konsorciumet më të rëndësishme evropiane.
- **Harmonizimi me ERA (European Research Area):** Shqipëria ka përfunduar plotësisht politikat kombëtare me prioritetet e ERA-s, duke lehtësuar lëvizshmërinë e kërkuesve tanë dhe duke garantuar aksesin e hapur në të dhëna (Open Science).

duke siguruar që aplikimet në Horizon Europe të jenë të shënjestruara dhe jo rastësore.

e. Rezultatet e Reformave dhe Objektivat e Inovacionit

Zbatimi i këtij kuadri ka krijuar një "autostradë ligjore" që po përkthehet në rezultate të matshme financiare dhe politike:

- Deri në mars 2026, janë përfituar 7.69 milion € financim neto nga BE, një rritje domethënëse që dëshmon rritjen e kapaciteteve absorbuese të institucioneve tona.
- Për periudhën 2026-2027, mbetemi të angazhuar për rritjen e impaktit të sektorit privat, duke targetuar një pjesëmarrje prej 25% të SME-ve në projektet e inovacionit.

d. Dokumentet Strategjike: Vizioni "Shqipëria 2030"

Qasja e re ndaj Kërkimit dhe Zhvillimit (R&D) nuk është thjesht administrative, por udhëhiqet nga një vizion i qartë politik i shprehur në dy dokumente kyçe:

- **Strategjia Kombëtare (SKSHI 2023-2030):** Ky dokument orienton investimet drejt fushave me vlerë të lartë të shtuar dhe parashikon rritjen progresive të buxhetit kombëtar për R&D në përputhje me objektivat e BE-së.
- **Strategjia e Specializimit Inteligjent (S3):** Përmes kësaj metodologjie, janë identifikuar sektorët ku Shqipëria zotëron avantazh konkurrues (si Bioekonomia, Energjia dhe Turizmi i Qëndrueshëm),

f. Krahasimi Horizon 2020 vs Horizon Europe

Performanca e Shqipërisë në "Horizon Europe" dëshmon kalimin nga një pjesëmarrje sasiore drejt një **përfitimi cilësor dhe impakti strategjik**.

Rezultatet e Shqipërisë në Horizon 2020 (2014–2020)

Në programin Horizon 2020, Shqipëria ka arritur këto rezultate:

Rezultatet e Shqipërisë në Horizon 2020 (2014–2020)

Treguesit	Horizon 2020 (2014–2020)
Kontributi neto i BE-së	5.81 milion euro
Grantet e nënshkruara	48
Pjesëmarrje	53
Pjesëmarrje unike	38.89%
Norma e suksesit	7.39 %
Propozime të pranueshme	450
Aplikime totale	568
Ekspertë shqiptarë	24 (30.56% gra)
MSCA	4 pjesëmarrje

Tipet e organizatave kryesore që kanë përfituar fonde ishin universitetet, institucionet kërkimore, organizatat publike dhe sektori privat.

Rezultatet e Shqipërisë në Horizon Europe (2021–2027)

Në programin Horizon Europe, shifrat e vitit 2025 konfirmojnë se reformat ligjore dhe strukturore po prodhojnë një kthesë organike: Shqipëria nuk operon më si një partner periferik, por si një aktor që konkuron me sukses për fonde ekselence, duke injektuar deri më tani 7.69 milion Euro direkt në ekosistemin kombëtar të kërkimit, me një shkallë suksesi rreth 11 përqind. Të dhënat e mëposhtme pasqyrojnë vëllimin financiar dhe efikasitetin teknik të angazhimit kombëtar:

Rezultatet e Shqipërisë në Horizon Europe (2021–2027)

Treguesit	Horizon Europe (2021–2027)
Kontributi neto i BE-së	7.69 milion euro
Grantet e nënshkruara	48
Pjesëmarrje	61
Pjesëmarrje unike	38.89%
Norma e suksesit	11 %
Propozime të pranueshme	450
Aplikime totale	568
Ekspertë shqiptarë	24 (30.56% gra)
MSCA	4 pjesëmarrje

Këto shifra tregojnë një trend pozitiv dhe pritet që numri i projekteve fituese të rritet ndjeshëm deri në mbylljen e programit.


Krahasimi Horizon 2020 vs Horizon Europe
Krahasimi mes dy programeve tregon një rritje të qartë të fondeve të përthithura, të pjesëmarrjes dhe të përfshirjes së ekspertëve shqiptarë. Ndërkohë që H2020 përfundoi me 5.81 milion €, Horizon Europe tashmë ka tejkaluar këtë nivel dhe pritet të rritet edhe më tej. Pjesëmarrja e universiteteve dhe instituteve kërkimore mbetet dominante, por gjithashtu është rritur edhe përfshirja e sektorit privat.

Tabela Krahasuese: Horizon 2020 vs Horizon Europe

Tabela Krahasuese: Horizon 2020 vs Horizon Europe

Treguesit	Horizon 2020 (2014–2020)	Horizon Europe (2021–2027)
Kontributi neto i BE-së	5.81 mln euro	7.69 mln euro
Grantet e nënshkruara	48	48
Pjesëmarrje	53	61
Pjesëmarrje unike	38.89%	38.89%
Norma e suksesit	7.39%	11%
Propozime të pranueshme	450	450
Aplikime totale	568	568
Ekspertë shqiptarë	24 (30.56% gra)	4 (30.56% gra)
MSCA	4 pjesëmarrje	4 pjesëmarrje

Tipet e organizatave pjesëmarrëse në Horizon Europe:



Pjesëmarrja në MSCA

Në Horizon 2020, Shqipëria ka pasur 4 pjesëmarrje në skemën Marie Skłodowska-Curie Actions (MSCA). Ndërsa në Horizon Europe deri tani janë arritur 5 pjesëmarrje. Kjo tregon një trend pozitiv të përfshirjes së studiuesve shqiptarë në programet ndërkombëtare të mobilitetit.


Mobiliteti i kërkuesve përbën një element të rëndësishëm të këtij angazhimi. Ai realizohet jo vetëm përmes Horizon Europe, por edhe përmes programit COST, ku Shqipëria ka një pjesëmarrje shumë aktive, me 577 pjesëmarrje dhe mbi 2100 angazhime në working groups. Veçanërisht pozitive është përfaqësimi i lartë i grave, rreth 80 përqind, si dhe përfshirja e konsiderueshme e kërkuesve të rinj. Mobiliteti mbështetet gjithashtu edhe përmes marrëveshjeve bilaterale me Turqinë, Italinë, Kosovën dhe Austrinë.

Organizatat Kryesore Pjesëmarrëse

Në të dy programet, një rol kryesor kanë luajtur universitetet dhe institucionet kërkimore. Më poshtë paraqiten disa nga organizatat shqiptare me pjesëmarrjen më të lartë në projektet e financuara: Krahasimi i Fondeve të Përfituara nga Organizatat Kryesore



Grafiku më poshtë paraqet krahasimin e fondeve të përfituara (në milionë euro) nga organizatat kryesore shqiptare në programet Horizon 2020 dhe Horizon Europe.

Krahasimi i fondeve te perfituara nga organizatat kryesore



Tipet e Organizatave

Grafikët më poshtë tregojnë shpërndarjen e fondeve sipas tipologjisë së organizatave në Shqipëri për secilin program Horizon.



Përfundime dhe Rekomandime

Shqipëria ka shënuar një progres të dukshëm nga H2020 në Horizon Europe. Duke qenë se Horizon Europe do të vazhdojë edhe për më shumë se dy vite, pritshmëritë janë që numri i fituesve dhe fondet e përthithura të rriten edhe më tej. Rekomandohet që të intensifikohet pjesëmarrja në thirrjet e ardhshme, të forcohen kapacitetet institucionale dhe të rritet bashkëpunimi ndërkombëtar.

g. Performanca Teknike: Rezultatet e Shqipërisë në Horizon Europe (2021–2027)

Gjatë vitit 2025 në veçanti, vihet re një vazhdim i këtij trendi pozitiv, si në pjesëmarrje ashtu edhe në cilësi. Një zhvillim shumë i rëndësishëm është fakti që për herë të parë në Horizon Europe, Shqipëria ka arritur të ketë edhe projekte të fituara ku institucionet shqiptare kanë rolin e koordinatorit. Kjo përfaqëson një hap cilësor përpara dhe një tregues të rritjes së kapaciteteve për të udhëhequr konsorciume ndërkombëtare.

Vihet re gjithashtu një rritje e pjesëmarrjes së universiteteve dhe organizatave kërkimore, duke reflektuar një angazhim në rritje të këtyre institucioneve në program. Megjithatë, përfshirja e sektorit privat mbetet ende e kufizuar dhe përbën një nga sfidat kryesore për periudhën në vijim.

Projektet me pjesëmarrje shqiptare janë përqendruar kryesisht në fusha si bioekonomia, burimet natyrore, klima, shëndetësia dhe shoqëria, ndërsa në nivel programi një pjesë e konsiderueshme lidhet me skemat e "Widening Participation" dhe "Excellent Science". Përfshirja në shtyllën "Innovative Europe" mbetet ende e ulët, duke treguar nevojën për një orientim më të fortë drejt inovacionit dhe tregut.

g.1. Fondet e disbursuara për Shqipërinë:

2021 - 0 Euro. Nuk ka kontribut duke qenë se marrëveshja kuadër është firmosur në vitin 2022 me efekt prapaveprues;
 2022 - 1,94 milion Euro
 2023 - 1,97 milion Euro
 2024 - 2,15 milion Euro
 2025 - 970,1 mijë Euro
 2026 - 160,3 mijë Euro

Institucionet kryesore përfituese:

1. Universiteti i Tiranës ~1.15 milion €
2. Co-PLAN Institute for Habitat Development ~928,000 €
3. Qendra e Kërkimeve Shkencore ~668,000 €
4. Partnerë të shoqërisë civile / organizata profesionale ~589,000 €
5. RASH ~463,000 €
6. AKKSHI & institucione publike ~370,000 €
7. Universitete të tjera publike ~312,000 €

Sipas sektoreve:

- 40% e pjesëmarrjes është nga universitetet dhe institucionet e arsimit të lartë.
- 30% janë nga institucione kërkimore dhe akademike.
- 30% bizneset

g.2. Fushat/clusters që kane perthithur me shumë fonde:

1. Zgjerimi dhe perhapja e ekselences (Widening participation and spreading excellence) - 2,69 milione Euro
2. Shëndeti (Health) - 1,45 milion Euro
3. Kultura, kreativiteti dhe gjithëpërfshirja (Culture, creativity and inclusive society) - 699,81 mijë Euro
4. Marie Skłodowska Curie Actions (MSCA) - 682,97 mijë Euro

5. Ushqimi, Bioekonomia, Burimet Natyrore, Bujqesia dhe Mjedisi (Food, Bioeconomy, Natural Resources, Agriculture and Environment) - 599,17 mije Euro
6. Infrastruktura kerkimore (Research Infrastructure) - 533,96 mije Euro
7. Siguria Civile (Civil Security for Society) - 220,34 mije Euro
8. Klima, Energjia, Mobiliteti (Climate, Energy and Mobility) - 146,21 mije Euro
9. Reforma dhe zhvillimi i sistemit european te Kerkimit dhe Inovacionit (Reforming and enhancing the European R&I system) - 127,44 mije Euro
10. Digital, Industry and Space (Digital, Industry and Space) - 25,38 mije Euro

g.3. Aktoret/institucionet qe kane perthithur me shume fonde:

1. Universiteti i Tiranës - 1,15 milion Euro
2. Co-PLAN/ Universiteti POLIS - 920,38 mije Euro
3. Qendra e Shëndetit dhe Mirëqenies Komunitare - 668,02 mije Euro
4. Partnerë në Zgjidhje dhe Zhvillim (Partners Albania) - 580,74 mije Euro
5. Rrjeti Akademik Shqiptar RASH/INCO - 460,77 mije Euro

Projektet Horizon Europe janë kryesisht te bazuar në konsorciume.

20 - Projekte te tipit CSA (Coordination and Support Action)

11 - Projekte te tipit RIA (Research and Innovation Actions)

8 - Projekte te tipit IA (Innovation Actions)

1 - Projekt te tipit Cofund Actions - aplikues i vetem qe eshte pergjegjes per ngritjen dhe financimin e projekteve nderkombetare, secili me konsorciumet e tyre,

1 - Projektet te tipit MSCA Doctoral Networks

1 - Projektet te tipit MSCA Doctoral Networks - Industrial Doctorates

2 - Projekte te tipit MSCA Staff Exchanges

Kategoritë e përfituesve shqiptarë ndahen në:

- Institucione të Arsimit të Lartë (IAL);
- Institucione publike;
- Organizata jofitimprurëse;
- Subjekte private;
- Institute kërkimore.

(sipas Horizon Dashboard)

g.4. Liderishi Shkencor: Kalimi në Statusin e Koordinatorit

g.4.1. Dinamika Sektoriale: Shtylla e Arsimit të Lartë dhe Sfida e SME-ve

Analiza e pjesëmarrjes sipas aktorëve nxjerr në pah një asimetri që kërkon ndërhyrje strategjike:

- **Pjesëmarrja Institucionale:** Universitetet dhe organizatat kërkimore mbeten motori kryesor, duke reflektuar angazhimin e shtuar pas reformave në Arsimin e Lartë.
- **Sektori Privat:** Përfshirja e bizneseve (SME) mbetet ende e kufizuar dhe është identifikuar si sfida kryesore për periudhën në vijim.
- **Fokusimi Tematik:** Projektet janë përqendruar në Bioekonomi, Burimet Natyrore, Klimë, Shëndetësi dhe Shoqëri.
- **Ekselencia Gjimore:** Shqipëria shënon një rekord me **80% pjesëmarrje të grave** dhe kërkuesve të rinj në programet e mobilitetit (COST).

g.4.2. Qasja Strategjike: Integrimi i Ekosistemit Kërkimor dhe Sektorit Privat

Analiza e performancës evidenton nevojën për një kalim nga kërkimi i izoluar akademik drejt një sistemi të integruar inovacioni. Për këtë arsye, qasja e re e Shqipërisë (bazuar në Ligjin e Kërkimit Shkencor dhe Strategjitë SKSHI e S3) synon fuqizimin e bashkëpunimit Akademi-SME përmes:

- **Rishikimit të Ligjit për Arsimin e Lartë:** Integrimi i mekanizmave që lehtësojnë transferimin e teknologjisë dhe krijimin e “spin-off”-eve universitare.
- **Sinergjisë së Fondeve:** Përdorimi i fondeve kombëtare si “seed money” për të nxitur konsorciumet e përbashkëta Universitet-SME që synojnë thirrjet ndërkombëtare, veçanërisht në shtyllën “Innovative Europe”.
- **Nxitjes së Inovacionit:** Orientimi i thirrjeve të AKKSHI drejt projekteve që dëshmojnë bashkëpunim real mes kërkuesve dhe industrisë, duke rritur kështu impaktin e kërkimit në treg.

g.4.3. Projektet me Koordinim Shqiptar

Viti 2025 shënon një kthesë cilësore për Shqipërinë: kalimin nga një partner kontribues në një **Koordinator** të konsorciumeve ndërkombëtare. Ky status dëshmon se institucionet tona kanë arritur maturinë e nevojshme administrative dhe shkencore për të menaxhuar grante komplekse evropiane.

Shqipëria numëron aktualisht projekte ku institucionet vendase udhëheqin partnerë nga e gjithë Evropa:

- **Projekti: RE-ENGAGE** (Re-Engaging with Neighbours in a State of War and Geopolitical Tensions)
 - **Koordinatori:** Universiteti Evropian i Tiranës (UET).
 - **Fokusi Strategjik:** Ky projekt analizon proceset e zgjerimit të BE-së dhe kohezionin social në kushtet e tensioneve gjeopolitike.
 - **Pesha e Lidërshipt:** Si koordinator, institucioni shqiptar menaxhon një konsorcium prej mbi 10 partnerësh nga vendet anëtare (përfshirë Gjermaninë, Italinë dhe Norvegjinë), duke mbajtur përgjegjësinë totale për

menaxhimin financiar dhe shkencor.

- **Projekti: POLICY ANSWERS**

- **Roli i AKKSHI:** Institucioni luan një rol kyç koordinues në paketat e punës (Work Packages) që lidhen me zbatimin e agjendës së Hapësirës Evropiane të Kërkimit (ERA) në Ballkanin Perëndimor.
- **Objektivi:** Ky projekt shërben si urë lidhëse për harmonizimin e politikave kombëtare të kërkimit me standardet evropiane.

g.4.4. Ekspertiza dhe Kapitali Njerëzor (Experts & COST)

Lidërshipti shqiptar mbështetet në rritjen e vazhdueshme të kompetencave teknike:

- **Ekspertë Vlerësues:** Numri i ekspertëve shqiptarë që vlerësojnë projektet e Komisionit Evropian është rritur në **30**.
- **Programi COST (Rrjetëzimi):** Shqipëria është jashtëzakonisht aktive me **577 pjesëmarrje** dhe mbi **2,100 angazhime** në grupe pune (Working Groups).
- **Ekselencia Gjimore:** Një aset i fortë reputacional është përfaqësimi i lartë i grave kërkuese (rreth **80%**) dhe përfshirja e kërkuesve të rinj.

g.4.5. Roli i AKKSHI në Fuqizimin e Lidërshiptit

Gjatë vitit 2025, AKKSHI ka intensifikuar mbështetjen për të kaluar nga aplikimet sasiore në ato cilësore:

- Janë organizuar mbi **30 aktivitete** informuese dhe trajnimi specifik për universitetet dhe SME-të.
- Trajnimet janë fokusuar në shkrimin e propozimeve për pozicione drejtuese, gjë që ka kontribuar direkt në rritjen e ndërgjegjësimit për rolin e koordinatorit.

g.4.6. Sinergjitë Bilaterale si Platformë Bashkëpunimi

Kapacitetet drejtuese mbështeten edhe përmes marrëveshjeve bilaterale me partnerë strategjikë si **Turqia, Italia, Kosova dhe Austria**. Këto marrëveshje shërbejnë si "seed-funding" për të krijuar bërthamat kërkimore që më pas aplikojnë me sukses si koordinatorë në Horizon Europe. Statusi i koordinatorit është prova më e qartë se Shqipëria ka kaluar fazën e asistencës dhe tashmë kontribuon aktivisht në udhëheqjen e kërkimit shkencor në Evropë.

h. Vizioni Strategjik: Drejt një Ekosistemi Kërkimor Digjital dhe Konkurrues

Shqipëria nuk e konsideron më pjesëmarrjen në "Horizon Europe" si një proces thjesht përfitues, por si një instrument parësor për transformimin strukturor të vendit. Vizioni ynë bazohet në kalimin e pakthyesëm nga kërkimi akademik i izoluar drejt një sistemi të integruar, ku shkenca dhe inovacioni prodhojnë vlerë të shtuar ekonomike dhe zgjidhje teknologjike të avancuara për shoqërinë.

1. Modernizimi i Infrastrukturës dhe Aksesit në Teknologjinë e Avancuar

Qeveria shqiptare është e angazhuar në rritjen progresive të investimeve në Kërkim dhe Zhvillim (R&D) përmes zbatimit të kuadrit të ri ligjor dhe Strategjisë Kombëtare SKSHI 2023-2030. Ky angazhim financiar shoqërohet me integrimin e plotë në rrjetin **GÉANT**, i cili i siguron akademisë shqiptare aksesin e domosdoshëm në **HPC (High-Performance Computing)**. Ky hap jo vetëm që fuqizon kapacitetet llogaritëse të kërkuesve tanë në fusha komplekse, por e pozicionon Shqipërinë si një njeje strategjike në digjitalizimin e shkencës në nivel rajonal.

2. Sinergjia Akademi-SME: Inovacioni si Motor i Rritjes Ekonomike

Sfida jonë kryesore mbetet thyerja e barrierave mes laboratorëve dhe tregut për të rritur pjesëmarrjen në shtyllën "Innovative Europe". Përmes rishikimit të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe zbatimit të Strategjisë së Specializimit Inteligjent (S3), synohet krijimi i një mjedisi që lehtëson transferimin e teknologjisë dhe nxit universitetet të operojnë si qendra inovacioni përmes "spin-off"-eve në bashkëpunim me SME-të. Ky orientim garanton që kërkimi shkencor të shndërrohet në produkte dhe shërbime me avantazh konkurrues, veçanërisht në sektorët e Bioekonomisë, Klimës dhe Energjisë.

3. Kapitali Njerëzor: Aseti ynë Strategjik

Shqipëria zotëron një kapital njerëzor që konkurron në kushte të barabarta me vendet anëtare të BE-së. Përfaqësimi prej rreth **80% i grave** në programet e mobilitetit (COST) përbën një rekord unik reputacional për vendin tonë. Arritja e statusit të Koordinatorit në projekte prestigjioze si RE-ENGAGE vërteton se institucionet shqiptare kanë tashmë maturinë administrative dhe shkencore për të udhëhequr axhendën evropiane.

i. Angazhimi Politik dhe Objektivat Operacionalë 2026-2027

Për periudhën vijuese, janë përcaktuar objektiva të matshëm që reflektojnë vullnetin e palëkundur për integrim të plotë në Hapësirën Evropiane të Kërkimit (ERA):

- **Fuqizimi Financiar:** Angazhim për një rritje prej **+20% të buxhetit kombëtar për R&D**, duke mbështetur drejtpërdrejt implementimin e Strategjisë Kombëtare SKSHI 2023-2030.

- **Lidershipi Shkencor:** Synohet gjenerimi i mbi 15 projekteve të reja me rol koordinues, duke u mbështetur në suksesin e konsoliduar të projekteve si RE-ENGAGE dhe POLICY ANSWERS.
- **Transformimi i Tregut:** Targetohet një pjesëmarrje prej 25% e SME-ve në projektet kërkimore, përmes rishikimit të kuadrit ligjor dhe nxitjes aktive të bashkëpunimit akademi-industri.

Drejt një Partneriteti Strategjik dhe Integrimi Cilësor

Konsolidimi i kornizës institucionale dhe modernizimi i infrastrukturës kritike digjitale dëshmojnë se Shqipëria nuk është më një aspirante në kërkim të asistencës, por një partnere e maturuar që ofron ekselencë dhe stabilitet. Ne jemi gati të rrisim shpejtësinë e integritit, duke kërkuar një bashkëpunim strategjik që e pozicionon vendin tonë si një aktor kyç dhe të besueshëm në arkitekturën teknologjike të Evropës së nesërme. Ky progres dëshmon pjekurinë e institucioneve tona për të operuar në kushte të barabarta me vendet anëtare, duke kontribuar aktivisht në sovranitetin shkencor të kontinentit.

Ky transformim shkon përtej arritjeve teknike; ai përbën një rikonfirmim të ambicies sonë kombëtare për ta shndërruar inovacionin në motorin parësor të rritjes ekonomike dhe mirëqenies shoqërore. Përmes investimeve strategjike në burimet njerëzore dhe infrastrukturën e avancuar, Shqipëria po ndërton një ekosistem ku dija shkencore shërben si urë lidhëse mes aspiratave tona kombëtare dhe standardeve më të larta evropiane.

Në këtë tryezë të përbashkët të JCM-së, Shqipëria prezantohet me besimin e plotë se shkenca dhe kërkimi ynë janë tashmë pjesë organike e familjes evropiane. Ne mbetemi të

vendosur për të udhëhequr nisma me impakt rajonal dhe kontinental, të gatshëm për të ofruar kontributin tonë në adresimin e sfidave të përbashkëta gjeopolitike dhe teknologjike. Rruga jonë drejt Bashkimit Evropian kalon përmes ekselencës shkencore dhe ne jemi plotësisht të përgatitur për këtë kapitull të ri të bashkëpunimit cilësor.

Ditët informative

Që nga firmosja e marrëveshjes kuadër "Horizon Europe" janë kryer gati 200 aktivitete informuese me aktorë të ndryshëm që operojnë në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit.


Gjatë vitit 2025, NASRI ka intensifikuar aktivitetet për rritjen e kapaciteteve, duke organizuar mbi 30 aktivitete informuese dhe trajnime për universitete, SME dhe institucione të tjera të interesuara për programet europiane. Këto përpjekje kanë kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe përgatitjes për aplikime në projekte të ndryshme të Horizon Europe

Burimi i informacionit:

https://dashboard.tech.ec.europa.eu/qs-digit/dashboard_mt/public/extensions/RTD_BI_public_HE_Country_Profile/RTD_BI_public_HE_Country_Profile.html?Country=AL

iii. RRJETI COST

Rrjeti COST (European Cooperation in Science and Technology) është një organizatë që financon rrjetet e kërkimit shkencor dhe teknologjisë. Aksionet COST ndihmojnë në krijimin e lidhjeve midis nismave kërkimore në mbarë Europën dhe më tej dhe i mundëson kërkuesve dhe individëve inovatorë që të zhvillojnë dhe rrisin idetë e tyre në çdo fushë të shkencës dhe teknologjisë duke i ndarë me të ngjashmit e tyre.



COST 2025 në rang ndërkombëtar

Thirrja e Hapur e COST ne vitin 2025 mori numrin më të lartë të propozimeve ndonjëherë, duke shënuar një rritje prej 29% krahasuar me vitin 2024. Më shumë se 50,000 propozues kryesorë dhe dytësorë morën pjesë në Thirrjen e Hapur, dhe për herë të parë, të 42 vendet anëtare të COST u përfaqësuan si propozues kryesorë. Kjo pjesëmarrje e gjerë tregon se COST vazhdon të shërbejë si një platformë e besueshme dhe e arritshme për studiuesit dhe inovatorët në të gjithë Evropën dhe më gjerë.

U ruajt një ekuilibër i fortë gjinor, dhe 55% e propozimeve kombinonin dy ose më shumë fusha shkencore, duke konfirmuar se bashkëpunimi midis disiplinave tani është normë dhe jo përjashtim.

Në vjeshtën e vitit 2025, COST lançoi 70 Veprime të reja. Këto rrjete të reja pasqyrojnë parimet thelbësore që përcaktojnë COST.

37% e propozuesve kryesorë vijnë nga Vendet e Synuara të Gjithëpërfshirjes, duke përforcuar angazhimin për të zgjeruar pjesëmarrjen në të gjithë Evropën. Një në tre propozues kryesorë është një studiues ose novator i ri, duke siguruar që brezi i ardhshëm të luajë një rol udhëheqës në formësimin e axhendave të kërkimit.

48% e propozuesve kryesorë janë gra, dhe më shumë se gjysma e Veprimeve të reja janë ndërdisiplinore.

Vlera e COST reflektohet gjithashtu në reagimet nga komuniteti ynë. Në vitin 2025, 89% e pjesëmarrësve në Veprimin COST njihnin rolin thelbësor të COST në përhapjen e njohurive shkencore dhe teknologjike. 87% deklaruan se COST mundëson përparime shkencore, ndërsa 86% konfirmuan se pjesëmarrja përmirëson karrierat e hulumtuesve të rinj.

2025 IN NUMBERS

Country participation




37

CO27 Annual Report 2025

2025 IN NUMBERS

Proposers profile per country



CO27 Annual Report 2025

38

COST 2025 Shqipëria

Shqipëria është pjesëtar me të drejta të plota të COST që nga viti 2018 dhe që atëherë ka patur një angazhim gjithnjë e në rritje, siç pasqyrohet më poshtë.


Në krahasim me vitin 2024, totali i buxhetit të rimbursuar nga COST për kërkuesit shqiptarë në 2025 ka pësuar rritje. Përfaqësimi i Shqipërisë në aksionet COST ka pësuar rritje të lehtë, nga 90% në 2024 në 92% në 2025. Pjesëmarrja në aksionet COST sheh gjithashtu rritje të vazhdueshme nga viti në vit, p.sh. në vitin 2024, pjesëmarrja si pjesëtar i grupeve të punës (working group member) ka qenë 1,612, kurse në 2025 ky numër arriti 2,108. Gjithashtu, numri i kërkuesve në pozicione drejtuese në aksione është rritur nga 20 (2024), në 28 (2025). Ndërkohë, nga 2024 në 2025, edhe pjesëmarrja si anëtar i komitetit drejtues (Management Committee member) ka pësuar një rritje.

COST-i gjykohet si një mundësi e mirë për të krijuar rrjetin e duhur të kontakteve për të aplikuar më tej në programin Horizon Europe (HE) ose programe të tjerë të Bashkimit European. Nëse krahasojmë raportin e suksesit të projekteve në HE dhe atë të COST vërejmë se ndërkohë që tek i pari ai është 11.14%, në COST arrin deri në 39%, gjë e cila shpjegon dhe interesin në rritje të kërkuesve shqiptarë në këtë rrjet.

Treguesit për Shqipërinë në raportin 2025 të COST




COUNTRY REPRESENTATION IN COST ACTIONS (%)



INDIVIDUAL PARTICIPATION IN ALL ACTION ACTIVITIES

577 participations


- Women
- Men
- Young researchers and innovators



WORKING GROUP MEMBERS



2108 members

- Women
- Men
- Young researchers and innovators



Statistical data refers to 2025

ALBANIA



ALBANIA

TESTIMONIAL

"There are multiple and unique benefits to joining a COST Action, particularly for researchers from ITC countries like me. As part of the PROGRAMMING project, I had the opportunity to collaborate with an excellent network of researchers across Europe, publish fully funded open-access papers, and attend scientific events hosted by leading institutions."

ASSOC. PROF. KLEJDA HARASANI
University of Medicine, Tirana, Albania,
MC Member in PROGRAMMING Action

EXAMPLES OF ACTIONS WITH LEADERSHIP POSITIONS

* The arrow icon is a clickable link to each Action

- Disruptive innovation and exponential HRM: crafting next-gen employee experience, workplace, job market
- Rising nationalisms, shifting geopolitics and the future of European higher education/research openness
- Platform work inclusion living lab
- Democratization at stake? Comparing anti-gender politics in CEE and NME countries
- Cultural property protection for all
- Innate lymphoid cells – the European quest for innovative cancer prognosis and immunotherapy

SUCCESS STORY

REMO: BUILDING A HEALTHIER RESEARCH CULTURE ACROSS EUROPE

The COST Action REMO conducted a mental health overview in Albania.



iv. RRJETI EUREKA

Eureka është rrjeti ndërqeveritar më i madh në botë i shteteve që mbështesin kërkimin shkencor, zhvillimin dhe inovacionin. I themeluar në vitin 1985 nga 18 vende dhe Komisioni European, ky rrjet i ministrisve dhe agjencive nga 47 vende pjesëmarrës i ofron kompanive të ndryshme, universiteteve dhe instituteve kërkimore, mbështetje financiare, ekspertizë dhe hapësira për rritjen e biznesit. Fokus i është nxitja e ekselencës në inovacion dhe zhvillimi ekonomik, krijimi i vendeve të punës dhe konkurrueshmëria.

Shqipëria është anëtar i Eureka-s që nga viti 2021 dhe është pjesë aktive në programet e Network Projects dhe Investment Readiness, ku AKKSHI ka rolin kryesor si organ kombëtar financues dhe mbështetës. Që

nga viti 2021, në portalin online të Eureka-s janë regjistruar 36 aplikime të ndryshme (në programin Network Projects) për projekte me bashkëpunim biznes-akademi/institucione kërkimore.

Në vitin 2025, AKKSHI u angazhua në promovimin e thirrjes shumëpalëshe Eureka LinkUp për projekte të kërkimit dhe zhvillimit (Network Projects), e cila u hap në 26 maj 2025 me afat deri në 10 shtator 2025. Në thirrje morën pjesë 6 vende të ndryshme: Shqipëria, Austria, Mali i Zi, Serbia, Sllovenia, dhe Turqia. Të gjithë këto vende alokuan fonde të caktuara në buxhetet e tyre për financimin e projekteve fituese. Shqipëria alokoi një buxhet prej 200,000 Euro (20,000,000 Lekë) në vit për këtë thirrje, me një kufi prej 50,000 Euro (5,000,000) në vit për projekt.



Informacioni për angazhimet specifike të vendeve pjesëmarrës

Shteti	Institucioni koordinues	Mbulimi i kostove për pjesëmarrësit	Buxheti në Euro
1 Shqipëria	AKKSHI	80% për biznesin e vogël, universitetet dhe institucionet kërkimore 75% për biznesin e mesëm 65% për biznesin e madh	200,000
2 Austria	FFG	60% për biznesin e vogël 50% për biznesin e mesëm 50% për IAL-të dhe qendrat kërkimore 40% për biznesin e madh	Pa limit
3 Mali i Zi	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit	Nuk ka përcaktime	300,000 (100,000 E në vit/ 50,000 E projekt/ vit)
4 Serbia	Ministria e Shkencës, Zhvillimit Teknologjik dhe Inovacionit (NITRA)	50% e kostove totale të projektit për universitetet dhe institucionet kërkimore. Biznesi vetëfinancohet.	Pa limit (max 150,000 E/ projekt)
5 Sllovenia	Ministria e Shkencës, Zhvillimit Teknologjik dhe Inovacionit	Në varësi të llojit të institucionit	450,000 Euro për projekt
6 Turqia	TUBITAK	75% për SME-të, 60% për biznesin e madh, Universitetet/ institucionet kërkimore mund të financohen si të nënkontraktuar	Pa limit

Sipas kushteve të thirrjes dhe të Eureka-s për projektet bashkëpunuese (të cilat përfshijnë minimumi dy institucione pjesëmarrëse me fokus në përfshirjen e bizneseve), konsorciumi i krijuar për zbatimin e projektit duhet të përfshijë partnerë nga të paktën dy vende pjesëmarrës (nga këto të paktën një partner duhet të jetë nga një vend pjesëmarrës i Ballkanit Perëndimor). Gjithashtu, përveç partnerëve nga vendet pjesëmarrës në thirrje, lejohet pjesëmarrja e partnerëve nga vende të tjerë të rrjetit Eureka-s si dhe jashtë tij, me kusht që financimi publik ose vetëfinancimi i tyre të sigurohet brenda afatit të thirrjes.

Sekretariati i Eureka-s dhe përfaqësuesit e vendeve pjesëmarrës zhvilluan në datë 16 qershor 2025, 14:00-15:30 (CET) një webinar për të ndarë informacion të nevojshëm me të aplikuesit e interesuar. Në të njëjtën kohë, AKKSHI promovoi gjerësisht thirrjen nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit (email, faqe web, media sociale, ditë informuese, etj.)

Në përfundim të afatit të pranimit të aplikimeve, rezultoi se pati 14 aplikime të suksesshme, nga të cilat 3 aplikime me partnerë shqiptarë. Një pasqyrë më e plotë dhe e detajuar për aplikimet e thirrjes së rrjetit Eureka për Ballkanin Perëndimor 2024 jepet në Tabelën 11 si më poshtë.

Rezultatet e aplikimeve (thirrja Eureka LinkUp 2025)

	Titulli i projektit	Institucionet zbatuese	Kontakti kryesor i projektit	Buxheti i kërkuar (euro)
Fusha: Biodiversiteti dhe Mjedisi				
1	Green Innovation: Cascade Valorization of Agro-industrial By-products through Zero-Waste Solution (VALORGREEN)	Innovation Center of the Faculty of Technology and Metallurgy in Belgrade Ltd. (Serbi) në bashkepunim me partnerë shqiptarë (UPT, UT/FSHN, A-consultant)	Aleksandra Ivanovska (Ilda Kazani, nga pala shqiptare)	471,524.36
2	AI-Based Remote & Autonomous Landfill Fire Prevention System (LandSafe AI)	Nova Science (Mal i Zi)	Nova Science	205,989.60
Fusha: Agrikulturë, Ushqim dhe Bioteknologji				
3	Black soldier FLY peptides and chitin for healthier FEED (FLYFEED)	Jata Emona (Slloveni)	Ajda Ota	1,155,005.60
4	A New Natural Bio-Stimulants Line for Climate-Smart Cropping (NutriVive Bio-Stimulant Line)	Universiteti Bujqësor i Tiranës (Shqipëri)	Erinda Lika	276,415.00
5	Circular Proteins and Fats for Cost-Efficient Livestock Nutrition (AL-FEED)	Universiteti Bujqësor i Tiranës (Shqipëri)	Erinda Lika	277,019.00
6	Drone-enabled Interoperable Precision Agriculture Service (DreamAgri)	ONEDRONE d.o.o. S188522253 (Slloveni)	Anja Horvat	1,000,000.00
Fusha: Shëndetësia dhe Shkencat Mjekësore				
7	Upzeez - The NextGen of Baby Nursery Furniture (High Rize Baby Cot)	InSight and InReach Design Innovation (Brand - Upzeez) (Estoni)	Christopher Olufeso	347,458.60
Fusha: Uji dhe Energjia				
8	Hydrokinetic Flow Energy System for Sustainable Innovation (HYDROFLOW)	Flowgen Ltd (Slloveni)	Tadej Recek	1,684,350.00

Titulli i projektit	Institucionet zbatuese	Kontakti kryesor i projektit	Buxheti i kërkuar (euro)
9 Next-Generation AEM Electrolyzers with Asymmetric Electrolyte Operation for Hydrogen Production (AsymAEM)	ReCatalyst d.o.o. (Slloveni)	Nina Meglič	700,763.70
Fusha: Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit			
10 Verified Container Infrastructure for Regulated Operations and Networks (VERICON)	SRC sistemske integracije d.o.o. (Slloveni)	Uroš Malbašić	2,367,437.85
11 Autonomous System for Cargo lifting and Evacuation via Navigated Drone (ASCEND)	University of Belgrade - Faculty of Mechanical Engineering (Serbi)	Žarko Mišković	366,447.05
12 Intelligent System for Estimating Workforce Costs in Diverse Business Domains (INTELLIGENT WISE-D)	Detay Danışmanlık Bilgisayar Hizm. San. ve Dış Tic. AŞ. (Turqi)	Zafer Güler	734,100.00
13 AI-Driven Simulation Platform for Next-Gen Lightweight Materials (SIMLIGHT)	RD Motion, d.o.o. (Slloveni)	Damijan Zorko	785,000.00
14 Proactive Planning and Process Intelligence (CogniPlan AI)	Inden d.o.o. (Slloveni)	Peter Korenčan	1,160,000.00

Aplikimet e suksesshme sipas shteteve pjesëmarrëse në projekt

Shteti	Nr. i aplikimeve
Serbia	5
Shqipëria	3
Turqia	3
Mali i Zi	3
Austria	3
Sllovenia	8
Estonia	1
Portugalia	1
Kina	1
Gjermania	1

Nga 3 projektet shqiptare të suksesshme, 3 nga ato plotësuan kushtet formale (kombëtare dhe Eureka) dhe kaluan në fazën e vlerësimit nga ekspertët e fushës (kombëtarë). Nga këto projekt, 2 nuk arritën të marrin vlerësim pozitiv nga pala e huaj (austriake) dhe u skualifikuan. 1 projekt u vlerësua pozitivisht, si nga pala shqiptare, ashtu edhe nga pala e huaj (serbe) dhe pritet të miratohet për financim nga Bordi i Administrimit të AKKSHI për të nisur zbatimin e tij në 2026. Pritet që një thirrje e ngjashme të përsëritet edhe në vitin 2026.

**v. PROGRAMI I SHKËMBIMIT TË STUDIMEVE
UNIVERSITARE “CEEPUS IV”**

**Veprimtaria kryesore dhe Pozicionimi
Strategjik**



Gjatë vitit 2025, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) ka konsoliduar rolin e saj si Zyra Kombëtare CEEPUS (ZKC) për Republikën e Shqipërisë. Programi CEEPUS IV përfaqëson një instrument strategjik për ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, duke mbështetur mobilitetin akademik shumëpalësh me vendet partnere të Evropës Qendrore dhe Juglindore.

- Integrimin në ERA: forcimin e pozicionit të Shqipërisë brenda Hapësirës Evropiane të Kërkimit (ERA) dhe rrjeteve të inovacionit.
- Mobilitetin akademik: lehtësimin e shkëmbimit të studentëve, stafit akademik dhe kërkuesve ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë.
- Bashkëpunimin tematik: zhvillimin e rrjeteve universitare për kërkim të përbashkët dhe kurrikula me dimension evropian.

Kuadri Ligjor dhe Institucional

Veprimtaria e AKKSHI-t në zbatimin e CEEPUS IV mbështetet në kuadrin ligjor dhe institucional përkatës, përfshirë: Ligjin Nr. 19/2024 për ratifikimin e Marrëveshjes “CEEPUS IV”; Udhëzimin e MAS Nr. 16, datë 17.04.2025 për rregullat teknike të zbatimit dhe administrimit të bursave; si dhe harmonizimin e politikave me Strategjinë Kombëtare të Shkencës dhe Inovacionit 2023–2030.

Efikasiteti i shfrytëzimit të kuotave (përmbushja)

Përmbushja e kuotave matet përmes “muajve të bursës”, si valutë standarde e programit. Shqipëria ka ruajtur një kuotë tavan prej 130 muajsh në vit, duke shënuar rritje të kategorisë “Lëvizësit e Lirë” në vitin akademik 2025/2026.


Realizimi i muajve të mobilitetit CEEPUS për Shqipërinë (2024/2025–2025/2026)

Treguesi i realizimit	Viti 2024/2025	Viti 2025/2026
Të akorduara (Muaj në rrjete)	30.00	26.93
Lëvizësit e lirë të akorduar	5.40	9.20
Muaj të pashfrytëzuar	94.60	93.86
Kapaciteti total (muaj)	130.00	130.00

Mobiliteti hyrës (Incoming) dhe trafiku në rrjetin “Umbrella”

Shqipëria është pjesë aktive e rrjetit “Umbrella”, i cili lehtëson shkëmbimet jashtë rrjeteve fikse. Për vitin 2025/2026, trafiku hyrës dëshmon bashkëpunim të ngushtë me vendet partnere të Evropës Qendrore.

Volumi i shkëmbimeve hyrëse (Incoming) sipas shteteve (2025/2026)




Profilizimi i kategorisë “Lëvizësit e Lirë” (2025/2026)

Kategoria e “Lëvizësve të Lirë” ka shërbyer si instrument fleksibël për personelin dhe studentët jashtë rrjeteve tradicionale, me dominim të mësuesve dhe studentëve afatshkurtër.

- Mësues/Lektorë: 45%
- Studentë afatshkurtër: 35%
- Staf Universiteti: 14%
- Ekskursione afatshkurtra: 5%

Shpërndarja e “Lëvizësve të Lirë” sipas llojit të mobilitetit (2025/2026)



Sinergjia me programet e tjera (COST dhe Horizon Europe)

AKKSHI ka inkurajuar përfituesit e mobiliteteve CEEPUS të përdorin kontaktet e krijuara për të rritur pjesëmarrjen në Veprimet COST dhe në Horizon Europe, duke e trajtuar mobilitetin si bazë për bashkëpunime kërkimore dhe konsorciume.

Sfidat e identifikuara dhe rekomandimet

- Rritja e kapaciteteve absorbuese: orientimi i muajve të pashfrytëzuar drejt aplikantëve të rinj përmes fushatave të informimit.
- Digjitalizimi i proceseve: kalimi i plotë në platformat digjitale për raportimin e mobiliteteve për të ulur barrën administrative.
- Fokusi te Specializimi Inteligjent (S3): prioritet për aplikimet në fusha të lidhura me Energjinë, Bio-ekonominë dhe Turizmin, në përputhje me Strategjinë Kombëtare.

vi. Angazhime të tjera stafit të DPN:

Gjatë vitit 2025, në kuadër të angazhimeve institucionale, kombëtare dhe ndërkombëtare të AKKSHI, stafi i DPN është përfshirë dhe ka dhënë kontribut në veprimtaritë e mëposhtme:

1. Tryeza e rrumbullakët me Pikat Kombëtare të Kontaktit (PKK) të Horizon Europe për të diskutuar mbi gjendjen aktuale të rrjetit të PKK-ve, identifikimin e problematikave dhe gjetjen e zgjidhjeve, si dhe ndarjen e praktikave të mira dhe përvojave të rrjeteve homologe të huaja.
2. Ditë Informuese për Horizon Europe (duke përfshirë dhe COST, EUREKA) në institucione të arsimit të lartë, institucione publike, shoqëri civile, biznese, etj. si, Universiteti Aleksandër Moisiu Durres, Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali", Akademia e Forcave të Armatosura, Akademia e Shkencave, Bashkia Gjirokastrë, organizata ISAL, kompania austriake Entrenovu, dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.
3. Takime të rregullta koordinuese të AKKSHI-së që rrjedhin si detyrime kontraktuale si përfitues në projektet Policy Answers, NCP_WIDERA.NET, SEREN5, ERA TALENT, 1Future.
4. Plotësimi i formularëve dhe dokumenteve administrative për aplikimet në projektet bashkëpunimi [Coordination Support Action, CSA] me institucione të huaja në kuadër të Horizon Europe.
5. Takime shkëmbimi përvojash me PKK-të e vendeve të BE-së, si Sllovakia dhe Austria.
6. Në përgatitje të Takimit të 225 të CSO-ve të COST dhe Ditës Informuese COST që do të zhvillohen në Nëntor 2025 në Tiranë, u mbajtën takime koordinuese

për organizimin e aktiviteteve të cilët pritet të mbledhin përfaqësues nga vendet anëtare të COST, drejtues dhe staf të COST, si dhe grupe të kërkuesve shkencorë.

7. U organizua Takimi i 225 i CSO-ve të COST dhe Dita Informuese COST në Nëntor 2025.
8. Në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), u zhvillua aktiviteti për shpalljen e 55 projekteve të përzgjedhur nga READ për përfshirjen e Diasporës Shkencore shqiptare në projekte të përbashkëta.

Gjithashtu, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025, AKKSHI mori pjesë në Takimin e Tretë të Komitetit të Përbashkët BE-Shqipëri për Kërkimin dhe Inovacionin, ku u raportua mbi progresin e Shqipërisë në plotësimin e rekomandive të BE-së në Kapitullin 25, duke përfshirë promovimin e Horizon Europe si dhe implementimin e Strategjisë për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin 2023-2030 dhe Ligjin e ri për Kërkimin Shkencor, Strategjinë për Specializimin Inteligjent (S3), si dhe historin e ndryshme suksesi në teknologji dhe inovacion, si Technology and Development Area (TEDA), Durana Tech Park, dhe projektin NANOBALKAN dhe SUSNANO. Ky takim gjithëpërfshirës, ndër të tjera, theksoi mundësitë për bashkëpunim të zgjeruar nëpërmjet PKK-ve, Digital Innovation Hub, qendrave "EIT Raw Materials" dhe "EIT Community Hub Shqipëri".

Gjatë vitit 2025, Sektori Multilateral promovoi shpalljen e 70 aksioneve të reja COST, si dhe shqyrtoi aplikimet nga kërkuesit shkencorë për t'u nominuar si anëtarë të Komitetit Menaxhues të secilit aksion.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe është bërë raportimi i projekteve të ndryshme, përgatitja dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Grantit në

kuadër të projekteve, përdorimi i Funding and Tenders Portal, publikimi i vendeve të punës për stafet akademike tek Portali Euraxess Albania etj.

Kërkuesit Shkencor, Stafet Akademike, po asistohen on-line dhe off line në lidhje me pyetje apo paqartësi të ndryshme që lidhen me hapat e aplikimit në Horizon Europe, COST, Euraxess, pjesa e buxhetit, marrëveshjet e grantit, raportimet etj.

Në kuadër të Kapitullit 25, Zgjerimin e Zonës Europiane të Kërkimit ERA, Implementimin e Strategjisë për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin 2023-2030, Sektori i Marrëdhënieve Bilaterale dhe Multilaterale jep kontribut të vazhdueshëm dhe po ndjek me vëmendje të vecantë përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin prej tyre.

Gjatë periudhës së raportimit, u mor pjesë në trajnimin disaditor të zhvilluar nga EU4Innovation/GIZ dhe Zabala Consulting, me qëllim pajisjen e aktorëve të ndryshëm të kërkimit shkencor dhe inovacionit me njohuritë dhe aftësitë për shkrimin e projekt propozimeve të suksesshme në thirrjet e Horizon Europe.

2.3.2. SEKTORI 2 – PROGRAMET E BE

i. Përgatitja e raportit vjetor për ecurinë e projekteve ndërkombëtare

Sektori ka përgatitur raportin vjetor mbi ecurinë e projekteve të financuara në kuadër të programeve ndërkombëtare, duke përfshirë programe të Komisionit Evropian (Horizon Europe), si dhe iniciativa të organizatave si UNESCO, CEI dhe NATO. Ky raport ka analizuar:

- nivelin e pjesëmarrjes së institucioneve shqiptare
- numrin e projekteve të financuara
- fondet e përfituara
- ndikimin e projekteve në zhvillimin e kërkimit dhe inovacionit

Raporti ka shërbyer si një instrument kyç për vlerësimin e performancës kombëtare në këto programe.

ii. Analiza e programeve të BE-së

Sektori ka kryer analiza të vazhdueshme të programeve të Bashkimit Evropian, me fokus në:

- identifikimin e prioritetëve tematike
- analizën e mundësive të financimit
- përshtatjen e kapaciteteve kombëtare me kërkesat e programeve

Kjo analizë ka ndihmuar në orientimin më të mirë të aplikantëve dhe në rritjen e pjesëmarrjes efektive.

iii. Informim për programin Horizon Europe

Një pjesë e rëndësishme e aktivitetit ka qenë informimi i komunitetit kërkimor mbi programin Horizon Europe, duke përfshirë:

- shpërndarjen e njoftimeve për thirrje
- prezantimin e prioritetëve dhe instrumenteve të financimit

- orientimin për strukturën e aplikimeve

Ky proces ka ndikuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së institucioneve shqiptare.

iv. Organizimi i workshop-eve për aplikime

Sektori ka organizuar workshop-e dhe sesione trajnimi për aplikantët potencialë, me qëllim:

- përmirësimin e aftësive për hartimin e projekteve
- kuptimin e kriterëve të vlerësimit
- ndërtimin e partneriteteve ndërkombëtare

Këto aktivitete kanë kontribuar në rritjen e cilësisë së aplikimeve.

v. Ndihmë për aplikantët në projekte

Është ofruar asistencë e drejtpërdrejtë për aplikantët, duke përfshirë:

- këshillim mbi përgatitjen e projekt-propozimeve
- ndihmë në identifikimin e partnerëve ndërkombëtarë
- mbështetje për aspektet administrative dhe financiare

Kjo mbështetje ka qenë thelbësore për rritjen e suksesit në aplikime.

vi. Monitorimi i projekteve ndërkombëtare

Sektori ka realizuar monitorimin e projekteve ndërkombëtare në zbatim, duke ndjekur:

- progresin e aktiviteteve
- realizimin e objektivave
- përdorimin e fondeve

Ky proces ka siguruar përmbushjen e detyrimeve kontraktuale dhe rritjen e cilësisë së rezultateve.

vii. Koordinimi me rrjetet ndërkombëtare

Sektori ka koordinuar bashkëpunimin me rrjete dhe struktura ndërkombëtare, duke:

- lehtësuar shkëmbimin e informacionit
- përfshirë institucionet shqiptare në rrjete kërkimore
- promovuar bashkëpunimin shumëpalësh

viii. Raport mbi projektet e financuara

Janë përgatitur raporte periodike mbi projektet e financuara, duke analizuar:

- shpërndarjen sipas fushave
- performancën e institucioneve
- ndikimin e projekteve

ix. Analiza e performancës së projekteve

Sektori ka realizuar analiza të performancës së projekteve ndërkombëtare, duke identifikuar:

- fushat me sukses më të lartë
- problematikat në aplikim dhe zbatim
- nevojat për përmirësim të kapaciteteve

2.3.3. SEKTORI 2 - ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

i. Dhënie informacioni dhe këshillim

Sektori ka ofruar informacion dhe këshillim për institucionet shqiptare mbi programet ndërkombëtare të bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik, duke ndihmuar në:

- identifikimin e mundësive të financimit
- përgatitjen për aplikim
- orientimin strategjik

ii. Takime me organizata ndërkombëtare

Janë zhvilluar takime dhe kontakte me organizata ndërkombëtare, me qëllim:

- forcimin e bashkëpunimit institucional
- promovimin e pjesëmarrjes së Shqipërisë
- shkëmbimin e eksperiencave

iii. Përgatitja e projekteve të reja

Sektori ka mbështetur përgatitjen e projekteve të reja në kuadër të bashkëpunimeve shumëpalëshe, duke:

- identifikuar temat prioritare
- ndërtuar partneritete ndërkombëtare
- asistuar në hartimin e aplikimeve

iv. Analiza e bashkëpunimit ndërkombëtar

Është realizuar analizë e nivelit të bashkëpunimit ndërkombëtar, duke vlerësuar:

- pjesëmarrjen në programe
- intensitetin e bashkëpunimit me partnerët
- ndikimin e projekteve në sistemin kërkimor

v. Raporti vjetor ndërkombëtar

Në përfundim të vitit, sektori ka kontribuar në hartimin e raportit vjetor mbi aktivitetin ndërkombëtar, duke reflektuar:

- arritjet kryesore
- treguesit e performancës
- sfidat dhe rekomandimet për përmirësim

vi. Sfidat Kryesore dhe Rekomandimet

Për t'u fokusuar te zgjidhjet dhe përmirësimi i performancës, më poshtë paraqiten sfidat kryesore të identifikuara gjatë vitit 2025 dhe rekomandimet përkatëse:

Sfidat (Challenges)	Rekomandimet (Recommendations)
Përmbushja e Detyrimeve Kontraktuale: Drejtuesit e projekteve bilaterale nuk kanë përmbushur detyrimet e monitorimit dhe raportimit.	Të merren masa ndëshkimore/penalizuese për drejtuesit mos-bashkëpunues të projekteve dhe të miratohet menjëherë dokumentacioni i ri i monitorimit.
Koordinimi i Brendshëm: Dokumentacioni i ri për thirrjet bilaterale (Udhëzuesi, Skeda e Vlerësimit) është në pritje të miratimit nga Bordi, duke penguar nisjen e proceseve të monitorimit.	Të sigurohet miratimi i shpejtë i dokumenteve administrative nga Bordi për të nisur procesin e monitorimit të thirrjes Shqipëri-Kosovë 2024-2026 dhe thirrjet e reja bilaterale.
Inkluziviteti Gjinores (HE): Përqindja e vlerësuesve femra në Horizon Europe ka pësuar rënie (nga 57% në 30.57%).	Të rriten përpjekjet aktive për identifikimin dhe nominimin e eksperteve vlerësuese femra për programet e BE-së.
Stafi i Drejtorisë: Sektori i Marrëdhënieve Multilaterale mbeti i paplotësuar me 1 specialist më pak gjatë vitit 2025.	Të adresohet urgjentisht plotësimi i strukturës së stafit të DPN.

vii. Kërkesa/Rekomandime për Kapacitetet Njerëzore

Perspektiva e Zgjerimit: Me rritjen e vazhdueshme të veprimtarisë së AKKSHI-t dhe synimin për të rritur ndjeshëm numrin e projekteve të reja ndërkombëtare, diktohet nevoja e menjëhershme për zgjerimin e kapaciteteve njerëzore. Shtimi i numrit të specialistëve mbetet një kusht i domosdoshëm për të garantuar menaxhimin efikas të volumit në rritje të aplikimeve dhe për të siguruar një monitorim cilësor e teknik të bashkëpunimeve të reja strategjike që do të nisnin në vitet në vijim.

SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

3.1. SEKTORI 1 – FINANCË

Veprimtaria kryesore e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Gjatë vitit 2025, Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ka luajtur një rol thelbësor në garantimin e qëndrueshmërisë financiare, menaxhimin eficient të burimeve dhe mbështetjen administrative të veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI). Aktiviteti i sektorit është zhvilluar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe standardet e menaxhimit financiar publik, duke siguruar transparencë, kontroll dhe përgjegjshmëri në përdorimin e fondeve.

Sektori i Financës i Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) ka ushtruar aktivitetin e tij në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, duke garantuar një menaxhim të kujdesshëm, transparent dhe eficient të fondeve publike. Veprimtaria financiare është bazuar në zbatimin e procedurave standarde të buxhetit dhe monitorimit financiar, si dhe në respektimin e planit të miratuar të buxhetit për vitin 2025.

Buxheti fillestar i akorduar për AKKSHI për vitin 2025 ishte në vlerën 431.4 milion lekë, i orientuar kryesisht drejt financimit të programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit shkencor, mbështetjes së projekteve, si dhe mbulimit të shpenzimeve operative dhe administrative. Gjatë vitit janë kryer një sërë rialokimesh dhe rishikimesh buxhetore, në përputhje me vendimet e Bordit të Administrimit dhe udhëzimet e institucioneve përgjegjëse, duke reflektuar nevojat dinamike të zbatimit të programeve.

Menaxhimi i fondeve është karakterizuar nga një shpërndarje e balancuar ndërmjet

programeve kryesore të kërkimit shkencor, ku pjesa më e madhe e buxhetit është dedikuar për Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit, projektet e teknologjisë dhe inovacionit, mbështetjen e diasporës shkencore, si dhe programet ndërkombëtare. Paralelisht, janë financuar edhe aktivitete mbështetëse si konferenca, bursa ndërkombëtare (CEEPUS) dhe kuotat në organizata ndërkombëtare.

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 06.02.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", si dhe të Udhëzimit nr. 22 datë 07.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për Njësitë e Qeverisjes Qëndrore", ligjit nr.115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, kod institucioni 1011237, dhe kod programi 09770 "Kërkimi Shkencor", përsa i përket realizimit të buxhetit, gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2025 është arritur një nivel realizimi prej rreth 102,159 mijë lekë, nga një buxhet i rishikuar prej 183,348 mijë lekë.

Zërat e pagave dhe sigurimeve shoqërore janë realizuar pothuajse në masë të plotë (rreth 99%), ndërsa shpenzimet operative dhe transfertat kanë shfaqur nivele të ndryshme realizimi, në varësi të ecursisë së programeve dhe proceseve të financimit.

Gjatë vitit 2025, përdorimi i fondeve buxhetore është bazuar në respektimin korrekt të planit të buxhetit të vitit 2025 të miratuar, sipas artikujve, kapitujve në lidhje me pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpenzimet operative, granteve për financimin e projekteve, investimeve, duke siguruar një menaxhim dhe përdorim të fondeve buxhetore me transparencë, eficiencë dhe efektivitet të plotë.

Gjatë vitit janë evidentuar gjithashtu procese të rëndësishme, si shpërndarja e fondeve për projektet fituese, administrimi i granteve, financimi i projekteve ndërkombëtare dhe menaxhimi i të ardhurave jashtë limitit. Sektori ka garantuar ndjekjen dhe raportimin periodik të treguesve financiarë, si dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Financave për çdo ndryshim apo detajim të buxhetit.

Në tërësi, Sektori i Financës ka luajtur një rol kyç në mbështetjen e veprimtarisë së AKKSHI-së gjatë vitit 2025, duke siguruar stabilitet financiar dhe mbështetje efektive për realizimin e objektivave strategjike në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit.

3.1.1. Organizimi dhe drejtimi i veprimtarisë së sektorit

Sektori ka organizuar dhe drejtuar në mënyrë të strukturuar të gjithë veprimtarinë financiare dhe mbështetëse të institucionit, duke koordinuar proceset e planifikimit, zbatimit dhe raportimit financiar. Është siguruar funksionimi normal i proceseve të përditshme, si dhe mbështetja financiare për të gjitha drejtoritë dhe programet e AKKSHI-së.

3.1.2. Kontrolli dhe garantimi i shkresave financiare

Sektori ka garantuar verifikimin paraprak të të gjitha shkresave dhe urdhrave me karakter financiar, duke siguruar përputhshmërinë e tyre me legjislacionin në fuqi dhe me buxhetin e miratuar. Ky kontroll ka qenë një element kyç për ruajtjen e disiplinës financiare dhe shmangien e parregullsive.

3.1.3. Asistenca në llogaritjen e kostove

Është ofruar mbështetje e vazhdueshme për drejtuesit e programeve në llogaritjen e kostove të aktiviteteve dhe projekteve, duke kontribuar në:

- hartimin realist të buxheteve;
- optimizimin e përdorimit të fondeve;
- garantimin e qëndrueshmërisë financiare të programeve.

3.1.4. Menaxhimi i riskut financiar

Sektori ka identifikuar dhe përditësuar regjistrin e riskut financiar, duke analizuar rreziqet potenciale që lidhen me menaxhimin e fondeve dhe zbatimin e buxhetit. Janë ndërmarrë masa për kontrollin dhe minimizimin e këtyre risqeve, duke forcuar sistemin e kontrollit të brendshëm financiar.

3.1.5. Menaxhimi i detyrimeve dhe pagesave

Sektori ka garantuar:

- ndjekjen e borxheve të paarkëtuara dhe përpjekjet për arkëtimin e tyre
- kryerjen në kohë të pagesave ndaj kreditorëve

Ky proces ka kontribuar në ruajtjen e besueshmërisë financiare të institucionit dhe në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale.

3.1.6. Planifikimi buxhetor

Sektori ka hartuar dhe detajuar planin e shpenzimeve të institucionit, si dhe ka marrë pjesë aktive në përgatitjen e projekt-buxhetit vjetor të AKKSHI-së. Ky proces është bazuar në:

- prioritetet strategjike të institucionit;
- nevojat e programeve;
- kufizimet buxhetore.

3.1.7. Zbatimi i buxhetit

Sektori ka qenë përgjegjës për zbatimin e buxhetit vjetor dhe të vendimeve financiare, duke siguruar përdorimin e fondeve në përputhje me planifikimin dhe legjislacionin në fuqi.

i. Buxheti për shpenzimet kapitale viti 2025

Me shkresën nr. 835/3 prot, datë 20.03.2025, dergohen nga MAS miratimi I shpenzimeve kapitale (231), në shumën: 182,408,814 lekë për vitin 2025, për vitin 2026 shuma 350,000,000 lekë dhe për vitin 2027 shuma 350,000,000 lekë.

Me vendim bordi nr. 3, datë 13.03.2025 "Për miratimin e financimit të projekteve fituese të infrastrukturës së kërkimit shkencor dhe inovacionit për vitin 2025 dhe 2026 kemi miratimin e PIKSH: 180,480 për vitin 2025 dhe 212,499 për vitin 2026.

Me shkresën me nr. 843, datë 08.05.2025 kemi "Shpërndarjen e grantit të projekteve fituese të infrastrukturës" dërguar në MF, si pakësim i llogarisë 231 në shumën: 179,923,541 lekë dhe 212,499,309 lekë për vitin 2026.

Gjithashtu në muajin Korrik kemi një shtesë prej 5,953,852 lekë në llog 231, por nuk kemi shkresë as nga MAS as nga MF.

Me shkresën nr 7310/1 prot, data 19.11.2025 dërgohet nga MA shkresa për "Detajimin e fondeve në zbatim të Aktit Normativ Nr. 100, datë 08.10.2025", në shumën 8,439,125 lekë, pakësim të llogarisë 231.

**Buxheti total i AKKSH-së është:
613,809 (në mijë lekë).**

**Buxheti i rishikuar është:
183,348 (në mijëra lekë).**

**Fakti progresi Janar - Dhjetor:
102,159 (në mijëra lekë)**

Realizimi i buxhetit për vitin 2025

	Shpenzime totale në 000/lekë
Buxheti v.2025	613,809
Buxheti v.2025 i rishikuar	183,348
Fakti Janar – Dhjetor 2025	102,159

Realizimi i buxhetit për vitin 2025 (Në 000/lekë)

	Buxheti v.2025	Buxheti v.2025 i rishikuar	Fakti Janar-Dhjetor 2025	Në %
Paga	25,784	23,784	23,528	99%
Sigurime Shoqërore	3,776	3,776	3,752	99%
Mallra dhe Shërbime të Tjera	6000	6000	4,342	72%
Mallra dhe Shërbime të Tjera (08)	0	9,091	975	11%
Transferime korrente të brendshme	395,840	99,465	65,711	66%
Transferime korrente të huaja (01)	0	1,000	472	47%
Transferime korrente të huaja (08)	0	111	0	0
Transferta për buxhete familjare Bursa CEEPUS (8)	0	5,121	3,379	66%
Transferta për buxhete familjare (kap 01)	0	35,000	0	0
Projekte të infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (231)	182,409	0	0	0
TOTALI	613,809	183,348	102,159	

Shenim: Shpenzime nga te ardhurat jashte limitit jane (në mijera)

- Plani: 15,374.6 lekë
- Shpenzimet: 4,922 lekë

Me Vendim Bordi Nr. 7, datë 12.06.2025 "Për miratimin e rishpërndarjes së fondit të papërdorur të AKKSHI-së për vitin 2025" kemi miratimin e shpërndarje së buxhetit 120,000,000, për vitn 2025 si më poshtë:

1. Financim i projektit të bashkëpunimit të UBT me Universitetin BOKU të Vjenës 65,000,000 lekë
2. Programi për mbështetjen e diasporës akademike 10,000,000 lekë
3. Kuota ndërkombëtare vjetore, Horizont Europa 45,000,000 lekë

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore (zërat 600+601) për vitin 2025 janë realizuar në masën 27,280 (në mijë lekë) dhe 91% në zbatim të strukturës, organikës së miratuar me urdhër nr. 158, datë 05.10.2023, për një ndryshim në urdhërin nr.48, datë 12.04.2017, të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit", me VKM 325 dt 31.05.2023 për strukturën e pagave. Struktura akoma nuk është plotësuar pasi në fakt janë 18 punonjës nga 19 punonjës që ka struktura në plan. Kemi dhe një punonjëse me kontratë të perkohshme (sanitare, 6 orë) mbi numrin organik.

Fondi për shpenzime në mallra dhe shërbime (zëri 602, kap 01, është realizuar në vlerën 4,342 në mijë lekë, në masën 72%. Shpenzimet operative janë për pagesën e rojeve, për shpenzime postare, pritje percjellje, për pagesat e Bordit Administrimit, për pagesat e Komisionit të Vlerësimit të Projekteve, shërbime telefonike, tatim ne burim, taksa vendore, për blerje materiale pastrami dhe kancelari, bileta dhe dieta jashtë vendit, komisione bankare për trasnfertat në valutë, etj.

Transferime korrente të huaja, të kuotave ndërkombëtare në këtë periudhë ka patur në shumën 472 (në mijëra) lekë.

Fondi për bursat CEEPUS

Fondi për pagesën e bursave CEEPUS është 5,121 në mijë lekë, 1,321 të trashëguara dhe 3,800 në mijë lekë, me transferim në bazë të vendimit të BA nr 2, datë 13.02.2025.

Numri i personave që kanë përfituar gjate vitit 2025 në këtë periudhë është 80 dhe shuma e realizuar është 3,379 (në mijë lekë), pra 66 %.

Të ardhurat jashtë limitit janë 15,374 (në mijë lekë)

Nga të ardhurat jashtë limitit janë shpenzuar 4,922 në mijë lekë, mbetja për vitin në vazhdim është 10,452 (në mijëra lekë).

3.1.8. Menaxhimi i shpenzimeve të personelit

Janë planifikuar dhe menaxhuar fondet për:

- pagat dhe sigurimet shoqërore;
- fondin e veçantë;
- kompensimet dhe përfitimet e tjera.

Gjithashtu, janë propozuar masa për optimizimin e shpenzimeve të personelit.

3.1.9. Alokimi dhe rishpërndarja e burimeve

Sektori ka organizuar alokimin e burimeve financiare dhe, kur ka qenë e nevojshme, ka realizuar rishpërndarjen e tyre në përputhje me prioritetet dhe ecurinë e programeve, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe Vendimeve të Bordit.

3.1.10. Administrimi i pagave

Është përpiluar lista mujore e pagave për punonjësit dhe është mbajtur regjistri përkatës për çdo punonjës, duke garantuar korrektësi dhe transparencë në administrimin e pagesave.

3.1.11. Hartimi i bilancit financiar

Sektori ka përgatitur bilancin ekonomiko-financiar vjetor, bazuar në regjistrimin dhe evidentimin e plotë të të gjitha veprimeve financiare të institucionit.

3.1.12. Regjistrimi i të ardhurave dhe shpenzimeve

Janë regjistruar të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet sipas kuadrit ligjor në fuqi, duke ndjekur me saktësi realizimin e buxhetit sipas zërave përkatës.

3.1.13. Dokumentimi dhe gjurma e auditimit

Sektori ka dokumentuar të gjitha transaksionet financiare dhe ka garantuar gjurmën e auditimit për çdo proces financiar, duke përmbushur standardet e kontrollit dhe transparencës.

3.1.14. Rakordimi me Thesarin

Është realizuar rakordimi mujor i të dhënave financiare me Degën e Thesarit, duke siguruar përputhshmërinë dhe saktësinë e

regjistrimeve financiare.

3.1.15 Raportimi financiar

Sektori ka përgatitur raporte dhe analiza periodike mbi veprimtarinë financiare, të cilat i janë paraqitur titullarit të institucionit, duke reflektuar:

- nivelin e realizimit të buxhetit
- problematikat financiare
- rekomandimet për përmirësim

3.1.16 Koordinimi me Ministrinë e Arsimit

Është realizuar koordinim i vazhdueshëm me Ministrinë e Arsimit dhe institucionet përkatëse për çështje që lidhen me buxhetin, financimin dhe raportimin.

3.1.17 Menaxhimi i inventarit

Sektori ka qenë përgjegjës për administrimin dhe përditësimin e inventarit të institucionit, duke siguruar regjistrimin dhe kontrollin e aseteve.

3.1.18 Kontrolli i magazinës dhe vlerave materiale

Është garantuar kontrolli i magazinës dhe i lëvizjeve të vlerave monetare dhe materiale, duke siguruar menaxhim të rregullt dhe të dokumentuar të tyre.

3.2. SEKTORI 2 – PROKURIMI

Gjatë vitit 2025, Sektori i Prokurimit ka luajtur një rol të rëndësishëm në garantimin e përdorimit efikas, transparent dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi të fondeve publike të AKKSHI-së. Veprimtaria e këtij sektori është fokusuar në planifikimin, zhvillimin dhe monitorimin e procedurave të prokurimit publik, duke siguruar përmbushjen e nevojave të institucionit në kohë dhe me cilësi.

Mbështetur në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, AKKSHI për vitin 2025 raporton se:

a) Në Janar 2025, me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor është proceduar me:

- Ngritjen e Komisionit për prokurimet me vlera të vogla;
- Ngritjen e Komisionit për prokurimet sipas Sistemit Dinamik të Biletave të Transportit Ajror;
- Ngritjen e Komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve;
- Caktimin e Autoritetit Përgjegjës për procedurat e prokurimeve publike;

b) Në Janar 2025, është hartuar brenda afateve ligjore dhe nënligjore Regjistri i Parashikimeve të Prokurimeve Publike;

c) Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar në total 14 (katërmëdhjetë) procedura prokurimi për blerje me vlera të vogla, nga të cilat rezultojnë:

- 2 procedura për blerje nën 100,000 (njëqind mijë) lekë;
- 2 procedura për blerje me vlerë të vogël mbi 100.000 lekë;
- 10 procedura blerje biletash.

Nga ana e zyrtarëve të AKKSHI, pjesmarrës

në procedurat e prokurimit, janë plotësuar brenda afateve kohore dhe sipas legjislacionit përkatës të gjitha deklaratat e konfliktit të interesave;

d) Nuk janë konstatuar raste të konfliktit të interesave nga zyrtarët e AKKSHI gjatë procedurave të prokurimit publik;

e) Janë dhënë brenda afateve kohore, kundrejt Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe Degës së Thesarit të gjitha informacionet e duhura mbi Rregjistrat e Realizimit të Prokurimeve Publike.

3.2.1. Planifikimi i procedurave të prokurimit

Sektori ka realizuar planifikimin vjetor të procedurave të prokurimit, në përputhje me planin e buxhetit dhe nevojat operationale të institucionit. Ky proces ka përfshirë:

- identifikimin e kërkesave për mallra, shërbime dhe investime
- hartimin e regjistrat të parashikimeve të prokurimit
- përcaktimin e procedurave përkatëse sipas vlerës dhe natyrës së shpenzimeve

Planifikimi i mirëstrukturuar ka mundësuar zhvillimin e procedurave në kohë dhe shmangien e vonesave në realizimin e aktiviteteve të institucionit.

3.2.2. Ndjekja e procedurave të prokurimit publik

Sektori ka ndjekur dhe administruar të gjitha procedurat e prokurimit publik në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi, duke garantuar:

- transparencë dhe konkurrencë të ndershme
- respektimin e afateve ligjore
- dokumentimin e plotë të çdo procedure

Procesi ka përfshirë përgatitjen e dokumenteve të tenderit, publikimin e procedurave në sistemin elektronik të prokurimit, vlerësimin e ofertave dhe shpalljen e fituesve, në bashkëpunim me komisionet përkatëse.

3.2.3. Monitorimi i kontratave

Pas përfundimit të procedurave të prokurimit, sektori ka ndjekur zbatimin e kontratave të lidhura, duke monitoruar:

- respektimin e kushteve kontraktuale;
- cilësinë e mallrave dhe shërbimeve të ofruara;
- përmbushjen e afateve të dorëzimit.

Ky proces ka siguruar që kontratat të zbatohen në mënyrë korrekte dhe në interes të institucionit.

3.2.4. Analiza e procedurave të prokurimit

Sektori ka kryer analiza të vazhdueshme të procedurave të zhvilluara, me qëllim:

- identifikimin e problematikave dhe pengesave;
- përmirësimin e efikasitetit të proceseve;
- rritjen e konkurrencës dhe cilësisë së ofertave.

Analiza ka evidentuar sfida të lidhura me tregun, si mungesa e operatorëve ekonomikë në disa fusha dhe variacionet e çmimeve, duke ndikuar në disa raste në zhvillimin e procedurave.

3.2.5. Raporti vjetor i prokurimeve

Në përfundim të vitit, sektori ka përgatitur raportin vjetor të prokurimeve, i cili ka përfshirë:

- numrin dhe llojin e procedurave të zhvilluara
- vlerën e kontratave të lidhura

- nivelin e realizimit të planit të prokurimit
- analizën e performancës dhe sfidave

Ky raport ka shërbyer si një instrument i rëndësishëm për transparencë dhe për përmirësimin e mëtejshëm të proceseve të prokurimit.

3.3. SEKTORI 3 – BURIME NJERËZORE

Gjatë vitit 2025, Sektori i Burimeve Njerëzore ka luajtur një rol kyç në sigurimin e funksionimit efektiv të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), duke garantuar menaxhimin profesional të kapitalit njerëzor dhe përputhshmërinë me kuadrin ligjor në fuqi. Veprimtaria e sektorit është fokusuar në rekrutimin, zhvillimin dhe vlerësimin e stafit, si dhe në forcimin e praktikave të mira të administrimit publik dhe të qeverisjes së burimeve njerëzore.

Bazuar në Urdhrin e Kryeministrit Nr. 158 datë 5.10.2023 Për një ndryshim në Urdhrin Nr.48, datë 12.04.2017, të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit", AKKSHI ka të miratuar në strukturën e tij 19 (nëntëmbëdhjetë) punonjës, ku 1 (një) punonjës është me Kod Pune dhe 18 (tetëmbëdhjetë) punonjës janë nëpunës civilë.

A. Rekrutimet

Struktura e AKKSHI e miratuar prej 19 punonjësish rezultonte në muajin Janar 2025 me 3 (tre) vende vakante për nëpunës civilë si më poshtë vijojnë:

- a) 1 (një) përgjegjës sektori
- b) 2 (dy) specialistë

B. Pozicionet vakante në dhjetor 2025

Deri në 31.12.2025 AKKSHI rezultoi me 1 (një) vend vakant dhe konkretisht:

- a) 1 (një) Specialist

C. Sistemi elektronik HRMIS

Gjatë vitit 2025 AKKSHI ka plotësuar në mënyrë të rregullt dhe të përditësuar informacionet në sistemin elektronik (HRMIS) lidhur me rekrutimet dhe largimet e punonjësve pranë këtij institucioni.

D. Statusi i nëpunësit civil

Në zbatim të Ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, për periudhën nga Janar 2025 deri në 31.12.2025 në AKKSHI ka patur 3 (tre) specialist si nëpunës civil në periudhë prove, ku nga të cilët 2 (dy) specialistë e kanë marrë statusin e nëpunësit civilë ndërsa 1 (një) Specialist tjetër vazhdon të jetë aktualisht nëpunës civil në periudhë prove.

E. Rregjistri Qëndror i Personelit HRMIS - Dosjet e personelit

AKKSHI ka mbajtur me rregullsi dosjet e personelit. Cdo e dhënë që përmban dosja individuale e punonjësve është hedhur në mënyrë të rregullt dhe të përditësuar në Regjistrin Qëndror të Personelit (HRMIS) që administrohet nga DAP.

3.3.1. Zbatimi i legjislacionit mbi deklarin e interesave private pasurore dhe konfliktit të interesave

i. Subjektet e deklarin të interesave private pasurore gjatë vitit 2025

Për procesin e deklarin të interesave private periodike, në zbatim të Ligjit Nr.9049 datë 10.04.2003 "Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, AKKSHI për vitin 2025 raporton:

- Për vitin 2025 Autoriteti Përgjegjës ka dhënë njoftimet kundrejt subjekteve deklaruese, brenda afateve ligjore;
- Autoriteti Përgjegjës ka dhënë konsulencën e duhur dhe ka dorëzuar brenda afateve ligjore Deklaratat e Interesave Private;
- Është rakorduar lista e zyrtarëve që mbartin detyrim për deklarin e interesave private;
- Nuk ka pasur raste të mosrespektimit të afateve ligjore për dorëzimin e deklaratave të interesave private nga zyrtarët që

mbartin detyrimin për deklarin.

- Nuk rezultojnë masa disiplinore për shkelje të konstatuara të Ligjit Nr.9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

Gjatë vitit 2025, referuar nenit 3, të Ligjit Nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar AKKSHI raporton se numri i subjekteve sipas funksioneve që kanë mbartur detyrimin për deklarin të interesave private ka qënë si vijon:

Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklarin të interesave private

Funksioni	Nr. gjithsej i pozicioneve sipas strukturës	Nr. i zyrtarëve që mbartin detyrimin për deklarin
Drejtor Përgjithshëm	1	1
Drejtor Drejtorie	2	2
TOTALI	33	

Gjatë vitit 2025, referuar sërish Ligjit Nr.9049, datë 10.04.2003 i ndryshuar, lista emërore e zyrtarëve që kanë mbartur detyrimin për deklarin të interesave private në AKKSHI rezulton si më poshtë:

Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklarin të interesave private

Funksioni	Data e emërimit	Lloji i deklarin DPF/DPV/DPL
Drejtor Përgjithshëm	04.07.2019	DPV
Drejtor Drejtorie	04.07.2017	DPV
Drejtor Drejtorie	26.06.2018	DPV

ii. Konflikti i interesave gjatë vitit 2025

Për identifikimin dhe regjistrimin e rasteve të konfliktit të interesave, në zbatim të Ligjit Nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar; si dhe të Udhëzimit Nr.01, datë 27.6.2014 "Për krijimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e strukturave të autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave, në institucionet publike" të Inspektoriatit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKP), AKKSHI për vitin 2025 raporton se:

- Janë plotësuar autorizimet për parandalimin e konfliktit të interesave nga çdo zyrtar i AKKSHI;
- Janë plotësuar deklaratat e konfliktit të interesave në procedurat e prokurimeve publike nga zyrtarët përkatës të AKKSHI;
- Nuk janë konstatuar raste të konfliktit të interesave nga zyrtarët/punonjësit e AKKSHI;
- Janë marrë kundrejt ekspertëve vlerësues të projekteve kërkimore shkencore deklaratat e konfliktit të interesave private dhe deklaratat e konfidencialitetit të të dhënave personale.
- Nuk janë konstatuar raste të konfliktit të interesave për ekspertët gjatë kryerjes së detyrës së tyre, por janë konstatuar raste të papajtueshmërisë së funksionit si ekspert dhe pjesëmarrjes si "aplikantë në projekte".
- Në këtë rast është proceduar me dhënien e dorëheqjes nga ana e ekspertit dhe dhënia e konfirmimit zyrtar për përzgjedhjen e njërit prej funksioneve, ose si ekspert, ose si aplikant në projekt.

3.3.2. Zbatimi i procedurave ligjore në menaxhimin e burimeve njerëzore

Sektori ka ndjekur dhe zbatuar në mënyrë rigorozë të gjitha procedurat ligjore që lidhen

me menaxhimin e burimeve njerëzore, duke përfshirë:

- organizimin e proceseve të rekrutimit në përputhje me kriteret ligjore dhe parimet e meritokracisë
- zhvillimin e procesit të vlerësimit të performancës së punonjësve
- regjistrimin dhe dokumentimin e të gjitha lëvizjeve të stafit (emërime, transferime, largime)
- administrimin dhe mirëmbajtjen e dosjeve të personelit

Gjithashtu, sektori ka përgatitur dhe raportuar indikatorë të menaxhimit të burimeve njerëzore, duke kontribuar në një vendimmarrje më të informuar dhe strategjike.

3.3.3. Sigurimi i burimeve njerëzore dhe zhvillimi i karrierës

Në funksion të mbështetjes së veprimtarisë së institucionit, sektori ka identifikuar nevojat për staf dhe ka kontribuar në sigurimin e burimeve njerëzore të kualifikuara. Paralelisht, është kushtuar rëndësi zhvillimit profesional dhe karrierës së punonjësve përmes:

- nxitjes së pjesëmarrjes në trajnime dhe aktivitete zhvilluese
- mbështetjes për përmirësimin e aftësive profesionale
- krijimit të kushteve për avancim në karrierë

Kjo qasje ka ndihmuar në rritjen e motivimit dhe performancës së stafit.

3.3.4. Mbështetja e njësive organizative

Sektori ka ofruar mbështetje të vazhdueshme për njësitë organizative në çështje që lidhen me menaxhimin e personelit, duke përfshirë:

- asistencë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë

- këshillim për zbatimin e masave disiplinore në përputhje me legjislacionin
- hartimin dhe përditësimin e përshkrimeve të punës

Kjo mbështetje ka kontribuar në standardizimin dhe përmirësimin e proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në të gjithë institucionin.

3.3.5. Zbatimi i politikave jo-diskriminuese

Sektori ka garantuar zbatimin e politikave të barazisë dhe mosdiskriminimit në vendin e punës, duke promovuar:

- trajtim të barabartë për të gjithë punonjësit
- respektimin e të drejtave të punës
- një mjedis pune gjithëpërfshirës dhe profesional

Ky angazhim ka kontribuar në krijimin e një kulture organizative të bazuar në integritet dhe respekt reciprok.

3.3.6. Monitorimi i standardeve të integritetit dhe mbrojtjes së të dhënave

Sektori ka monitoruar dhe garantuar zbatimin e detyrimeve ligjore që lidhen me:

- mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve
- parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike
- deklarimin e pasurive dhe detyrimeve financiare

Këto procese kanë qenë thelbësore për ruajtjen e integritetit institucional dhe për forcimin e besimit publik.

3.3.7. Kontributi në hartimin e strukturës dhe organikës

Sektori ka marrë pjesë aktive në procesin

e hartimit dhe përditësimin të strukturës organizative dhe organikës së institucionit, duke analizuar:

- nevojat për burime njerëzore
- eficiencën e strukturës ekzistuese
- shpërndarjen optimale të funksioneve dhe përgjegjësi

Ky kontribut ka ndihmuar në përmirësimin e organizimit të brendshëm dhe në rritjen e efektivitetit institucional.

3.4. Sektori 4 – Administratë dhe Protokollit

Gjatë vitit 2025, Sektori i Administratës dhe Protokollit ka luajtur një rol të rëndësishëm në sigurimin e funksionimit administrativ dhe dokumentar të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), duke garantuar menaxhimin korrekt dhe të organizuar të fluksit të informacionit dhe dokumentacionit zyrtar. Veprimtaria e sektorit është fokusuar në administrimin e korrespondencës, ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve, si dhe në mbështetjen e proceseve të komunikimit institucional.

Arkiva e AKKSHI

Gjatë vitit 2025, në zbatim të Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", i ndryshuar, të "Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", si dhe bazuar në Vendimin Nr. 4, datë 19.6.2017 "Për miratimin e "Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, AKKSHI informon se:

- a) Në Janar 2025, me urdhër të titullarit të AKKSHI, është ngritur Komisioni i Ekspertizës mbi dokumentacionin zyrtar të AKKSHI;
- b) Komisioni i Ekspertizës ka hartuar Listën e dokumentacioneve me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK) dhe Listën e dokumenteve me Afat të Përkohshëm;
- c) Janë mbajtur nga punonjësi i sekretari/arkivit dosjet e dokumentave të vitit 2025 sipas pasqyrës së celjes së dosjeve;
- d) Referuar përpunimit tekniko-shkencor të dokumentacioneve informojmë se është përfunduar përpunimi tekniko-

shkencor i dokumentave të vitit 2010 dhe është dorëzuar pranë institucionit përkatës Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Për sa i përket përpunimit tekniko-shkencor të dokumentacioneve, të vitit 2011, ju bëjmë me dije se, viti 2011, është në proces përpunimi.

3.4.1 Menaxhimi i korrespondencës, arkivit dhe protokollit

Sektori ka administruar në mënyrë të strukturuar dhe të kontrolluar të gjithë ciklin e dokumentacionit zyrtar, duke përfshirë:

- pranimin, regjistrimin dhe shpërndarjen e korrespondencës hyrëse dhe dalëse
 - ndjekjen e qarkullimit të dokumenteve ndërmjet njësive organizative të institucionit
 - regjistrimin e çdo dokumenti në sistemin e protokollit, duke garantuar gjurmueshmërinë dhe transparencën
- Në kuadër të menaxhimit të arkivit, sektori ka siguruar:
- ruajtjen sistematike dhe klasifikimin e dokumenteve sipas standardeve ligjore
 - arkivimin fizik dhe, në rastet e mundshme, digjital të dokumentacionit
 - akses të kontrolluar dhe të sigurt në dokumente për njësitë përkatëse

Gjithashtu, është garantuar riprodhimi i shkresave dhe formularëve të nevojshëm për funksionimin e përditshëm të institucionit, duke mbështetur proceset administrative dhe operacionale.

Sektori ka kontribuar në rritjen e eficiencës së komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm të AKKSHI-së, duke siguruar që informacioni të qarkullojë në kohë dhe në mënyrë të saktë ndërmjet strukturave të institucionit dhe partnerëve të tij.

3.4.2. Programi i Transparencës

Plotesimi i Programit të Transparencës së AKKSHI-së ka për qëllim nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjësisë së autoriteve publike.

Gjatë vitit 2025, në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar, është plotësuar Programi i Transparencës së Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit. Bazuar në pikën 10, të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar, Koordinatorin për të Drejtën e Informimit ka krijuar, publikuar dhe përditësuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve brenda afatit të caktuar ligjor. Gjithashtu, në disa raste të caktuara Koordinatorin ka derguar kërkesën për informim nje autoriteti tjetër publik brenda afateve të parashikuara ligjore, në rastin kur autoriteti publik nuk e zoteron informacionin e kërkuar, për kërkesën e cila është e depozituar.

Bazuar në pikën 2, të nenit 19, të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar, në mungesë të delegimit të ushtrimit të funksioneve siç është përgatitja dhe miratimi i Programit të Transparencës, rishikimi i tij, nga titullari i institucionit tek nëpunësi më i lartë civilë, këto detyra janë kryer nga Koordinatorin i të drejtës për Informim.

Këto detyra tek Programi i transparencës së AKKSHI-së përfshijnë:

- Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve;
- Kuadri ligjor rregullator dhe Integrimi evropian;
- E drejta për t`u informuar dhe ankuar;
- Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare në AKKSHI;
- Informacion mbi procedurat e prokurimit;
- Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit,

- llojet dhe format e dokumenteve;
- Informacione dhe dokumenta që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikun nga AKKSHI;
- Rreth autoritetit AKKSHI;
- Procedurat mekanizma për të dhëna mendime për hartimin e akteve nënligjore apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit përgjegjës;
- Ndihma shoqërore të dhëna nga AKKSHI;
- Sherbimet që ofrohen nga AKKSHI.



RAPPORT 2025

PLANI I VEPRMIT VITI 2026